Иако, често нивните мислења беа спротивставени, сепак, најголемите разлики помеѓу практичарите од правната сфера, со кои имавме можност да разговараме, можат да се забележат во однос на три конкретни прашања: транспарентноста на процесот на назначување бранители по службена должност; плаќањето за услугите на бранителите по службена должност; и обемот на работа на адвокатите, откако ќе стапи во сила новиот ЗКП.

Вообичаено, практичарите се на мислење дека службеното назначување бранители од страна на претседателите на судовите или претседателите на судските совети, се заснова врз личната наклонетост и познанство со одредени адвокати или перцепцијата на судијата или претседателот на советот, за евентуалната „послушност“ на назначениот адвокат. Ова прашање е поврзано со општата загриженост за обезбедување транспарентност во судските постапки и правото на правично судење, како и со правото на соодветна одбрана кое произлегува од нив. И покрај свесноста за ограничувањата, со кои судиите се соочуваат во текот на својата работа и кратките временски рокови наметнати во постапките, мора да се преземат

напори за да се обезбеди најтранспарентно и правично спроведување на судските процеси. Почитувањето на објективни критериуми, како ,на пример, оној за назначување бранители по азбучен ред од изготвените списоци во судовите, гарантира поправичен пристап, паралелно со одредбите кои дозволуваат одредени отстапки, кога тоа го бараат одредени околности, кои се надвор од контрола – нерасположивост на адвокати, конфликт на интереси или други прашања од слична природа. Успешната примена на едно такво решение ќе зависи од постоењето и соодветната примена на списоци на квалификувани и мотивирани адвокати.

Овој услов е од уште покритична важност во постапките за сложени кривични дела, каде односот на меѓусебна доверба помеѓу обвинетиот и неговиот бранител е вообичаено послаб, како резултат на службеното поставување на бранител од страна на судот. Оваа „разредена“ врска помеѓу клиентот и адвокатот може да биде директен производ на фактот што бранителот е или наметнат на обвинетиот, кој не бил во можност да ангажира адвокат приватно или избран и поставен во отсуство на самиот обвинет. Во вториот случај, едноставно не постои никаква врска помеѓу бранителот и клиентот. Со цел да се зајакне оваа врска и на тој начин да се подигне квалитетот на понудената одбрана, судот мора да обезбеди соодветна компетентност и повисоко ниво на заинтересираност и мотивација на бранителите, поставени по службена должност од страна на судот.

Доколку списоците по азбучен ред бидат воведени како основа за поставување на службените бранители, тоа треба да бидат списоци со имиња на искусни адвокати, кои доброволно би го прифатиле таквиот ангажман, способни да дадат свој придонес кон успешната одбрана во кривичните предмети. Секој суд треба да настојува да изготви таков список (доколку е можно, имајќи предвид дека е можно да има недостиг од лиценцирани адвокати, кои го поседуваат неопходното искуство во кривичната сфера во одредена територијална надлежност, што дополнително ќе му ја отежни задачата на претседателот на судот, кој е месно надлежен, за изготвување на квалитетен список). Дополнително, судовите мораат да усвојат единствен пристап во однос на критериумите, кои ќе ги земат предвид при изготвувањето на таквите списоци, кои можат да бидат доследни на критериумите, утврдени од страна на другите судови од иста надлежност и слични специфики или, пак, тоа да бидат посебни критериуми,

конкретно применливи само за одделни судови. Во тој поглед, искуствата од Франција, МКСПЈ и Хрватска се особено интересни. Некои локални адвокатски комори во Франција, како што е, на пример, Париската адвокатска комора, сите идни бранители по службена должност ги обврзуваат на задолжителна специјализирана обука во вкупно времетраење од дваесет и четири часа, во рок од шест недели, пред воопшто да бидат назначени од судот како службени бранители. МКСПЈ исто функционира според систем на постојни списоци на адвокати, кои можат по службена должност да бидат поставени од Трибуналот. Критериумите, кои се применуваат за вклучување на списокот, обезбедуваат ангажман на адвокати кои се доволно искусни и квалификувани да постапуваат по предмети за воени злосторства. Во 2008 година, во Хрватска беше воспоставен специјален список за потребите на одбраната за случаи на воени злосторства, при што беа проширени и барањата во однос на искуството на адвокатите кои сакаат да се најдат на списокот. Воведувањето на условот за најмалку петгодишно соодветно искуство со новиот ЗКП, за адвокатите, кои би биле поставени да работат на предмети за кривични дела, за кои законот предвидува затворска казна од најмалку десет години, покажува дека законодавецот ја има идентификувано оваа конкретна слабост на кривичната постапка. Ова покачување на прагот на искуство, претставува промена која ветува.

Иако не се работи за прашање кое е ендемично само за земјата-домаќин, проблематичните хонорари и со нив поврзаното доцнење во исплатата на надоместоците за бранителите назначени по службена должност, се чини дека предизвикуваат големо незадоволство меѓу практичарите од правната сфера. Некои од практичарите посведочија за ситуации во кои на адвокатите им била исплатена само една половина од минималниот износ на хонорарот, предвиден со адвокатската тарифа. Иако ова прашање е поврзано со поголемиот проблем на судскиот буџет и не зависи само од судовите, ниските и нередовните исплати на наградите за бранителите по службена должност неизбежно влијаат врз нивната мотивација и капацитети за давање соодветна одбрана. Затоа, отсутството на финансиски потстрек директно ќе влијае врз квалитетот на одбраната, која се нуди за сиромашните лица.

Конечно, извесното воведување на дополнителни истражни одговорности и задачи за адвокатите на одбраната наметнува одредени суштински прашања. Дали и на кој начин адвокатите ќе се справат со овие нови задолженија од

аспект на дополнителниот обем на работа? Колку ќе бидат квалификувани за спроведување на таквите истражни дејствија? Кој ќе ги финансира овие нови активности? И она најважното, на кој начин, овие нови функции ќе се одразат врз ангажманот и работата на бранителите по службена должност?

Без сомнеж, најсоодветниот модел, на кој би можеле да се повикаме, е моделот на Канцелариите на јавни бранители (КЈБ) во САД. Откако беа запознаени со карактеристиките на КЈБ во САД, огромното мнозинство од практичарите од правната сфера – кои доаѓаат од различни сегменти на струката – го поздравиле концептот на КЈБ. Меѓу практичарите со кои разговаравме постои широк консензус дека американскиот модел претставува ефективен систем за обезбедување правна помош за сиромашните. Оние што не го споделуваа ваквото мислење вообичаено изразуваа скептицизам и загриженост, идентификувајќи ги КЈБ како потенцијална конкуренција во однос на адвокатите и нивната должност за заштита на правата на одбраната и правото на правично судење. Тие често пати потенцираа дека во земјата и така веќе има премногу правници. Како и да е, практичарите од правната сфера квазиедногласно утврдија дека американскиот концепт на КЈБ би можел ефикасно да се адаптира и во државава, имајќи предвид дека новиот ЗКП предвидува и зголемена одговорност и обврски за адвокатите, особено од аспект на спроведувањето истражни дејствија.

Еден американски модел на КЈБ би можел да биде од интерес за земјата. Во 2007 година, бројот на население во државата Ново Мексико беше проценет на 1 милион 960 илјади жители.¹⁹⁹ Истата таа година (2007), тамошната државна програма на јавни бранители имаше 13 канцеларии низ целата држава, постапуваше по 72 740 предмети и вработуваше 223 адвокати со полно работно време, со вкупни годишни трошоци од околу 37 милиони американски долари, што претставуваше 15,8% од севкупните трошоци во судската и правната сфера во државата.²⁰⁰ Сепак, најдобро е да се избегне каква било избрзана споредба со земјата домаќин, затоа што истото бара да се земат предвид и бројните специфични карактеристики на земјата.

¹⁹⁹ Погледнете Лин Лангтон (Lynn Langton) и д-р Доналд Фарол (Donald Farole) помладиот, Специјален извештај за програмите за јавни бранители од 2007 година, страница 4, Министерство за правда на САД, Канцеларија за правосудни програми, Статистичко биро за правосудството, NCJ 228229 од септември 2010 година.

²⁰⁰ Видете погоре, Лин Лангтон (Lynn Langton) и д-р Доналд Фарол (Donald Farole) помладиот, страница 4.

На пример, во 2006 година стапката на криминал во Ново Мексико беше речиси четири пати поголема од онаа во земјата-домаќин (во земјата-домаќин биле евидентирани 1 081,53 кривични дела на секои 100 000 жители, а во Ново Мексико истата бројка изнесувала 4 280,00 дела на 100 000 жители).²⁰¹ Од друга страна, во 2007 година вкупниот судски буџет на Ново Мексико бил речиси осум пати поголем од оној на земјата домаќин (22 241 278,00 евра во земјата-домаќин, во споредба со 172 110 295,00 евра во Ново Мексико).²⁰² Исто така, вкупниот буџет предвиден за правна помош во Ново Мексико за 2007 година бил 30 пати поголем од буџетот на земјата-домаќин, одвоен за истата цел и истиот временски период (900 277,00 евра во земјата-домаќин, наспроти 27 107 673,00 евра во Ново Мексико).²⁰³ Конечно, државната Програма на јавни бранители во Ново Мексико има постапувано во 27 пати повеќе предмети на бесплатна правна помош од земјата-домаќин (во земјата-домаќин, правна помош е обезбедена во 2 674 случаи во текот на 2007 година – од кои 2 652 за кривични

²⁰¹ Погледнете го испитувањето на Канцеларијата за дроги и криминал на Обединетите нации (UNODC) за 2005-2006 година, македонскиот одговор од 18 декември 2008 година, кој може да се најде на адресата <http://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/TFYR%20of%20Macedonia.pdf>, во кој има информации за евидентирани кривични дела и стапки на криминал за 2006 година. Погледнете и Биро за попис на САД, табела 297 – Стапки на криминал по држави, за 2006 и 2007 година, како и според видот, за 2007 година, кој содржи статистички податоци за криминалот во Соединетите Американски Држави во 2006-2007 година и стапките на криминал во Ново Мексико за 2006 и 2007 година, за регистрираните кривични дела, како и процена за бројот на оние кои не биле пријавени.

²⁰² Погледнете го одговорот на државата во однос на Планот за оцена на судските системи за 2007 година, прашање 6, страница 3, оцена спроведена од страна на Европската комисија за ефикасност на правдата (CEPEJ), кој може да се најде на адресата http://www.coe.int/t/dghl/cooperation/cepej/evaluation/2008/ERYM_en.pdf. Вреди да се напомене дека вкупниот државен буџет го вклучува буџетот на сите судови во земјата, како и буџетот на Академијата за обука на судии и јавни обвинители. Погледнете погоре за Ново Мексико, Лин Лангтон (Lynn Langton) и д-р Доналд Фарол (Donald Farole) помладиот, страница 4, каде се наведува дека вкупните судски и правни трошоци во државата Ново Мексико за 2007 година изнесувале 235 445 000 американски долари. Конверзијата на овој износ од американски долари во евра беше направена врз основа на просечниот годишен курс за 2007 година за промена на евра во долари од 0,731 евра за 1 долар, утврден од Управата за јавни приходи на САД, односно стапките, кои може да се погледнат на следнава адреса: <http://www.irs.gov/businesses/small/international/article/0,,id=206089,00.html>.

²⁰³ Погледнете го погоре посочениот одговор на државата во однос на Планот за оцена на судските системи за 2007 година, прашање 13, страница 5. Во објаснувањето на страница 6 е наведено дека одвоениот буџет за правна помош ги вклучува и средствата предвидени за исплата на вештачења и вешти лица. За Ново Мексико, погледнете: Лин Лангтон (Lynn Langton) и д-р Доналд Фарол (Donald Farole) помладиот, страница 4, каде се наведува дека вкупните судски и правни трошоци во државата Ново Мексико за 2007 година, изнесувале 235 445 000 американски долари. Конверзијата на овој износ од американски долари во евра беше направена врз основа на просечниот годишен курс за 2007 година за промена на евра во долари од 0,731 евра за 1 долар, утврден од Управата за јавни приходи на САД.

предмети и 22 за други предмети²⁰⁴ – додека во Ново Мексико за истиот период во 2007 година таква помош е обезбедена во 72 740 случаи).²⁰⁵

Сепак, краткото запознавање со ОЈБ во Ново Мексико укажува дека земјата-домаќин ќе мора да вложи значителни напори за да воспостави сопствена ПЈБ. Во оваа фаза, со новиот ЗКП, кој стапува во сила дури во 2012 година, би можело да биде невозможно да се расправа и да се залага за воспоставување на еден сличен институт, ниту, пак, истиот целосно да се отфрли. Во контекст на новиот ЗКП може да се разговара за важните лекции кои можат да се научат од американскиот модел. Идејата, според која истражителите ќе им помагаат на бранителите по службена должност во работата, е една од опциите кои бараат понатамошна разработка, иако може да се јави легитимна загриженост во врска со финансирањето на една таква можност, како и во однос на ангажирањето и обуката на ваквите приватни истражители итн.

Уште една работа која заслужува внимание во завршните заклучоци е и правото на обвинетите да бидат присутни на судењето. Како што беше објаснето и погоре во текстот, судењето во отсуство се смета за исклучок и не секогаш значи и повреда на правото да се биде присутен на судскиот процес, сè додека постојат соодветни мерки на заштита, за гарантирање на правично судење, вклучувајќи ја и можноста за повторно судење и застапување на отсушниот обвинет од страна на бранител. Во секој случај, новиот ЗКП предвидува и ситуации во кои судењето може да се одвива и во отсуство на обвинетиот, иако таквите случаи не можат навистина да се сметаат како формално судење во отсуство и поради тоа не се предвидени никакви мерки на заштита. Истите можат да се најдат во случајот на скратената постапка и нарушувачкото однесување на обвинетиот за време на судењето. Имајќи предвид дека за истите не се предвидени дополнителни мерки на заштита, тие можат да се оквалификуваат како кршење на правото за правично судење. Со цел да се надмине ваквата ситуација, би било препорачливо да се поведе соодветна законодавна иницијатива од страна на овластените службени лица.

Постои и уште едно прашање, за кое е потребно решение, во контекст на правната помош за сиромашните обвинети лица во земјата-домаќин. Иако

²⁰⁴ Погледнете го одговорот на државата во однос на Планот за оцена на судските системи за 2007 година, прашање 24, страница 9.

²⁰⁵ Погледнете: Лин Лангтон (Lynn Langton) и д-р Доналд Фарол (Donald Farole) помладиот, страница 4.

мнозинството од практичарите со кои имавме можност да разговараме истото не го сметаа за некој поголем проблем, недоволната јасност и прецизност на критериумите, кои се користат за утврдување на материјалната неспособност и квалификуваност за правна помош, се чини дека е едно од прашањата кои ќе треба да бидат разрешени во иднина. Имајќи предвид дека Законот за бесплатна правна помош дефинира јасни и прецизни услови во однос на квалификуваноста за правна помош во граѓански и управни постапки (и во кривични предмети за тужителот), законодавецот треба да размисли за можноста за воведување на јасни граници или критериуми за утврдување на материјалната неспособност на обвинетите во кривичните постапки, покрај веќе постојниот концепт на „интерес на правдата“.

Имајќи предвид дека новиот ЗКП беше донесен неодамна, а неговото стапување во сила е одложено за понатаму, евентуалните дополнителни дискусии на овие теми меѓу практичарите би биле добредојдени. Сите различни размисли презентирани во ова истражување имаат за цел да поттикнат едно континуирано размислување и дебата за пронаоѓање на најдобриот начин за гарантирање и остварување на правото на бранител за сите граѓани.

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

343.121.4(497.7)

343.121.4.05

ГАРАНТИРАЊЕ на правото на правен советник : компаративна пракса
во обезбедувањето правна помош во кривичните предмети. - Скопје :
ОБСЕ, 2010. - 214 стр. ; 21 см

Текст на мак., алб., и англ. јазик. - Фусноти кон текстот. - Содржи и:

Ensuring the right to legal counsel

ISBN 978-608-4630-12-8

а) Правна помош - Кривична постапка - Македонија б) Правна помош -
Кривична постапка - Компаративни истражувања

COBISS.MK-ID 86482442

Ky botim nuk ka për qëllim të zëvendësojë këshilimin juridik. Misioni Vëzhgues i OSBE-së në Shkup ka marrë të gjitha masat që informacioni që përmbahet në këtë botim është i saktë dhe i përditësuar; asnjë përgjegjësi nuk pranohet për ndonjë gabim ose mungesë informacioni.

Të drejtat e autorit:
Misioni Vëzhgues i OSBE-së në Shkup
Oktomvriska Revolucija pn
Shkup
www.osce.org/skopje

**SIGURIMI I TË DREJTËS PËR
MBROJTËS LIGJOR:
Praktikat komparative në
sigurimin e ndihmës juridike
në çështjet penale**

Dhjetor 2010



Organization for Security and
Co-operation in Europe
Spillover Monitor Mission to Skopje

Falenderime

Ky material kërkimor u shkrua dhe redaktua nga stafi i Divizionit të Reformës Gjyqësore pranë Misionit Vezhgues të OSBE-së në Shkup (Departmenti i Sundimit të së Drejtës):

Penelopa Gjurchilova
Romana Macesic
Ljubica Mishevsk
Meriton Pajaziti
Rezarta Schuetz
Nathalie Tran

Divizioni i Reformës Gjyqësore përfiton nga rasti t'i shprehë mirënjohjen e vet gjithë juristëve që u intervistuan në procesin e përgatitjes së këtij botimi. Kontributi i tyre ishte vecanërisht i vlefshëm për këtë material kërkimor.

■ PËRMBAJTJA

KAPITULLI 1. PARIMET FUNDAMENTALE QË KANË TË BËJNË ME TË DREJTËN DHE PRAKTIKAT PËR NDIHMË JURIDIKE15

1.1. E DREJTA PËR MBROJTËS JURIDIK	15
1.1.1. Ligji i Maqedonisë	15
1.1.2. Ligjet ndërkombëtare dhe krahasuese	16
▪ Ligji Kroat	16
▪ Ligji Amerikan	16
▪ Ligji i Francës.....	17
▪ E drejta ndërkombëtare	17
▪ Standarde të zbatuara nga Tribunalet Ndërkombëtare	19
1.2. MBROJTËSI I OBLIGUESHËM LIGJOR	22
1.2.1. Ligji i Maqedonisë	22
1.2.2. Ligjet ndërkombëtare dhe krahasuese	23
▪ Ligji i Kroacisë	23
▪ Ligji i Francës.....	24
▪ Standarde ndërkombëtare: rregullat dhe praktikat e GJNPJ-së	25
1.3. E DREJTA PËR VETË-PËRFAQËSIM	25
1.3.1. Ligji i Maqedonisë	26
1.3.2. Ligjet ndërkombëtare dhe krahasuese	26
▪ Ligji i SHBA	26
▪ Ligji i Francës.....	27
▪ Standardet ndërkombëtare	27
▪ Praktika e GJNPJ-së.....	27

1.4. GJYKIMI NË MUNGESË SI NJË PËRJASHTIM	28
1.4.1. Ligji i Maqedonisë	29
1.4.2. Ligjet ndërkombëtare dhe krahasuese	34
▪ Ligji kroat.....	34
▪ Ligji amerikan	35
▪ Ligji i Francës.....	35
▪ Jurisprudenca e GJEDNJ-së	36
▪ Rregullativat dhe praktikat e gjykatave ndërkombëtare penale	37

KAPITULLI 2. E DREJTA PËR NDIHMË LIGJORE FALAS: KORELACION ME TË DREJTËN PËR MBROJTËS LIGJOR.....41

2.1. TEORIA DHE PRAKTIKA	41
2.1.1. Modeli i Maqedonisë	41
2.1.2. Modelet ndërkombëtare dhe krahasuese.....	46
▪ Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut dhe praktika e Gjykatës	46
▪ Pikat kryesore të modelit të Kroacisë	49
▪ Modeli amerikan: Zyra e mbrojtësit publik	51
▪ Modeli i Francës.....	58
▪ Modeli ndërkombëtar i juridiksionit penal: shembull nga GJNPJ	63
2.2. EMËRIMI I MBROJTËSVE EX-OFFICIO (ZYRTARË)	65
2.2.1. Ligji i Maqedonisë	65
2.2.2. E drejta ndërkombëtare dhe krahasuese	71
▪ Modeli Amerikan	71
▪ Pasqyrë e një sistemi të specializuar nga rajoni: lista e posaçme e Kroacisë për ex-officio emërimet në rastet e krimeve të luftës	74
▪ Modeli i Francës.....	75
▪ Modeli i juridiksionit ndërkombëtar penal	77

KONKLuzion.....81

■ HYRJE

Ky hulumtim ka për qëllim t'i shqyrtojë aspektet e ndryshme të së drejtës për mbrojtje përkatëse, me fokus të veçantë në qasjen përkatëse për personat e varfër për mbrojtje në lëndët penale.¹ Qëllimi i tij primar është për ta ndihmuar diskutimin mbi këto tema në prag të miratimit të Ligjit të ri për procedurë penale (LPP).² Objektivi sekondar i hulumtimit është shqyrtimi dhe identifikimi i rolit të avokatëve ex-officio (në sajë të detyrës zyrtare) të mbrojtjes në rastet e krimeve të ndërlikuara. Termi "krim kompleks" ose "krim i rëndë" i përdorur për qëllimet e këtij hulumtimi është më tepër i konotacionit praktik sesa i një koncepti juridik. Kjo ju referohet rasteve nën juridiksionin e Departamentit të Krimin të Organizuar të Gjykatës Themelore- Shkup 1, si dhe rasteve të tjera me situata komplekse faktike, me shumë të pandehur, avokatë të mbrojtjes ose raste të së cilat për arsye të publicitetit të lartë ose kërcënimit ndaj sigurisë, paraqesin raste të profilit të lartë.

Kërkimi hapet me dinamikë të sfidave që shoqërohen me të drejtë për mbrojtje në kontekstin e mbrojtjes së detyruar, përballë ose përveç vetë përfaqësimit dhe gjykimeve në mungesë. Në pjesën e dytë paraqitet një përmbledhje e modeleve të ndryshme të ofrimit të ndihmës juridike për të pandehurit e varfër e përcjellë me diskutim mbi sistemin vendor. Modelet e shqyrtuara të ndihmës juridike vijnë nga shteti -pritës, Kroacia, Shtetet e Bashkuara, Franca dhe nga gjykatat ndërkombëtare penale. Praktika e gjykatave ndërkombëtare penale, sidomos të Gjykatës Ndërkombëtare Penale për ish – Jugosllavinë (GJNPJ), është analizuar në kontekstin e këtij hulumtimi si një shembull standard dhe për qëllime krahasuese, veçanërisht në bazë të mandatit të tyre të veçantë sepse gjykatat ndërkombëtare ofrojnë masa shumë të dobishme mbrojtëse që mund të shërbejnë si një referencë.

Gjithashtu do të rishikohet praktika e sigurimit të mbrojtjes në sajë të detyrës zyrtare në rastet e krimeve të ndërlikuara sipas LPP-së së vitit 2005. Zakonisht, rastet komplekse penale krijojnë një situatë më komplekse faktike, dënime të shqiptuara më të larta, sasi më të lartë të provave, dëshmitarë, të pandehur dhe avokatë mbrojtës të shumëfishtë. Si pasojë, këto gjykime shtrihen gjatë një peri-

¹ Në këtë hulumtim, për ta lehtësuar leximin mashkullorja përfshin femëroren dhe njëjësja përfshin shumësen dhe vice versa (anasjelltas).

² Në kohën e finalizimit të këtij hulumtimi në Nëntor të vitit 2010, Ligji i ri për procedurë penale (LPP i ri) ishte posa i miratuar nga Parlamenti Maqedonas ("Gazeta Zyrtare" nr. 150 e datës 18 Nëntor të vitit 2010). Shqyrtimi i situatës aktuale – përderisa pritet të hyjë në fuqi i Ligjit të ri në vitin 2012, i cili ka periudhë përgatitore dyvjeçare të paraparë deri në hyrjen në fuqi - i referohet situatës e cila është ende sipas Ligjit për procedurë penale të vitit 2005 (LPP 2005), "Gazeta Zyrtare Nr. 15/2005".

udhe më të gjatë të krahasuara me rastet e rregullta penale dhe bartin një rrezik më të lartë gjatë mungesës së palëve, veçanërisht të të pandehurit(ve) dhe mbrojtësit(ve) të tyre ligjorë. Për t'i korrigjuar vonesat e pajustificuara dhe/ose të tepruara, gjyqtari priret t'i përdorë emërimet ex-officio për të pandehurit para gjykimit ose për të pandehurit në mungesë.

METODA

Ky hulumtim është i bazuar në autoritetet primare dhe sekondare. Autoritetet primare i përfshijnë traktatet ndërkombëtare, legjislacionin vendor, vendimet e gjykatave ndërkombëtare, statutet dhe rregullat dhe procedurat e gjykatave ndërkombëtare. Autoritetet sekondare përfshin artikuj të ligjit, burime elektronike, manuale të praktikuesve dhe intervista me praktikuesit të ligjit nga vendi.

Me që hulumtimi pasqyron mendimet personale, sqarimet apo informacionet që mund ta zbulojnë identitetin e të intervistuarve qëllimisht janë mënjanuar. Grupi i të intervistuarve përfshin 16 praktikues nga mbarë vendi, shtatë avokatë mbrojtës, tetë gjyqtarë (nga të cilët tre janë kryetarë të gjykatave) dhe një prokuror.

KAPITULLI 1.

PARIMET FUNDAMENTALE QË KANË TË BËJNË ME TË DREJTËN DHE PRAKTIKAT PËR NDIHMË JURIDIK

1.1. E DREJTA PËR MBROJTËS JURIDIK

Zakonisht ndihma juridike është e materializuar përmes sigurimit të mbështetjes profesionale në angazhimin me çështjet ligjore. Kurdo që të jenë nisur procedurat gjyqësore, ndihma juridike është e barabartë me të drejtën për ta pasur ndihmën e mbrojtësit ligjor. E drejta e fundit është parim themelor i cili është i njohur në të gjitha tekstet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut si një e drejtë e mbrojtjes dhe një parim themelor për zhvillimin e gjykimit të drejtë.

1.1.1. LIGJI I MAQEDONISË

Sipas ligjit vendor, të gjithë që janë të akuzuar për një vepër penale (të dyshuar, të akuzuar dhe të akuzuar të shkallës së parë) kanë të drejtë për avokat³ dhe autoritetet janë të detyruara ta informojnë individin të thirrur, të arrestuar ose të privuar nga liria për të drejtën e këtillë. E drejta për mbrojtje e përfshin të drejtën për tu mbrojtur personalisht ose përmes një avokati mbrojtës në sajë të zgjedhjes vetanake, mandej të drejtën për të pasur kohë të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes dhe për ta prezantuar atë para një gjykate të paanshme. Kushtetuta thotë se, *“Personat e thirrur, arrestuar ose të paraburgosur menjëherë do të informohen për arsyet e thirrjes, arrestimit, paraburgimit si dhe për të drejtat e tyre. Mbi ta nuk duhet të ushtrohet forcë për të dhënë deklaratë. Një person ka të drejtë për avokat në procedurën policore dhe gjyqësore“*⁴

³ Shih nenet 69, 70 dhe 71 të LLP të ri. Shih gjithashtu nenet 4, 63 dhe 66 të LPP-së të vitit 2005.

⁴ Shih nenin e 12 (3) të Kushtetutës, “Gazeta Zyrtare” nr. 52/2001.

1.1.2. LIGJET NDËRKOMBËTARE DHE KRAHASUESE

▪ Ligji Kroat

Kodi penal i Kroacisë⁵ parasheh se i akuzuari ka të drejtë për mbrojtje ligjore para dhe gjatë procedurës penale. Para marrjes së parë në pyetje, i akuzuari duhet të informohet për të drejtën e tij që të ketë një avokat që do ta ndihmojë dhe që do të jetë i pranishëm gjatë marrjes në pyetje.

▪ Ligji Amerikan

Në Shtetet e Bashkuara e drejta për mbrojtës juridik në çështjet penale është sanksionuar në Amendamentin e gjashtë të Kushtetutës së Shteteve të Bashkuara. Amendamenti i gjashtë thekson:

“Në të gjitha ndjekjet penale, personi i akuzuar gëzon të drejtën që ndaj tij të zhvillohet një proces gjyqësor i shpejtë dhe i hapur, i kryesuar nga një juri e paanshme, e atij shteti apo distrikti ku është kryer krimi dhe ku janë zhvilluar më parë hetime përmes rrugës ligjore; personi i akuzuar gëzon gjithashtu të drejtën që të njoftohet me natyrën dhe arsyen e akuzës; do të ballafaqohet me dëshmitarët që dëshmojnë kundër tij; do të ketë proces të ku do të sigurohen dhe merren për të dëshmuar dëshmitarët të cilët do të dëshmojnë në favor të tij si dhe do të ketë ndihmën e Avokatit gjatë mbrojtjes së tij”.

Megjithatë, mbrojtja e dhënë nga Amendamenti i Gjashtë është efektive pas ngritjes së akuzave formale. Për fazat e hershme të procedurës, e tillë siç është ndalja në polici, i dyshuari ende mund të ketë qasje në ndihmën e një avokati në saje të interpretimit të Amendamentit të Pestë nga Gjykata e Lartë e Shteteve të Bashkuara në lidhje me atë që i takon në të drejtat procesuale në saje të Amendamentit të Pestë⁶ sipas rastit përkufizues Miranda kundër Arizonës.⁷

⁵ Ligji i ri për procedurë penale është miratuar më 28 dhjetor të vitit 2008. Shumica e dispozitave të tij do të hynë në fuqi më 1 shtator të vitit 2011, pa marrë parasysh se një numër i tyre tanimë kanë hyrë në fuqi në mes të vitit 2009.

⁶ Shih Amendamentin e Pestë të Kushtetutës së Shteteve të Bashkuara i cili thekson “Askush nuk mund të mbajë përgjegjësi për një krim të rëndë apo për një akt tjetër që dënohet pa deklaratën apo aktakuzën e një jurie të lartë, me përjashtim të atyre rasteve që lindin në radhët e Forcave tokësore e detare ose Forcave të mbrojtjes territoriale gjatë shërbimit aktiv në kohë lufte ose në gjendje gatishmërie; askush nuk mund të gjykohej dy herë për të njëjtën shkelje të ligjit e as ti vihet në rrezik jeta; as nuk mund të detyrohet të dëshmojë kundër vetvetes në një çështje penale e as të privohet nga liria dhe pasuria pa u zhvilluar një proces i rregullt gjyqësor.; askujt nuk mund ti merret për përdorim publik prona private pa zhdëmtim përkatës”.

⁷ Shih Miranda kundër Arizonës, 384 U.S. 436, 86 S. Ct. 1602, (1966).

▪ Ligji i Francës

Sipas nenit paraprak të Kodit të Procedurës Penale të Francës, çdo individ i dyshuar ose i akuzuar për kryerjen e një vepre penale ka të drejtë për ndihmën e mbrojtësit juridik.⁸ E drejta për mbrojtje juridike për këtë arsye është e zbatueshme që nga fillimi, siç është marrja në pyetje nga policia e deri në marrjen kryesore në pyetje. Personi i dyshuar apo i paditur, ndër të tjera, e gëzon të drejtën për t'u informuar për akuzat e ngritura kundër tij.⁹ Është e rëndësishme të theksohet se ajo e drejtë themelore e mbrojtjes gjithashtu është e njohur edhe përmes të drejtave të garantuara nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut e cila, si një konventë ndërkombëtare e ratifikuar nga shteti i Francës, është pjesë e ligjit të Francës.¹⁰

▪ E drejta ndërkombëtare

E drejta për një mbrojtës ligjor përbën një nga të drejtat themelore juridike të individëve - sidomos në rastet penale. Kjo e drejtë është e sanksionuar në të gjitha burimet esenciale të së drejtës ndërkombëtare. Ky është një nga parimet e parimit të barazisë së mjeteve para gjykatave.¹¹ Tekstet e mëposhtme ndërkombëtare e nxjerrin në pah rëndësinë e veçantë të kësaj të drejte.

Konventa Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive themelore të Njeriut (KEDNJ)¹²

*Neni 6- E drejta për gjykim të drejtë*¹³

*3. Çdokush që është i ngarkuar me akuzë penale i ka të drejtat vijuese minimale:
[...]*

⁸ Shih nenin paraprak ndaj Kodit për procedurë penale të Francës, versioni i konsoliduar i 14 nëntorit të vitit 2010.

⁹ Shih po ashtu nenin paraprak ndaj Kodit për procedurë penale të Francës.

¹⁰ Shih nenin 53 të Kushtetutës së Francës të 4 tetorit të vitit 1958.

¹¹ Shih në përgjithësi: Komiteti i të Drejtave të njeriut (KDNJ), Komenti i përgjithshëm 32 [90] në nenin 14, paragr. 10, të miratuar më 24 korrik 2007.

¹² Konventa Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive themelore të Njeriut (KEDNJ), që i është e nënshtruar plotësisht me dispozitat e protokollit nr. 14 (Zyra për Marrëveshje e Këshillit të Evropës – ZMKE nr. 194) që kanë hyrë në fuqi më 1 qershor të vitit 2010.

¹³ Neni 6 të i KEDNJ-së: “E drejta për gjykim të drejtë”

1. Në përcaktimin e të drejtave dhe obligimeve civile të tij ose të ndonjë akuze penale kundër tij, çdokush ka të drejtë për gjykim të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e themeluar me ligj. Vendimi duhet të shpallet publikisht por shtypi dhe publiku mund të përjashtohen nga i tërë ose një pjesë e gjykimit në interes të sigurisë morale, rendit publik ose të sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve këtë e kërkojnë, ose në të zgjerohet në mënyrë strikte sipas mendimit të gjykatës në rrethanat e posaçme ku publiciteti do t'i prejudikonte interesat e drejtësisë.

2. Çdo person që është me akuzë penale do të konsiderohet i pafajshëm deri në dëshmimin e të kundërtës në pajtim me ligjin.

(c) ta mbrojtë veten vetë ose përmes mbrojtësit juridik mbi zgjedhjen e bërë nga vetë ai ose, nëse nuk ka mjete të mjaftueshme të paguajë mbrojtje juridike, ajo t'i ofrohet falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë [...]

Marrëveshja Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike¹⁴

Neni 14¹⁵

3. Në përcaktimin e çfarëdo akuze penale kundër tij, çdokush ka të drejtë në garancitë vijuese minimale, në barazi të plotë:

3. Çdo person i akuzuar me akuzë penale i ka të drejtat vijuese minimale:

(a) të informohet menjëherë, në gjuhën të cilën ai e kupton dhe në mënyrë të detajuar, për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij;

(b) të ketë kohë dhe mjete përkatëse për përgatitjen e mbrojtjes së tij;

(c) ta mbrojtë veten vetë ose përmes mbrojtësit juridik mbi zgjedhjen e bërë nga vetë ose, nëse ai nuk ka mjete të mjaftueshme ta paguajë t'i sigurohet falas kur interesat e drejtësisë e kërkojnë kështu;

(d) të marrë në pyetje ose t'i ketë marrë në pyetje dëshmitarët kundër tij dhe ta kërkojë praninë dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në favor të tij sipas kushteve të njëjta si dëshmitarët kundër tij;

(e) ta ketë ndihmën falas të përkthyesit nëse ai nuk mund ta kuptojë ose ta flasë gjuhën që përdoret në gjykim.”

¹⁴ Marrëveshja ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (MNDCP), e miratuar dhe e hapur për nënshkrim, ratifikim dhe aderim nga Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 2200A (XXI) të 16 dhjetorit të vitit 1966, që ka hyrë në fuqi më 23 mars të vitit 1976.

¹⁵ Nenin 14 i MNDCP-së thekson me sa vijon:

“1. Të gjithë personat do të jenë të barabartë para gjykatave dhe tribunaleve. Në përcaktimin e çdo akuze penale kundër tij, ose të të drejtave dhe detyrimeve të tij në pajtim me ligjin, çdokush ka të drejtë për gjykim të drejtë dhe publik nga një gjykatë kompetente, të pavarur dhe të paanshme të themeluar në saje të ligjit. Media dhe publiku mund të përjashtohen nga i tërë apo nga një pjesë të gjykimit për shkak të moralit, rendit publik (ordre public) ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, ose atëherë kur interesat e jetës private të palëve këtë kështu e kërkojnë, ose në opinion të përhapet aq që sipas mendimit të gjykatës në rrethanat e posaçme publiciteti do t'i prejudikonte interesat e drejtësisë; çdo vendim i bërë në një rast penal apo në një padi në përputhje me ligjin do të bëhen publike por me përjashtim kur interesi i personave të mitur përndryshe këtë e kërkojnë ose kur procedurat kanë të bëjnë me konteste martesore ose tutorinë e fëmijëve.

2. Çdokush i akuzuar me akuzë për vepër penale do të ketë të drejtë të konsiderohet i pafajshëm përderisa nuk i dëshmohet faji në pajtim me ligjin.

3. Në përcaktimin e çfarëdo akuze penale kundër tij, çdokush ka të drejtë në garancitë vijuese minimale, plotësisht të barabarta:

(a) Të informohet menjëherë dhe në detaje në gjuhën të cilën e kupton për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij;

(b) Të ketë kohë dhe mjete të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes së tij dhe të komunikojë me mbrojtës që e ka marrë në sajë të zgjedhjes së tij;

(c) Të gjykohet pa vonesë të tepruar;

(d) Të gjykohet në prezencën e tij, dhe të mbrohet vetë ose me ndihmën e mbrojtësit juridik në sajë të zgjedhjes së tij; të jetë i informuar, në qoftë se ai nuk ka ndihmë juridike, për këtë të drejtë të tij; dhe të ketë ndihmë juridike që i është caktuar, në çdo rast kur

(d) Të gjykohet në prezencën e tij, dhe të mbrohet vetë ose me ndihmën e mbrojtësit ligjor në saje të zgjedhjes së tij; të jetë i informuar, në qoftë se ai nuk ka ndihmë juridike, të kësaj të drejte të tij; dhe të ketë ndihmë juridike që i është caktuar, në çdo rast kur interesat e drejtësisë e kërkojnë këtë dhe pa pagesë nga ai në rastin kur ai nuk ka mjete të mjaftueshme për ta paguar atë, [...]

E drejta për avokat ligjor është fiksuar në kuadër të konceptit të përgjithshëm të së drejtës për gjykim të drejtë e cila gjithashtu siguron garanci specifike në rastet penale, të tilla si e drejta për t'u informuar për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij/saj; të drejtën për të pasur kohë të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes së tij/saj, të drejtën për marrje në pyetje të dëshmitarëve dhe të drejtën për tu ndihmuar me përkthyes.¹⁶

▪ Standarde të zbatuara nga Tribunalet Ndërkombëtare

Rregullat e zbatueshme për gjykatat e ndryshme ndërkombëtare që përfshijnë të drejta të ngjashme për personat e akuzuar për krime ndërkombëtare.

interesat e drejtësisë këtë e kërkojnë, dhe pa pagesë nga ai në rast të tillë nëse ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të paguar për atë;

(e) Të marrë në pyetje ose t'i ketë marrë në pyetje dëshmitarët kundër tij dhe të kërkojë praninë dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në favor të tij sipas kushteve të njëjta si dëshmitarët kundër tij;

(f) Ta ketë ndihmën falas të përkthyesit nëse ai nuk mund ta kuptojë ose ta flasë gjuhën që përdoret në gjykim;

(g) Të mos detyrohet të dëshmojë kundër vetes ose ta pranojë fajin.

4. Në rast të personave të mitur, procedura do të jetë e tillë që do të marrë parasysh moshën e tyre dhe dëshirën për ta promovuar rehabilitimin e tyre.

5. Çdokush i akuzuar për krim do të ketë të drejtë që akuza dhe dënimi e tij të shqyrtohen nga një gjykatë më e lartë në pajtim me ligjin.

6. Kur një person nga një vendim përfundimtar se ka qenë i dënuar për një veprë penale dhe kur më pas dënimi i tij ka qenë i kundërt ose ai ka qenë i falur me arsyetimin se një fakt i ri ose fakte më të reja të zbuluara më vonë tregojnë përfundimisht se nuk ka pasur gabim gjyqësor, personi i cili e ka vuajtur dënim si rezultat i vendimit të tillë do të kompensohet në pajtim me ligjin, përveç nëse është dëshmuar se mos-zbulimi i faktit të panjohur në kohën e caktuar tërësisht ose pjesërisht i atribuohet atij.

7. "Askush nuk mund të ndiqet ose të dënohet sërish për një veprë për të cilën ai tanimë ka qenë i akuzuar ose i dënuar sipas ligjit dhe procedurës penale të çdo vendi."

¹⁶ Shih më sipër, nenin 6 nga KEDNJ dhe nenin 14 nga MNDPCP.

Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare Penale për ish – Jugosllavinë (GJNPJ)

Neni 21- Të drejtat e të akuzuarve¹⁷

4. Në përcaktimin e çdo akuze kundër të akuzuarit në bazë të këtij Statuti, i akuzuari ka të drejtë në garancitë e mëposhtme minimale, plotësisht të barabarta:

[...]

(d) të gjykohet në prezencën e tij, dhe ta mbrojë vetë vetveten ose përmes mbrojtësit në saje të zgjedhjes vetanake; të informohet për këtë të drejtë nëse nuk ka mbrojtës ligjor; dhe të ketë mbrojtje ligjore që i është caktuar, në çdo rast kur interesat e drejtësisë e kërkojnë këtë, po dhe pa pagesë nga ana e tij në rastin kur ai nuk ka mjete të mjaftueshme që atë ta paguajë [...]

¹⁷ “1. Të gjitha personat do të jenë të barabartë para Tribunalit Ndërkombëtar.

2. Në përcaktimin e akuzave kundër tij, i akuzuari për gjykim të drejtë dhe publik, Në pajtim me nenin 22 të Statutit.

3. I akuzuari do të konsiderohet i pafajshëm deri në dëshmimin e fajësisë së tij në pajtim me dispozitat e këtij Statuti.

4. Në përcaktimin e çfarë do qoftë akuze kundër të akuzuarit në pajtim me këtë Statut, i akuzuari ka të drejtë në garancitë e mëposhtme minimale, plotësisht të barabarta:

(a) të informohet shpejtë dhe në mënyrë të detajuar në gjuhën që ai e kupton për natyrën dhe shkakun të akuzës kundër tij;

(b) të ketë kohë të mjaftueshme për ta përgatitur mbrojtjen e vet dhe të komunikojë me avokatin që e ka zgjedhur vetë;

(c) të gjykohet pa vonesë të panevojshme;

(d) të gjykohet kur është i pranishëm dhe të mbrohet vetë ose nëpërmjet mbrojtësit ligjor të zgjedhur prej tij; të informohet, për këtë të drejtë nëse ai nuk ka mbrojtës juridik; dhe të ketë ndihmë juridike që i është dhënë, në secilin rast kur interesat e drejtësisë kërkojnë kështu, dhe pa pagesë nga ai në cilin do rast të tillë në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme të paguajë për atë;

(e) të marrë në pyetje ose t'i ketë marrë në pyetje dëshmitarët kundër tij dhe ta kërkojë paraqitjen dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në favor të tij në të njëjtat kushte si dëshmitarët kundër tij;

(f) të ketë ndihmë falas të përkthyesit nëse ai nuk mund ta kuptojë ose të flet gjuhën e përdorur në Tribunalin Ndërkombëtar;

(g) të mos detyrohet të dëshmojë kundër vetvetes ose ta pranojë fajësinë.” nenin 21 të Statutit të TNPJ (Statuti i TNPJ), i miratuar më 25 Maj të vitit 1993 nga Rezoluta 827 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe të amendanduar më 29 qershor nga Rezoluta 1931 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Statuti i Romës i Gjykatës Ndërkombëtare Penale (GJNPR)

Neni 55-Të drejtat e individëve gjatë hetimit¹⁸

2. *Ku ka arsye të besohet se një person ka kryer një krim brenda juridiksionit të Gjykatës dhe se personi përgatitet të merret në pyetje ose nga prokurori, ose nga autoritetet kombëtare në bazë të një kërkesë të bërë sipas pjesës 9, ky person duhet gjithashtu t'i ketë të drejtat e vijuese për të cilat ai ose ajo duhet të informohet para se të merret në pyetje :*

[...]

(c) Të ketë ndihmë juridike sipas zgjedhjes së individit, ose, nëse individi nuk ka përfaqësues juridik, të ketë mbrojtës që i është përcaktuar atij ose asaj, në cilin do qoftë rast nëse interesat e drejtësisë kështu e kërkojnë dhe pa pagesë nga individi në çfarë do qoftë rasti të tillë, nëse individi nuk ka mjete të mjaftueshme për ta paguar avokatin [...]

Neni 63 - Gjykimi në prani të të akuzuarit

1. *I akuzuari duhet të jetë i pranishëm gjatë gjykimit.*

2. *Nëse i akuzuari, gjatë prezencës në sallën e Gjykimit, vazhdon ta pengojë gjykimin, Këshilli Gjyqësor mund ta largojë të akuzuarin dhe mund atij ose asaj t'ia bëjë të mundshme ta përcjellë gjykimin nga hapësira jashtë sallës së gjykimit*

¹⁸ "1. Në lidhje me ndonjë hetim në saje të këtij Statuti, një person:

(a) Nuk do të detyrohet ta inkriminojë veten ose ta pranojë fajësinë;

(b) Nuk do t'i nënshtrohet asnjë forme të presionit, detyrimit ose kërcënimit, torturës ose ndonjë formës tjetër të trajtimit apo dënimit mizor, jonjerëzor ose degradues;

(c) Duhet, në qoftë se merret në pyetje në një gjuhë tjetër që dallon nga gjuha që personi plotësisht e kupton dhe flet, ta ketë, i liruar nga çfarë do qoftë pagese, ndihmën e përkthyesit kompetent dhe përkthime të tilla që janë të nevojshme t'u përgjigjen kërkesave të drejtësisë; dhe

(d) Nuk do t'i nënshtrohet arrestit apo ndaljes arbitrare dhe nuk do të privohet nga liria e tij ose e saj, përveç në baza të tilla dhe në përputhje me procedurat e tilla siç janë të përcaktuara në këtë Statut.

2. Aty ku ka arsye për të besuar se një person ka kryer një krim brenda juridiksionit të Gjykatës dhe se personi duhet të merret në pyetje ose nga prokurori, ose nga autoritetet kombëtare në bazë të një kërkesë të bërë sipas pjesës 9, ky person duhet gjithashtu t'i ketë të drejtat vijuese të cilat ai ose ajo duhet të informohet para se të merret në pyetje:

(a) Të informohet, para se të merret në pyetje, se ka baza për të besuar se ai ose ajo ka kryer krim brenda juridiksionit të Gjykatës;

(b) Të hesht, duke mos u marrë në konsideratë kjo heshtje në përcaktimin e fajit ose të pafajësisë;

(c) Të ketë ndihmë juridike sipas zgjedhjes së personit, ose, nëse personi nuk ka ndihmë juridike, atij ose asaj t'i caktohet ndihmë juridike, në çdo rast kur interesat e drejtësisë këtë e kërkojnë, dhe pa pagesë nga personi në rast se personi nuk ka mjete të mjaftueshme ta paguajë; dhe

(d) Të merret në pyetje në prani të mbrojtësit përveç nëse personi vullnetarisht ka hequr dorë nga e drejta e tij ose e saj për avokat.", neni 55 i Statutit të Romës për Gjykatën Ndërkombëtare Penale (Statuti i Romës), A/CONF.183/9, të adoptuar më 17 korrik të vitit 1998, e që ka hyrë në fuqi më 1 korrik të vitit 2002.

dhe ta udhëzojë avokatin përmes përdorimit të teknologjisë së komunikimit nëse kjo është e nevojshme. Masa të këtilla do të ndërmerren vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, pasi alternativat e tjera të arsyeshme që janë provuar janë treguar jo adekuate, dhe vetëm për kohëzgjatjen e tillë sa është e nevojshme.

1.2. MBROJTËSI I OBLIGUESHËM LIGJOR

Shumica e traditave, përfshirë edhe të gjitha këto të shqyrtuara këtu, sigurojnë ndihmë të obligueshme ligjore në rastet e specifikuar me ligj. Në këto raste, ndihmesa ligjore nuk është vetëm e drejtë por kusht *sine qua non* për vlefshmëri të procedurës. Rrethanat që mund të grupohen si ato në lidhje me shkallën e krimeve në fjalë ose në lidhje me të dyshuarin vetë e kërkojnë “mbrojtjen” e nevojshme të ofruar nga një mbrojtës ligjor.

1.2.1. LIGJI I MAQEDONISË

Ligji maqedonas parashikon se ndihma e mbrojtësit ligjor duhet të jetë e obligueshme për personin në rastet vijuese:¹⁹

- Në qoftë se i dyshuari ose i akuzuari është memec, shurdh ose i paaftë ta mbrojë me sukses veten, atëherë për atë prania e një avokati mbrojtës është e detyrueshme që nga marrja e parë në pyetje;
- Në qoftë se i dyshuari ose i akuzuari është i ngarkuar me një krim për të cilin me ligj është i paraparë dënimi me burgim të përjetshëm, prania e një avokati mbrojtës është e detyrueshme që nga marrja e parë në pyetje;
- Në qoftë se i dyshuari ose i akuzuari është në paraburgim, angazhimi i një avokati mbrojtës është e detyrueshëm për tërë kohëzgjatjen e paraburgimit;
- Në qoftë se një individ është i akuzuar për një krim për të cilin ligji parashikon burgim prej dhjetë vjet ose më shumë, angazhimi i një avokati mbrojtës është i detyrueshëm që nga momenti i dorëzimit të aktakuzës;
- Angazhimi i një avokati mbrojtës është i detyruar kur një i dyshuar ose i akuzuar është në fazë ndërmjetësimi ose ka lutje për arritjen e marrëveshjes për kohëzgjatjen e kësaj procedure. Kjo është një risi të LPP-në e ri kur bisedimet për ndërmjetësim dhe lutja për arritjen e marrëveshjes është bërë për herë të parë; Kjo është risi e LPP ku ndërmjetësimi – në këtë formë – dhe negocimi i akuzës janë parashtuar për herë të parë.

¹⁹ Shih nenin 74 të LPP-sëi. Shih gjithashtu nenin 66 të LPPsë të vitit 2005.

Angazhimi i avokatit mbrojtës është e detyrueshme për të akuzuarin që gjykohet në mungesë menjëherë pasi të miratohet një vendim i tillë.

Një nga risitë e paraqitura nga LPP është se viktimat e krimeve seksuale dhe ato të krimeve kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare kanë të drejtë për mbrojtje nga avokati pa pagesë kur marrin pjesë në procedimin si palë të dëmtuara para kryerjes së ndonjë ekzaminimi në të gjitha fazat e procedurës. Gjykata, prokurori dhe policia janë të detyruar ta informojnë viktimën për këtë të drejtë.²⁰

Shumica e praktikuesve të intervistuar të ligjit mendonin se rregullativat e mbrojtjes së detyrueshme janë shumë të qarta në LPP-në e ri dhe reale për tu zbatuar. Një numër i tyre megjithatë mendonin se ata kanë dështuar ose nuk e kanë bërë përcaktimin e të drejtave që i kanë prezantuar ose arsyetuar pas tyre.

Disa praktikues shprehën dyshime për qartësinë e dispozitës dhe ngritën pyetje për praktikën jo-konsistente të gjykatave në kërkimin e dokumenteve siç janë certifikata mjekësore dhe/ose raporte të ekspertëve, në varësi të llojit të paaftësisë. Sipas tyre, disa gjykata kërkojnë paraqitje të një numri të dokumenteve ndërsa të tjerët nuk kanë nevojë për dokumente mbështetëse.

Përveç kësaj, disa nga praktikuesit mendojnë se pragu prej dhjetë vjet burgim për të drejtën për mbrojtje të detyrueshme duhet të ulet për të përfshirë krime më të lehta. Ata gjithashtu konsiderojnë se mbrojtja e detyrueshme mund të caktohet më herët nga koha kur është ngritur një aktakuzë.

1.2.2. LIGJET NDËRKOMBËTARE DHE KRAHASUESE

▪ Ligji i Kroacisë

Prania e detyrueshme e avokatit mbrojtës që nga marrja e parë në pyetje është paraparë në këto raste:²¹

- Kur i dyshuari ose i akuzuari është memec, shurdh ose i paaftë ta mbrojë veten me sukses;
- Për akte penale në të cilat është paraparë burgim afatgjatë, nga dërgimi i urdhrin për ngritjen e hetimit deri në finalizimin e procedurës;

²⁰ Shih nenin 55 të LPP-së të ri.

²¹ Shih nenin 65 të LPP-së të vitit 2005.

- Nëse kundër të akuzuarit janë urdhëruar paraburgim ose paraburgim hetues²² avokati është i obligueshëm që nga momenti i lëshimit të vendimit për heqje të lirisë;
- Nga dorëzimi i aktakuzës deri sa të finalizohet procedura penale (pra, në fund të gjykimit) për krimet për të cilat është paraparë burgim prej 10 ose më shumë vjet;
- Nëse i pandehuri nuk ka avokat që e përcjell vendimin e gjykatës i cili e parandalon avokatin që të ndërmarrë veprime të veçanta ose përfaqësimin e klientit të tij²³;
- Gjatë vazhdës së negociatave për pranimin e fajësisë si dhe gjatë nënshkrimit të ndonjë marrëveshjeje që rrjedh nga marrëveshja për pranimin e fajësisë;
- Nga momenti kur është sjellë vendimi për mbajtjen e gjykimit në mungesë;
- Pasi është paditur ndonjë i akuzuar me të meta mendore;
- Atëherë kur i akuzuari është gjykuar në mungesë për shkak të sjelljes së tij obstruktive gjatë gjykimit.

Kapaciteti mendor i një të pandehuri në kohën e kryerjes së krimit dhe gjatë gjykimit çmohet nëpërmjet vlerësimit psikiatrik të urdhëruar nga gjykata. Psikiatri duhet të vlerësojë vallë i pandehuri është me probleme mendore dhe të japë mendim nëse ai është i aftë ta kuptojë natyrën dhe qëllimin e procedimeve penale të ngritura kundër tij, si dhe t'i kuptojë aktet specifike procedurale dhe pasojat e tyre, vallë mund të komunikojë me avokatin mbrojtës dhe ta udhëzojë këtë të fundit.

▪ Ligji i Francës

Ashtu siç u diskutua më herët, personi i dyshuar ose i akuzuar se ka kryer një vepër penale ka të drejtë për ndihmën e avokatit. I pandehuri mund të vendosë të heqë dorë nga kjo e drejtë dhe ai vetë ta përgatit mbrojtjen e tij. Megjithatë, ndihma e mbrojtësit ligjor kërkohet në saxe të ligjit në disa procedura dhe në rrethana të caktuara.

Ligji i Francës e parashikon ofrimin e mbrojtjes së obligueshme për një person të akuzuar në procedimet para *Cour d'Assises* (për akuza me krime të rënda) dhe në procedimet penale që i

²² Dallimi në mes paraburgimit dhe paraburgimit hetimor është se i pari është i urdhëruar paraprakisht nga prokurori publik dhe mund të zgjasë deri në 48 orë në fund të të cilave, përveç nëse nga gjykata nuk është urdhëruar paraburgim hetimor, i dyshuari lirohet. Paraburgimi hetimor është urdhëruar nga gjykata kompetente për një periudhë prej një muaji, në një kohë dhe mund të zgjatet deri në fund të gjykimit.

²³ Kur gjykatësit i është bërë e qartë se avokati propozon aktivitete që përsëriten dhe synon që ta prolongojë gjykimin [të tilla si marrje në pyetje të dëshmitarëve të rinj, të ekspertëve ose porositje të ekspertizave të reja,] gjykata pas paralajmërimit, mund edhe atij t'i kërkojë që ta braktis gjykimin. Shih nenin 11, Paragr. 3 të LPP-së të vitit 2005.

²⁴ Shih nenin 317 të Kodit për procedurë penale të Francës dhe nenin 4 të v. 1945, Rregullën në lidhje me delinkuentët e mitur të vitit 1945 (Ordonnance n°45-174 du 2 février 1945 relative à l'enfance délinquante).

përfshijnë të miturit.²⁴ Përveç kësaj kjo gjithashtu është parashikuar edhe për të rriturit e mbrojtur (p.sh., të rriturit aftësitë mendore ose fizike të të cilëve nuk ju lejojnë që ata vetë të kujdesen për nevojat e tyre dhe të cilët mund të përfitojnë nga masat e posaçme mbrojtëse).²⁵

Më tej, mbrojtësi i obligueshëm aplikohet në rastet e kundërvajtjes së tillë siç është “*comparution immediate*” (paraqitjen e menjëhershme), ku i pandehuri nxirret menjëherë në gjykatë në saje të pëlqimit të tij/saj të dhënë në praninë e avokatit, kur është i akuzuar për një vepër që sjell të paktën dy vjet burgim. Shembull i dytë flet për të pandehurin e kapur në *flagrant délit* [në aktin e flagrancës], në çrast kundërvajtja dënohet me jo më pak se gjashtë muaj burgim. Në çdo rast, prokurori duhet të paraqesë prova të mjaftueshme për të dëshmuar fajin dhe për t’u bindur se nxjerrja e tillë e menjëhershme e të pandehurit në gjykatë është e justifikuar.²⁶

Së fundi, mbrojtësi i obligueshëm është i siguruar në ekuivalentin francez të procedurës së pranimit të fajësisë ose “*sur comparution sur reconnaissance préalable de culpabilité*”, i cili është në dispozicion të të pandehurit për kundërvajtje që dënohen me maksimum pesë vjet burgim. Në këtë procedurë, i padituri nuk mund të heq dorë nga e drejta e tij për t’u ndihmuar nga përfaqësuesi ligjor.²⁷

▪ Standarde ndërkombëtare: rregullat dhe praktikat e GJNPJ-së

Neni 21 (4) d i Statutit të GJNPJ-së përcakton se i akuzuari para gjykatës ndërkombëtare mund të përfaqësohet ose nga avokati ose vetë. Tribunali ndërkombëtar për këtë arsye nuk i detyron të pandehurit të ndihmohen me avokat. Me që kjo çështje e veçantë në thelb është e lidhur për çështjen e vetë-përfaqësimit dhe për kufijtë e tij, për mbrojtësin e detyrueshëm ose të imponuar do të diskutohet në vijim.

1.3. E DREJTA PËR VETË-PËRFAQËSIM

Një atribut i të drejtës për gjykim të drejtë është e drejta për tu mbrojtur vetë [e drejtë për vetë-përfaqësim]. Për të qenë gjykimi i drejtë, të pandehurit duhet t’i jepet mundësia që të jetë i pranishëm në gjykimin e tij, t’i sfidojë pretendimet e palëve të tjera dhe të paraqesë mbrojtjen e tij/saj.

²⁵ Shih nenet 706-116 të Kodit për procedurë penale të Francës. Për më tepër informacione për regjimin ligjor për të rriturit e mbrojtur, shih prej nenit 425 deri 488 të Kodit civil të Francës.

²⁶ Shih nenet 394 deri 396 të Kodit për procedurë penale të Francës.

²⁷ Shih nenin 395-8 të Kodit për procedurë penale të Francës. Për më tepër për “*comparution sur reconnaissance préalable de culpabilité*”, shih nenet prej 495-7 deri 495-16 dhe 520-1 të Kodit për procedurë penale të Francës.

1.3.1. LIGJI I MAQEDONISË

Procedura penale maqedonase parasheh mundësinë që një i pandehur ta organizojë dhe ta paraqesë mbrojtjen e tij/saj vetë. Neni 4 i LPP-së të vitit 2005 përcakton që çdo i akuzuar ka të drejtë “të gjykohet në praninë e tij dhe të mbrohet vetë ose me ndihmë juridike” dhe të “jetë i pranishëm gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve dhe të jetë në gjendje t’i bëjë pyetje vetes”.²⁸ Neni 66 i kodit të njëjtë gjithashtu e sanksionon të drejtën e të akuzuarit/dyshuarit për përgatitjen e mbrojtjes vetanake.²⁹ Praktika ka treguar se në këso raste të akuzuarit janë vetë përgjegjës për mbrojtjen e tyre, nëse ata ashtu dëshirojnë.

1.3.2. LIGJET NDËRKOMBËTARE DHE KRAHASUESE

▪ Ligji i SHBA

Vetëpërfaqësimi ose *pro se* përfaqësimi është heqje dorë nga e drejta për avokat ku i pandehuri (ai/ajo) do ta përfaqësojë vetveten. Megjithatë, gjykatat zakonisht sigurojnë se heqja dorë nga e drejta e tij për avokat është bërë me dije, me vetëdije dhe vullnetarisht.³⁰

²⁸ Shih nenin n 4 paragr.2 të LPP të vitit 2005.

²⁹ Shih nenin n 66 të LPP të vitit 2005:

“(1) Në qoftë se i dyshuari ose i akuzuari është memec, shurdh ose i paaftë ta mbrojë me sukses veten ose zbatohet procedurë penale kundër tij për krim për të cilin, në sajë të Ligjit është përshkruar dënimi i përjetshëm, atëherë ai patjetër duhet të ketë mbrojtës gjatë marrjes së parë në pyetje.

(2) I pandehuri duhet patjetër të ketë një avokat në qoftë se parburgimi është përcaktuar kundër tij gjatë periudhës së ndaljes së tij.

(3) Pas aktpadsisë për një krim për të cilin me Kodin është përshkruar dënim deri në dhjetë vjet, e në rast të dënimit më të ashpër, i akuzuari duhet të ketë patjetër avokat në kohën e dorëzimit të aktpadsisë.

(4) Menjëherë sa është sjellë vendimi për gjykim në mungesë, i akuzuari (me nenin 292) patjetër duhet të ketë avokat.

(5) Në qoftë se i akuzuari në rastet e mbrojtjes së detyruar sipas paragrafëve paraprakë të këtij neni, nuk e siguron vetë mbrojtësin, Kryetari i gjykatës do të caktojë një avokat në sajë të detyrës zyrtare për kohëzgjatjen e mëtejshme të procedurës penale, deri në verdiktin fuqiptotë final ligjor. Kur të akuzuarit i është caktuar një avokat *ex officio* (sipas detyrës zyrtare) pas aktit të ndjekjes penale, ai do të jetë i informuar për këtë çështje si dhe për dorëzimin e aktakuzës.”

³⁰ Shih në përgjithësi vendimin e Gjykatës Supreme të SHBA-ve, Moran kundër Burbine 475 U.S. 412, 421, 106 S.Ct. 1135, (1986). Shih, gjithashtu, Almeida kundër Shtetit, 24 FLË S331, Gjykata Supreme e Floridës (1999).

▪ Ligji i Francës

Siç u tha më sipër, procedura penale e Francës i specifikon rrethanat në të cilat zbatohet mbrojtja e obligueshme. Jashtë nga këto raste, të pandehurit i lejohej që ta përfaqësojë veten dhe ta zbatojë mbrojtjen e tij ashtu siç është paraparë me nenin 6 (3) c. të Konventës Evropiane (shih më poshtë).

▪ Standardet ndërkombëtare

Sikurse praktikat e brendshme edhe ligji ndërkombëtar e rregullon të drejtën për mbrojtje. Ajo mund të realizohet me ndihmën e një mbrojtësi ligjor ose i pandehuri përfaqëson vetveten. E drejta e fundit – që ta refuzojë benefitin e ndihmës së një avokati dhe ta përfaqësojë vetveten – është pranuar në Konventën Evropiane, si dhe si MNDCP (Marrëveshje Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike).³¹ Megjithatë, e drejta për vetëpërfaqësim nuk është absolute. Në të vërtetë, ashtu si ka deklaruar Komiteti për të Drejtat e Njeriut:

*“Interesat e drejtësisë mund, në rastin e një gjykimi të veçantë, ta kërkojnë caktimin e një avokati edhe kundër dëshirës së të akuzuarit, veçanërisht në rastet kur në mënyrë të konsiderueshme dhe të vazhdueshme pengohet rrjedha përkatëse e gjykimit, apo me që përballen me akuzë të rëndë dhe janë të paaftë të veprojnë në interesin e tyre. Kështu veprohet edhe atëherë kur është e nevojshme mbrojtja e dëshmitarëve të lëndueshëm nga ankthi i mëtejshëm ose frikësimi i marrjes në pyetje nga i akuzuari. Sidoqoftë, çdo kufizim i dëshirës së personave të akuzuar për ta mbrojtur veten duhet patjetër të ketë një objektiv dhe një qëllim mjaft serioz dhe të mos shkojë përtej asaj që është e nevojshme për t’i mbështetur interesat e drejtësisë. Prandaj, ligji vendor duhet të shmang çdo pengesë absolute kundër të drejtës për ta mbrojtur veten në procedurat penale pa ndihmën e avokatit.”*³²

▪ Praktika e GJNPJ-së

Gjykata në disa raste e lejon të akuzuarin të përgatisë dhe të paraqesë mbrojtjen e tij vetanake. E drejta për vetëpërfaqësim, megjithatë, i ka kufijtë e saj. Në përkujtimin e

³¹ Shih Vendimin gjyqësor të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), Seliëiak kundër Polonisë, 21 korrik 2009, paragr. 57. Shih gjithashtu komentet e përgjithshme MNDCP 32 [90], paragr. 37.

³² Shih Komentin e përgjithshëm 32 [90] të MNDCP, paragr. 37. Gjithashtu shih Vendimin gjyqësor të GJEDNJ-së, Hermi kundër Italisë, 18 tetor 2006, paragr.73.

³³ Shih përgjithësisht, Steven Kay QC & Gillian Higgins, E drejta për vetëpërfaqësim – Avokatët në syrin e Stuhisë, Byroja Ndërkombëtare e Kodit penal, 4 gusht 2010. Shih gjithashtu Micheal P. Scharf, Vendimi i dhomës së apelit të GJNPJ-së për të drejtën e Slobodan Millosheviqit për vetëpërfaqësim, Vështrime të ASIL -Shoqatës Amerikane për të Drejtën Ndërkombëtare (VSHADN), nëntor 2004.

rrethanave të veçanta që kanë të bëjnë me të pandehurin, në rastet siç është gjendja shëndetësore apo sjellja e vazhdueshme destruktive, gjykata ka vendosur t'i caktojë të akuzuarit një avokat profesionist. Kufizimet e të drejtës për vetëpërfaqësim kanë ndodhur në disa raste të GJNPJ-së siç janë gjykimet e Millosheviqit dhe të Karaxhiqit. Përderisa në rastin e parë Tribunali përfundimisht vendosi të caktojë mbrojtës për ta përfaqësuar të pandehurin, gjendja shëndetësore e të cilit shkaktoi disa shtyrje, në rastin e Karaxhiqit Tribunali imponoi një avokat në “pritje” për t'i siguruar të drejtat për mbrojtje, sepse i akuzuari bënte opstrukcione duke refuzuar të marrë pjesë në gjykim.³³

1.4. GJYKIMI NË MUNGESË SI NJË PËRJASHTIM

Gjykimet në mungesë ju referohen procedimeve gjyqësore ku i pandehuri nuk është i pranishëm për t'iu përgjigjur akuzave penale për të cilat është akuzuar. Çështja e pranisë së avokatit është vendimtare për të garantuar gjykim të drejtë, sepse prania e të pandehurit ju shërben qëllimeve të ndryshme në rrjedhën e gjykimit. I pandehuri duhet të jetë i pranishëm për t'iu përgjigjur pyetjeve, për t'i siguruar deklaratat dhe provat dhe për t'i “përballuar” provat e mbledhura inkriminuese dhe deklaratimet e dëshmitarëve të tjerë, në ç'rast jep udhëzime avokati ligjor i cili është përgjegjës për mbrojtjen e tij. Por në mënyrë më të përgjithshme, prania e tij është fundamentale sepse ai duhet të jetë i vetëdijshëm për akuzat e ngritura ndaj tij dhe për të siguruar që mungesa e tij gjatë procedurës nuk do të ndikojë negativisht ndaj tij/saj.

Tradicionalisht, sistemi i përbashkët ligjor nuk ka lejuar gjykime në mos prezencë për shkak se e drejta që i pandehuri të jetë i pranishëm në gjykimin e tij është e shenjtë. Përveç kësaj, ai përdor një sistem të pavolitshëm, ku secila palë e ka përgjegjësinë për t'i çuar përpara argumentet e veta dhe të paraqesë prova. Në disa sisteme kontinentale, për shkak se procedura është e rreptë, hetimi dhe mbledhja e provave është siguruar nga gjykatësi hetues i cili është përgjegjës për kërkimin dhe grumbullimin si të provave inkriminuese ashtu edhe të atyre lehtësuese. Kështu, të drejtat e mbrojtjes konsiderohen t'i nënshtrohen më pak rrezikut sesa në sistemin anglo-sakson. Ajo që është më e rëndësishme, dallimi në qëndrimet shpjegohet nga ajo se si çdo qasje gjen se drejtësia është dërguar, duke përfshirë edhe atë se kur i pandehuri është arratisur. Sistemet ligjore që e ndjekin një qasje më kontinentale, si Franca apo Italia, lejojnë gjykime në mungesë në procedurat penale por të dy vendet gjithashtu janë kritikuar nga Gjykata Evropi-

ane për të Drejtat e Njeriut për këtë zgjedhje, sepse llogariten si të pamjaftueshme për t'i garantuar të drejtat e mbrojtjes. (Shih më poshtë.)

Përderisa GJEDNJ lë një hapësirë vlerësimi për më shumë se pesëdhjetë jurisdikcioneve kombëtare dhe nuk i ndalon gjykimet në mungesë, por njih një përgjegjësi shtesë të Shtetit për t'i siguruar të drejtat e mbrojtjes gjatë kryerjes së procedurave të përmendura.

Pozita e gjykatave ndërkombëtare dhe hibride penale është e përzier: përderisa ndalesa e gjykimeve të mbajtur tërësisht në mungesë mbizotëron, disa gjykata, sidomos ato të ndikuara nga sistemet mbi të drejtën Romake, i lejojnë gjykimet në mungesë të të pandehurit, duke siguruar mbrojtje me garanci të caktuar.

1.4.1. LIGJI I MAQEDONISË

Sipas LPP-së 2005 dhe Ligjit të Ri për procedurë penale (LPP të ri), gjykimi në mungesë mund të mbahet kur një i akuzuar është arratisur ose nuk është në dispozicion të autoriteteve shtetërore, ndërsa ekzistojnë arsye posaçërisht të rëndësishme për ta mbajtur gjykimin edhe pse i pandehuri nuk është i pranishëm.³⁴ Gjykimi në mungesë nuk mund të mbahet për të miturit.³⁵ Kodi më tej nuk përpunon se çfarë cilësohet si një arsye e rëndësishme (s). Megjithatë, diskutimet me praktikuesit ligjor sugjerojnë se nuk ka kuptim të unifikuar apo të qartë se çfarë

³⁴ Shihe nenin 316 të LPP-së të vitit 2005 i cili i përshkruan hapat paraprakë që duhet të ndërmerren nga gjykata para vendimit që një person ta gjykojë në mungesë:

“(1) Në qoftë se i akuzuari ka qenë i thirrur por nuk merr pjesë në gjykim dhe as e justifikon mungesën e tij, Dhoma gjykuese do të urdhërojë që i akuzuari të kapet me forcë. Në qoftë se arrestimi nuk mund të kryhet menjëherë, Dhoma gjykuese do të vendos që gjykimi të mos mbahet dhe do të urdhërojë që i akuzuari të arrestohet me forcë për gjykimin e ardhshëm. Në qoftë se në kohën e arrestimit të tij i akuzuari e arsyeton mungesën e tij, Kryetari i Dhomës do ta revokojë urdhrin për arrestimin me forcë.

(2) Nëse i akuzuari i thirrur padyshim është shmangur që të marrë pjesë në gjykim, dhe nuk ka arsye për parburgim sipas nenit 184 të këtij Kodi, Dhoma gjykuese mund të vendosë për një parburgimin para-gjykes për ta siguruar praninë e të akuzuarit në gjykim. Ankesa nuk e shtyn përmbarimin e vendimit për parburgimin para-gjykim. Për një parburgim para-gjykim të përcaktuar për këtë arsye aplikohen dispozitat nga nenet 183 deri 197 të këtij Kodi. Nëse nuk revokohet para kësaj, parburgimi para-gjykim zgjat deri në shpalljen e vendimit, por jo më shumë se 30 ditë.

(3) I akuzuari mund të gjykohet në mungesë vetëm nëse është i arratisur ose nuk është në dispozicion për agjencitë shtetërore dhe ka arsye posaçërisht të rëndësishme për t'u ndjekur penalisht, edhe pse në mungesë. [...]” Kuptimi i termit “arsye posaçërisht të rëndësishme” është ndoshta përcaktuar më mirë në jurisprudencë.

³⁵ Shih nenin 472 të LPP-së të vitit 2005.

³⁶ Shih nenet 316 dhe 409 të LPP të vitit 2005 dhe Nenet 365 dhe 441 nga LPP i ri.

³⁷ Shih nenin 424 të LPP-së të vitit 2005.

janë ato “arsye të rëndësishme”, por besojmë se ato i referohen seriozitetit të kriminit dhe ekzistimit të disa të pandehurve: mos mbajtja e gjykimit në atë rast do të jetë një mohim i drejtësisë për viktimat dhe do të përfaqësojë rrezik për të dëshmuar.

Vendimi për ta zhvilluar një gjykim në mungesë është bërë nga Dhoma Gjyqësore, me propozimin e Prokurorit. Mbrojtja mund ta ankimojë vendimin para Gjykatës së Shkallës së Dytë brenda tri ditëve nga dita e pranimit të vendimit në fjalë.³⁶

Personi i dënuar ose mbrojtësi i tij mund të kërkojë një ri-gjykim brenda një viti nga dita kur i dënuari ka qenë i informuar për vendimin e arritur në mungesë.³⁷ Një ri-gjykim është gjithashtu i mundur në qoftë se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut konstaton shkelje të të drejtave të garantuara nga Konventa, e cila në këtë rast i referohet të drejtës për gjykim të drejtë sipas nenit 6.³⁸

Sipas ligjit vendor, një bazë tjetër për gjykim në mungesë mund të gjendet në kontekstin e procedimeve të shkurtuara.³⁹ Këto procedura janë të zbatueshme për veprat penale që dënohen me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.⁴⁰ Këtu prokurori mund të padit në bazë të dëshmive të mbledhura në fazën e mëparshme dhe pa filluar një hetim formal.⁴¹ Nëse i akuzuari në procedurën e shkurtuar nuk paraqitet në seancën kryesore, përfshirë aty edhe kur gjykata nuk arrin ta thërrasë në mënyrën e duhur për shkak të dështimit të të paditurit ta raportojë ndryshimin e adresës, gjykata mund të vendosë për ta mbajtur gjykimin në mungesë të tij në qoftë se prania e tij nuk është e domosdoshme.⁴² Natyrisht, pyetja është cilat janë rrethanat që do ta bëjnë prezencën e të pandehurit të panevojshme. Sipas praktikuesit ligjor të konsultuar, paqartësia e këtij kushti nuk paraqet problem për gjykatën për marrjen e vendimit për gjykim në mungesë.

LPP i ri, krahas një riformulimi të vogël, i ka parashikuar të njëjtat kërkesa. Ai, megjithatë, i ka hequr kushtet e imponuara kur prania e të pandehurit nuk është e nevojshme: Ai thotë: “Në procedurat e veprave penale që sjellin një gjobë ose

³⁸ Shih nenin 418 (1) (7) të LPP-së të vitit 2005.

³⁹ Shih kapitullin 26 të LPP-së të vitit 2005, nenet 442 deri 457. Shih gjithashtu kapitullin 28 të LPP të ri, nenet 468- 482.

⁴⁰ Shih nenin 442 të LPP-së të vitit 2005.

⁴¹ Sipas LPP-së të vitit 2005 investigimi formal udhëhiqet nga gjykatësi hetues me propozimin e prokurorit dhe të bazuar në provat e grumbulluara në fazën para-hetimore duke siguruar dyshime të bazuara se i dyshuari i caktuar e ka kryer krimin.

⁴² Shih nenin 454§4 të LPP-së të vitit 2005 i cili thotë: “(4) Nëse i akuzuari nuk ka marrë pjesë në gjykim edhe pse ai ka qenë i thirrur ose thirrjet e gjykatës nuk kanë mund atij ti dorëzohen sepse i akuzuari nuk e ka njoftuar gjykatën për adresën e tij të re të banimit ose për vendqëndrimin e ri, gjykata mund të vendosë që gjykimi të mbahet në mungesë të tij por vetëm me kusht që prezenca e tij të mos jetë e nevojshme.”

⁴³ Shih nenin 479 (2) të LPP të ri,.

dënim me burg deri në tre vjet, në qoftë se i pandehuri nuk paraqitet në seancën kryesore, edhe pse është i thirrur në mënyrë të rregullt ose në qoftë se shërbimi i procesit nuk është kryer siç duhet për shkak se është ditur qartë se i pandehuri i është shmangur thirrjes, gjykata mund të vendosë të mbahet seanca kryesore në mungesë të tij ose të saj. Për të gjitha krimet e tjera për të cilat zhvillohen procedura të shkurtuara, prania e të pandehurit në seancën kryesore duhet të jetë e detyrueshme.⁴³ Posaçërisht, ky segment i fundit i dispozitës duket se është në kundërshtim me parimet e përgjithshme të gjykimit në mungesë, që presupozojnë përmbushjen e më tepër kushteve.

Më në fund, gjykimi mbahet, po qese edhe qëllimisht pengohet marrja në pyetje ose nuk respektohen udhëzimet e Kryetarit të trupit gjykues i cili është i ngarkuar me mbajtjen e gjykimit.⁴⁴ Pas lëshimit të paralajmërimit përkatës, gjykata mund të urdhërojë që të akuzuarit të largohen nga salla e gjykimit për një periudhë të caktuar kohore. Në qoftë se i pandehuri deri atëherë është marrë në pyetje në gjykim, ai mund të largohet gjatë kohëzgjatjes së procedurës së paraqitjes së provave. Në atë rast, para kompletimit të procedurës së paraqitjes së provave, gjykatësi Kryesues i panelit do ta kthejë të akuzuarin dhe do ta informojë atë për rrjedhën e gjykimit. Gjykata mund të urdhërojë largim tjetër, nëse i akuzuari vazhdon të jetë destruktiv. Në atë rast gjykimi do të përfundojë pa të akuzuarin dhe Kryetari i trupit gjykues ose një nga gjyqtarët në panel do ta njoftojnë atë me vendimin, në prani të një nëpunësi të gjykatës.⁴⁵

Një masë mbrojtëse për t'u siguruar gjykimi i drejtë në mungesë, përveç mundësisë ligjore për rigjykim, është kërkesa e të pandehurit që mungon, të përfaqësohet nga një avokat menjëherë kur gjykata e ka arritur vendimin për ta mbajtur gjykimin në mungesë.⁴⁶ Të pyetur nëse gjykimet në mungesë janë mbajtur në përputhje me ligjin, praktikuesit e intervistuar të ligjit janë përgjigjur pozitivisht – është thënë se të pandehurit që mungojnë zakonisht janë të përfaqësuar nga avokati. Megjithatë, në dy rastet e fundit të përshkruara më lartë në lidhje me procedurën e shkurtuar dhe sjelljen destruktive të të pandehurit paraqesin *de facto* rastet e gjykimeve në mungesë, ku ligji nuk parasheh përfaqësimin e të pandehurit në mungesë nga një avokat, e as mundësinë për rigjykim. Ky konkluzion pasqyrohet në observimin e bërë nga disa të anketuar të cilët konfirmojnë se në këto raste të posaçme, ku i pandehuri nuk është formalisht i gjykuar në mungesë, nga gjykata nuk janë siguruar ex-officio mbrojtës ligjor.

⁴⁴ Shih nenin 311 (1) të LPP të vitit 2005. Shih gjithashtu dispozitat e njëjta në nenin 361 (2) të LPP të ri.

⁴⁵ Shih nenin 311 (2) të LPP të vitit 2005.

⁴⁶ Shih nenin 66 (4) të LPP të vitit 2005. Shih gjithashtu nenin 74 (5) të LPP të ri.

Në diskutimin që bëhet rreth gjykimeve në mungesë, praktikuesit e intervistuar janë të vetëdijshëm për masat e ndryshme mbrojtëse ligjore që garantojnë gjykim të drejtë. Shumica mbizotëruese mendojnë se gjykimet në mungesë zhvillohen në përputhje me ligjin për shkak se ai e parashikon mundësinë e ri-gjykitimit kur i pandehuri është i paraburgosur ose bëhet i kapshëm. Një pakicë, megjithatë, vëren se gjykimet në mungesë çojnë në përgjithësi në shqiptimin e dënimit më të lartë juridik dhe se rezultati i procedimeve në dënimet bazohet në prova shumë jo bindëse.

Në procedurat e krimeve komplekse, mungesa e avokatëve mbrojtës dhe e të pandehurve është më kritike për arsye të brendshme: rastet e krimit të organizuar sipas definicionit përfshijnë të paktën tre bashkë - të akuzuar,⁴⁷ mu për këtë shumohen mundësitë që disa prej tyre [ose avokatët e tyre] të mos paraqiten para gjykatës. Natyra e krimit, po ashtu, kërkon që procedurat kundër çdo njërit prej tyre të konsolidohen, prej atëherë kur në rastet komplekse, në kohëra të ndryshme, mund të pengohet përcaktimi objektiv i fakteve të rrezikuara.

Të gjithë praktikuesit ishin të njëzëshëm në observimin se përfaqësimi ligjor në rastet e krimeve komplekse është vendimtar për udhëheqje përkatëse të gjykitimit dhe se kjo kërkon shkathtësi të posaçme nga pjesëmarrësit në procedimet, përfshirë edhe mbrojtjen. Të intervistuarit kanë mendime të përziera për sa i përket praktikës së gjykimeve në mungesë në krimet komplekse. Shumë prej tyre besonin se mbajtja e gjykitimit në mungesë është në përputhje me ligjin. Të tjerët ishin të shqetësuar se udhëheqja e gjykitimit në mungesë të të pandehurit zakonisht shpie në akuza të cilat nganjëherë prodhojnë dënime drastike të larta. Një i anketuar deklaroi se gjykimet në mungesë ndonjë herë sjellin mangësi në prezantimin përkatës të provave: “Aty praktikisht nuk ka gjykim, në këto gjykime nuk paraqiten prova, kurfarë raporti nuk nxirret. Një tipar tjetër i gjykimeve në mungesë është se dënimet që rezultojnë nga këto raste janë të larta në mënyrë drastike.”

Shtyrje në rastet komplekse penale - Në përputhje me rregullat procedurale të vendosura nga LPP i vitit 2005, është në diskrecionin e gjykatësit kryesues të trupit gjykues që ta shtyjë seancën atëherë kur një palë nuk është e pranishme në seancë, e aty përfshihen edhe mangësi të tjera kur mungojnë edhe: prokurori, avokati mbrojtës ose viktimi,⁴⁸ ose kur palët angazhohen në sjellje destruktive.⁴⁹

⁴⁷ Neni 121 (20) të Kodit të konsoliduar Penal, “Gazeta Zyrtare” 114/09: “Një grup, bandë ose grupim tjetër kriminel ose një organizatë do të thotë të paktën tre persona që kanë formuar një grupim për qëllime kriminele, përfshirë edhe organizatorin e grupimit.”

⁴⁸ Shih nenin 311 (3) të LPP të vitit 2005.

⁴⁹ Shih nenin 315 (1) dhe (2) të LPP të vitit 2005.

⁵⁰ Shih nenin 301 (1) të LPP të vitit 2005.

⁵¹ Shih nenin 301 (2) të LPP të vitit 2005.

Gjykata mund të urdhërojë që ta shtyjë gjykimin me kërkesën e arsyeshme të palëve⁵⁰ ose për shkaqe të tjera të arsyeshme për shtyrje siç janë arsyet mjekësore ose ndonjë shkak tjetër i arsyetuar mirë.⁵¹

Ligji gjithashtu rregullon se si duhet të bëhet zëvendësimi i avokatëve. Zëvendësimi i tillë është bazë për shtyrje/azhurnim të gjyimit, përveç në rastet kur ndodh më shumë se një zëvendësim, me qëllim të vonimit [zvarritjes] së procedimit. Në pajtim me nenin 322 (3) të LPP të vitit 2005, “gjatë seancës kryesore, nëse i pandehuri e revokon autorizimin e avokatit mbrojtës ose avokati mbrojtës vetë tërhiqet nga përfaqësimi i tij, avokatit të posa angazhuar do t’i jepen më së shumti 15 ditë për ta përgatitur mbrojtjen, dhe në këso rasti seanca kryesore do të vazhdojë menjëherë. Një tërheqje e re/revokim i autorizimit të procedimit të mëtejshëm të seancës kryesore do të lejohet vetëm me vendim të trupit gjykues dhe në qoftë se kjo nuk është bërë për ta shtyrë gjykimin me qëllim.”⁵²

Në praktikë, sipas shumicës së të anketuarve, gjykimet shpesh shtyhen. Një pjesë e vogël mendojnë se shtyrjet kanë qenë ngjarje të rralla. Arsyet kryesore për shtyrje sugjerohet se janë mosprania e avokatit, e të pandehurit ose e të dy palëve njëkohësisht. Disa të anketuar kanë vënë në dukje se mungesa e prokurorit, gjykatësit apo e ndonjë dëshmitari, gjithashtu mund të jenë, në mënyrë tipike, bazë për vendimin për shtyrje.

Për sa i përket numrit të shtyrjeve për shkak të mungesës së të pandehurit para se gjykata të urdhërojë që të mbahet gjykim në mungesë, të anketuarit u pajtuan se janë ndjekur hapa të ndryshme. Aty ku i pandehuri konsiderohet si i arratisur [i paarritshëm për agjencitë shtetërore] dhe nëse ka arsye posaçërisht të rëndësishme për ndjekjen e tij penale, pavarësisht nga mungesa e tij,⁵³ gjykata mund ta mbajë menjëherë gjykimin në mungesë. Prandaj pyetja është se sa seanca janë shtyrë nga gjykatat pikërisht para se të vendosin të pushojnë duke pritur realizimin e kërkesës që autoritetet për zbatimin e ligjit edhe zyrtarisht të deklarojnë se i akuzuari është në arrati/i fshehur. Përgjigja varet nga përvojat e ndryshme të praktikuesve. Disa mendonin se gjykata do ta shtyjë vetëm një herë, të tjerët mendonin se gjykatat zakonisht shtyjnë dy ose tre dëgjime para se të vazhdojnë me gjykimet në mungesë.

⁵² Paragrafi pasues i nenit 322 të LPP të vitit 2005 parashikon me sa vijon: “(4) Jashtë rasteve të parapara në paragrafin (3) të këtij neni, në qoftë se i akuzuari ka autorizuar një avokat të mbrojtjes, shqyrtimi kryesor do të vazhdojë pa vonesë.” Nuk duket se instancat e sakta ku gjykimet do të mbahet menjëherë pas emërimit të avokatit të ri janë të përcaktuara qartë.

⁵³ Shih nenin 316 (3) të LPP të vitit 2005.

⁵⁴ Shih nenin 402 (3) të LPP të Kroacisë i cili thotë: “I pandehuri mund të gjykohej në mungesë vetëm nëse për këtë gjykim ekzistojnë arsye posaçërisht të rëndësishme, dhe në qoftë se: 1) nuk është i mundshëm gjykimet në vend të huaj, 2) nuk është i mundshëm ekstradimi, ose 3) i pandehuri është i arratisur.”

Shqetësim të veçantë paraqesin rastet që përfshijnë të pandehur të shumëfishtë. Gjykimi i tyre në të njëjtën kohë implikon presion mbi gjykatën për ta finalizuar rastin aq shpejt sa e lejon ligji, edhe nëse kjo do të thotë se një i pandehur mund të mungojë. Kërkesa e ngutshme që të respektohet drejtësia dhe të respektohet e drejta e të pandehurve të pranishëm për gjykim brenda kohës së arsyeshme ka përparësi mbi të drejtat e të pandehurve të arratisur.

1.4.2. LIGJET NDËRKOMBËTARE DHE KRAHASUESE

- Ligji kroat

Në bazë të ligjit, gjykimet në mungesë duhet të jenë përjashtim. Ato mund të mbahen vetëm në rrethana specifike dhe për arsye posaçërisht të rëndësishme, të tilla si kur i pandehuri është i paarritshëm për autoritetet – janë jashtë vendit, nuk mund të ekstradohet, ose në përgjithësi,⁵⁴ Gjykata merr vendim që të mbajë gjykim në mungesë pas prononcimit të prokurorit.

⁵⁵ Shih vendimin e Gjykatës së Lartë të SHBA-ve në Hopt kundër Utah: “legjislatura e ka konsideruar esenciale mbrojtjen e atij, jeta apo liria e të cilit është e involvuar në ndjekje penale për krim, ai që personalisht do të jetë i pranishëm në gjykim, që është, në çdo fazë të gjyimit, kur të drejtat e tij substanciale mund të preken nga procedimet kundër tij. Nëse ai do të jetë i privuar nga jeta apo liria e tij, pa qenë i pranishëm, privimi i tillë do të ishte pa atë proces të rregullt ligjor të kërkuar nga Kushtetuta.” Hopt kundër Utah, 110 US 574, 28 L Ed 262, 4 S Ct 202 (1884).

⁵⁶ Shih Rregullën 43 nga Rregullat federale të procedurës re. Defendant’s Presence, F.R.Crim.Pro.: “(a) kur kërkohet.

Përveç kësaj rregulle, Rregulla 5 ose Rregulla 10 sigurojnë se i pandehuri patjetër duhet të jetë i pranishëm në:

(1) daljen e parë, rregullimin fillestar dhe apelimin;

(2) çdo fazë të gjyimit, përfshirë aty shqyrtimin nga këshilli dhe kthimin e vendimit; si edhe

(3) dënimin.

(b) Kur nuk kërkohet. I pandehuri nuk ka nevojë të jetë i pranishëm në asnjë nga rrethanat e mëposhtme:

(1) Të pandehurit e organizuar.

I akuzuari është organizatë e përfaqësuar nga avokati i cili është i pranishëm.

(2) Shkelje kundërvajtëse.

Vepra penale është e dënueshme me gjobë ose me burgim për jo më shumë se një vit, ose me të dyja, dhe me pranimin me shkrim të të pandehurit, gjykata lejon që marrëveshja, apelimi, gjykimi dhe dënimi të ndodhin në mungesë të të pandehurit.

(3) Seancë ose dëgjim për çështje ligjore.

Procedimi përfshin vetëm konferencë të dëgjimit të në çështje të ligjit.

(4) Përmirësimi i dënimit.

Procedimi e përfshin përmirësimin ose zvogëlimin e dënimit në saje të Rregullës 35 ose 18 U.S.C. § 3582(c).

▪ Ligji amerikan

E drejta për t'u gjykuar në prezencë, gjithmonë ka qenë e njohur nga Shtetet e Bashkuara dhe ka qenë e garantuar sipas parimit të procesit të përcaktuar të mbrojtur nga Amendamenti i pestë, i jashtë dhe i katërmbëdhjetë të Kushtetutës së SHBA-ve.⁵⁵ Megjithatë, përjashtime për këtë të drejtë janë pranuar në Rregulloren federale të procedurës penale të vitit 1946⁵⁶ dhe në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë ku pranohet se “këtu vepra nuk është e madhe dhe i akuzuari nuk është në paraburgim, [...] nëse, pasi që gjykimi ka filluar në praninë e tij, ai vullnetarisht e largon veten, kjo nuk e anulon atë që është bërë ose e parandalon përfundimin e gjykimit, por, përkundrazi, funksionon si një heqje dorë nga e drejta e tij për të qenë i pranishëm dhe e lë gjykatën e lirë të vazhdojë me gjykimin në të njëjtën mënyrë dhe me të njëjtin efekt sikur ai të kishte qenë i pranishëm.”⁵⁷ Një kërkesë e tillë e pranisë fillestar ka qenë e projektuar për të siguruar që i pandehuri është i vetëdijshëm për akuzat dhe për procedimet e ngritura kundër tij.⁵⁸

▪ Ligji i Francës

Tradita ligjore e Francës është ndër sistemet kontinentale të cilat lejojnë që gjykimet të zhvillohen në mungesë të të pandehurit. Ajo ka pësuar ndryshime të mëdha të legjislativit në vitin 2004 si rezultat i dënimit të Francës nga GjEDNJ në gjykimin e saj Krombach kundër Francës.⁵⁹

Sipas sistemit aktual, të titulluar “*procédure de défaut criminel*” ose procedurave të paracaktuara penale, një i pandehur i cili ngarkohet me shkelje para *Cour d'Assises* (që gjykon shkelje të rënda penale) mund të gjykohet në mungesë të tij, nëse

(c) Heqje dorë nga prezencja e vazhdueshme.

(1) Në përgjithësi.

I pandehuri i cili fillimisht ka qenë i pranishëm në gjykim, apo i cili është deklaruar fajtor ose nolo contendere, heq dorë nga e drejta për të qenë i pranishëm në rrethanat vijuese:

(A) kur i pandehuri vullnetarisht mungon pas fillimit të gjykimit, pavarësisht nëse gjykata e ka informuar të pandehurin që të jetë i pranishëm gjatë gjykimit;

(B) në një rast jo të rëndë, kur i pandehuri vullnetarisht mungon gjatë shqiptimit të dënimit; ose

(C) kur gjykata e paralajmëron të paditurin se do ta largojë atë nga salla e gjykimit për sjellje destruktive, por i pandehuri vazhdon me këto sjellje që e justifikon largimin nga salla e gjykimit.

(2) Efekti i dorëheqjes.

Nëse i padituri heq dorë nga e drejta që të jetë i pranishëm, gjykimi mund të vazhdojë deri në përfundim, përfshirë aty vendimin e gjyqit dhe dënimin, gjatë mos prezencës së të paditurit.”

⁵⁷ Shih Diaz kundër Shteteve të Bashkuara, 223 U.S. në 455 [1912].

⁵⁸ Për informacione të tjera për gjykime në mungesë në kontekstin amerikan, shih rastin e Gjykatës Supreme të SHBA-ve, Crosby kundër Shteteve të Bashkuara, 506 U.S. 255 (1993).

⁵⁹ Shih Vendimin gjyqësor të GjEDNJ, Krombach kundër Francës, 13 shkurt 2001.

ai nuk është i pranishëm dhe nuk ka dhënë arsytim të vlefshëm për këtë ose në se ai mungon gjatë debateve pas fillimit të gjykimit dhe nuk ka mundësi për ta pezulluar gjykimin. Garancitë procedurale të paraqitura në 2004 janë vendosur dhe e lejojnë mundësinë e ri-gjykimit në rast se i pandehuri ju dorëzohet autoriteteve ose nëse arrestohet para shpalljes së dënimit, bashkë me të drejtën e mosplotësimit të detyrimit që i pandehuri të përfaqësohet nga një avokat. Më në fund, ankimimi i vendimit në mungesë të gjykatës së shkallës së dytë penale, *Cour d'Assises d'Appel*, nuk është i lejuar por është paraparë një ankesë në pikat e ligjit në *Cour de Cassation* (gjykatës më i lartë francez për çështje gjyqësore).⁶⁰

Sistemi ligjor francez gjithashtu parashikon një procedurë me mosparaqitje ku i pandehuri i cili rregullisht ka qenë i thirrur nuk paraqitet në seancën e dëgjimit mund të gjykohe në mungesë të tij.⁶¹ Megjithatë, gjykata gjithmonë mund të vendosë që ta shtyjë seancën përderisa i pandehuri i përfaqësuar nga mbrojtësi të paraqitet. Gjithashtu, i pandehuri i akuzuar mund ta kundërshtojë vendimin e dorëzuar gjatë mungesës së tij dhe të ri-gjykohe.⁶²

▪ Jurisprudenca e GJEDNJ-së

Një nga karakteristikat më fundamentale të së drejtës për gjykim të drejtë është se i pandehuri ka të drejtë të jetë i pranishëm në gjykimin e tij, të mbrohet vetë ose të përfaqësohet nga një avokat. Dështimi për t'ia siguruar të pandehurit këtë mundësi mund të ndikojë në ligjshmërinë e gjykimit. Vetëm në saje të përjashtimit procedimet mund të zbatohen pa praninë e të pandehurit, por gjithmonë në baza të jashtëzakonshme dhe në respektimin e masave të caktuara mbrojtëse. GJEDNJ në mënyrë të qartë thekson se gjykimet në mungesë nuk janë *per se* (vetvetiu) në kundërshtim me frymën e Konventës:

*“Procedimet e mbajtura në mungesë të të akuzuarit në parim nuk janë në kundërshtim me Konventën në qoftë se personi i interesuar mund të sigurojë më pas një gjykim i cili merret me përcaktimin e ri të pjesës së akuzës, edhe me ligjin edhe me faktet.”*⁶³

⁶⁰ Shih nenet 379-2 deri 379-6 të Kodit për procedurë penale të Francës.

⁶¹ Shih nenet 410-412 dhe 487-488 të Kodit për procedurë penale të Francës.

⁶² Shih nenin 489 të Kodit për procedurë penale të Francës.

⁶³ Shih Vendimin e GJNDNJ-së, Poitrimol kundër Francës, 23 nëntor 1993, paragr. 31; Vendimin e GJNDNJ-së, Colozza kundër Italisë, 12 shkurt 1985, paragr. 27 dhe 29.

⁶⁴ Shih më lartë, Vendimi i GJNDNJ, Poitrimol kundër Francës dhe Vendimi i GJNDNJ-së, Lala kundër The Holandës, 22 shtator 1994, paragrafi 33: “fakti se i pandehuri, pavarësisht se ka qenë i thirrur në mënyrë përkatëse, nuk paraqitet, nuk mund – madje edhe kur mungon apo ka arsytim – pa justifikim të privohet nga e drejta e tij sipas nenit 6 paragr. 3 (art. 6-3) të Konventës për t'u mbrojtur nga avokati.”

⁶⁵ Shih Vendimi i GJNDNJ-së, F.C.B. kundër Italisë, 28 gusht 1991, Goddi kundër Italisë, 9 prill 1984, Seliëiak kundër Polonisë, 21 korrik 2009.

Megjithatë, duhet të ketë masa mbrojtëse se si e drejta e të pandehurit të përfitojë nga një rigjykim (shih më lart), që të përfaqësohet nga një këshilltar ligjor,⁶⁴ ose të informohet në mënyrë përkatëse nga autoritetet kombëtare në lidhje me datën e gjykimit, apo t'i lejohej të marrë pjesë në seancë.⁶⁵ Gjykata Evropiane gjithashtu i shpall kushtet rreth formës së heqjes dorë nga e drejta për të qenë i pranishëm gjatë procedimeve: “shmangia e tillë, nëse ajo do të jetë efektive për qëllime të Konventës, duhet të vendoset në një mënyrë të qartë dhe të përcillet me masa minimale mbrojtëse që përputhet me: rëndësinë e saj”⁶⁶ Gjykata Evropiane e përmbledh çështjen në një mënyrë tjetër “para se të pandehurit në mënyrë të padyshtimtë t'i kumtohet, përmes sjelljes së tij, se ka hequr dorë nga një e drejtë e rëndësishme në saje të nenit 6 të Konventës (së re. Fer gjykim) patjetër duhet të dëshmohej se ai ka mund të parashikojë se çfarë do të jenë pasojat e sjelljes së tij.”⁶⁷

▪ Rregullativat dhe praktikat e gjykatave ndërkombëtare penale

Edhe pse Gjykata Ushtarake Ndërkombëtare në Nuremberg ka lejuar gjykime në mungesë, sot shumica e gjykatave ndërkombëtare penale me sa duket, përgjithësisht, nuk lejojnë gjykime në mungesë të të pandehurve. Shumë persona kanë shfaqur shqetësime dhe i kanë kritikuar gjykimet e Nurembergut sepse është lejuar të kalojnë akuzat kundër të pandehurve të arratisur.⁶⁸

Gjykatat bashkëkohore të tilla si GJNPJ dhe GJNPR e sigurojnë të drejtën e të pandehurit për të qenë i pranishëm në gjykim, duke mos i përjashtuar në mënyrë të qartë procedimet në mungesë.⁶⁹ Precedenca e vendosur në gjykimin e Sllobodan

⁶⁴ Shih më sipër Vendimi i GJNDNJ-së, Poitrimol kundër Francës, para. 31, dhe Vendimin e GJNDNJ-së, Seliëiak kundër Polonisë, paragr. 57; Vendimi i GJNDNJ-së, Pfeiffer dhe Plank kundër Austrisë, 25 shkurt 1992, paragr. 37.

⁶⁵ Shih më sipër, Vendimi i GJNDNJ-së Hermi kundër Italisë, paragr. 74; Vendimi gjyqësor i GJNPJ-së Jones kundër Mbretërisë së Bashkuar, 9 shtator 2003.

⁶⁶ Për diskutim të përgjithshëm për praktikat e gjykatave ndërkombëtare penale për gjykimet në mungesë, shihni Antonio Kaseze, Ligji Ndërkombëtar penal, faqja 389, Edicioni i dytë, botim i Universitetit të Oksfordit, 2008.

⁶⁹ Shin Nenin 21 (4) d, të Statutit të GJNPJ dhe Nenin 20 (4) d, të Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare Penale të Rundës (Statuti i GJNPR), të miratuar më 8 Nëntor 1994 nga Rezoluta e KS OKB 989, e plotësuar me amendamente më 13 Tetor t;ë vitit 2006 nga Rezoluta 1717. Shih gjithashtu Nenin 80 (B), Rregullat e procedurës dhe provave të GJNPJ, IT/32/Rev. 44, versioni i 10 Dhjetorit 2009. Për diskutim të përgjithshëm për këtë çështje, shih Herman Schëartz, Gjykime në mungesë, 4 HUM. RTS. BR. 1, 12 (1996).

⁷⁰ Për më shumë informacione mbi procedurat në mungesë të pjeshme kundër Millosheviqit, shih Kris Xhenks, Shënim i paraqitur ndryshe: A do ti shkelin të drejtat e njeriut Gjykimet në mungesë në Tribunalin e Posaçëm për Libanin? Zhurnali Ndërkombëtar i drejtësisë i Fordemit, Dhjetor 2009. Shih gjithashtu Aleksandra B. Stankovic, Fajtor deri sa të shpallet fajtor: Rregulla 61 të GJNPJ, Ekspres O, 2010, që mund të gjendet në http://works.bepress.com/aleksandra_stankovic/3.

Milloseviqit para GJNPJ-së në disa nuanca e solli ndalesën e rreptë të gjykimeve në mungesë dhe e ka vendosur atë, që tani është emërtuar si “mungesë e pjeshme”. Përderisa Milloseviqi ishte i pranishëm në fillimin e procedimit, më pas ai në periudha të gjata nuk ishte në gjendje të marrë pjesë në gjykimin e tij për shkak të sëmundjes. Pjesë e seancave dhe të procedurave u zhvilluan në mungesë të tij dhe janë vlerësuar se Milloseviqi ka marrë pjesë në gjykimin e tij si në fillim.⁷⁰ GJNPR ka aplikuar diçka si gjykime pjesërisht në mungesë si në rast të të akuzuarit i cili ka refuzuar të paraqitet në sallën e gjykimit pasi që ka marrë pjesë në procedimet paraprake.⁷¹

Tribunalet pasuese penale - hibride ose tërësisht ndërkombëtare - të tilla si Administrata e Tranzicionit e K.B. në Timorin Lindor,⁷² Gjykata Ndërkombëtare Penale,⁷³ Gjykata e Posaçme për Siera Leonen,⁷⁴ Dhomat e jashtëzakonshme të Gjykatave në Kamboxhia⁷⁵ i kanë adoptuar politikat e GJNPJ-së dhe të GJNPR-së dhe e kanë formalizuar mundësinë e gjykimit të kufizuar në mungesë, në rastet e të akuzuarve të arratisur, të atyre që refuzojnë të paraqiten në gjykim ose që e ndërpresin procedimin pasi që fillimisht kanë marrë pjesë në gjykim.⁷⁶

Një gjykatë penale duhet të veçohet për pranimin e gjerë të gjykimeve në mungesë. Gjykata e Posaçme për Libanin në statutin e saj e parasheh mundësinë që të zhvillojë gjykime në mungesë, pa asnjë paraqitje fillestare të të pandehurit në

⁷¹ Shih Prokurori kundër Barajagviza, Rasti Nr. GJNPR 99-52-T, Vendimi gjyqësor, para. 7, Dhjetor 3, 2003, ku i akuzuari ka refuzuar të paraqitet në gjykim pasi që vendimi gjyqësor i favorshëm për të është rrezuar nga Gjykata e Apelit të GJNPR.

⁷² Shih Administrata e tranzicionit e Kombeve të Bashkuara në Timorin Lindor, Rregullativa Nr. 2000/30 për rregullat transitorë për procedurë penale, para. 5.1, Dok. i K.B. UNTAET/REG/2000/30, Shtator 25, 2000.

⁷³ Shih më sipër nenin 63, Statuti i Romës.

⁷⁴ Shih R. 60(A), Rregullat e Procedurës dhe të provave të Gjykatës së Posaçme për Siera Leonen, që është ndryshuar me amendamente më 28 Maj, 2010, në dispozicion në <http://www.scscl.org/LinkClick.aspx?fileticket=zXPrwoukovM%3d&tabid=176>.

⁷⁵ Rregulla 81(4) të Rregullave të brendshme të Dhomës së jashtëzakonshme në Gjykatat të Kamboxhias (Rev.4), i ndryshuar me amendamente në shtat. 11, 2009, i qasshëm në <http://www.eccc.gov.kh/english/cabinet/fileupload/121/irv4-en.pdf>.

⁷⁶ Një përjashtim në këtë trend të përgjithshëm për t'i vërtetuar procedurat gjyqësore të mbajtura pjesërisht në mungesë është miratuar nga Misioni i OKB-së në Kosovë, ku gjykimet në mungesë janë të ndaluara për krime që kualifikohen si shkelje serioze të ligjit ndërkombëtar humanitar. Shih Misioni i OKB-Administrata e Përkohshme në Kosovë, Rregullorja nr 2001 / 1, Dok. i K.B. UNMIK/REG/2001/1, 12 janar 2001.

⁷⁷ Shih nenin 22 të Statutit të Gjykatës së Posaçme për Libanin, të miratuar më 30 maj 2007 nga Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të KB 1757. Për diskutim të përgjithshëm për këtë çështje, shih më sipër, Kris Xhenks, Shënim ndryshe i dhënë: A do t'i shkelin gjykimet në mungesë në Tribunalin e Posaçëm për Libanin të drejtat e njeriut?

⁷⁸ Shih më sipër, Chris Jenks, Kris Xhenks, Shënim ndryshe i dhënë: A do t'i shkelin gjykimet në mungesë në Tribunalin e Posaçëm për Libanin të drejtat e njeriut?

rastin kur ai ka hequr dorë nga e drejta të jetë i pranishëm në gjykim, kur nuk është dorëzuar nga autoritetet përkatëse, ose në qoftë se ai është fshehur ose askund nuk mund të gjendet pas ndërmarrjes së hapave të nevojshëm për ta siguruar praninë e tij.⁷⁷ Kjo sjellje relativisht “e relaksuar” që ndodhtë në gjykimet në mungesë ka krijuar zhurmë të caktuar midis pjesëtarëve të shoqërisë civile.⁷⁸

Duhet të sqarohet një tjetër procedurë e aplikueshme në kontekstin e mungesës së të pandehurit. Rregulla 61 e GJNPJ-së për Procedurë dhe Prova, “Procedura në rast të dështimit të ekzekutimit të një Urdhri”, ngjallën shumë polemika sepse është konsideruar si një shkelje e të drejtës së të pandehurit që të jetë i pranishëm gjatë gjykimit të tij. Sipas kësaj rregulle, atëherë kur Dhoma Gjyqësore është e bindur se përpjekjet për ta arrestuar të pandehurit ishin të pasuksesshme, ajo mund ta konfirmojë aktakuzën fillestare të ngritur ndaj të pandehurit pasi i ka shqyrtuar provat e ofruara nga ana e Prokurorit, dhe lëshon një urdhër-arresti ndërkombëtar kundër të akuzuarit.⁷⁹ Përdorimi i parë i procedurës sipas Rregullës 61 të GJNPJ-së kishte të bënte me të arratisurin Dragan Nikolić⁸⁰ dhe më vonë u aplikua për të arratisurit e tjerë si për Radovan Karaxhiqin dhe Ratko Mlladiqin.⁸¹ Vlen të përmendet se GJNPR ka miratuar rregulla të ngjashme me Rregullën 61.⁸²

⁷⁹ Shih Aleksandra B. Stankovic, Fajtor deri sa të shpallet fajtor: Rregulla 61 të GJNPJ, Ekspres O, 2010, të qasshme në http://works.bepress.com/aleksandra_stankovic/3.

⁸⁰ Shih Prokurori kundër Dragan Nikolic, Rasti No. IT-94-2-R61, Pasqyra e padive në bazë të Rregullës 61 të Rregullativës për procedurë dhe prova, (20 tetor 1995).

⁸¹ Shih Prokurori kundër Radovan Karadzic & Ratko Mladic, Rasti No. IT-95-5-R61, Pasqyra e padive në bazë të Rregullës 61 të Rregullativës për procedurë dhe prova, ¶ 3 (11 korrik 1996).

⁸² Shih Rregullën 61 të Rregullave për procedurë dhe prova të GJNPR-së, të miratuar më 29 qershor 1995, versioni i 26 qershorit 2000.

KAPITULLI 2.

E DREJTA PËR NDIHMË LIGJORE FALAS: KORELACION ME TË DREJTËN PËR MBROJTËS LIGJOR

Siç është diskutuar gjatë këtij hulumtimi, e drejta për t'u ndihmuar nga një përfaqësues ligjor është gur sinori në kuadër të së drejtës për mbrojtje. Asnjë rrethanë e jashtme e procesit gjyqësor, siç është mungesa e mjeteve financiare te individit, nuk do të duhej ta pengojë realizimin e kësaj të drejte sidomos në procedurat penale. Pjesa në vijim do të përqendrohet në modelet e ndryshme ligjore që ofrojnë mbrojtje ligjore për të varfrit.

2.1. TEORIA DHE PRAKTIKA

Në këtë seksion, aspektet ligjore dhe praktike të modeleve për sigurimin e ndihmës ligjore falas në rastet penale do të shqyrtohet për të nxjerrë një pasqyrë të rregullave të përgjithshme dhe të strukturës së sistemeve të tilla. Një vështrim krahasues të elementeve të tilla si funksionimi i sistemit të ndihmës juridike, organizimi i trupave të përfshira në sigurimin e ndihmës juridike, natyra e tyre ligjore dhe buxheti vjetor do të sigurohen, me fillimin e modelit të aplikuar në shtetin pritës.

2.1.1. MODELI I MAQEDONISË

Shtrirja dhe natyra e ndihmës juridike

LPP i vitit 2005⁸³ në lidhje me të pandehurit e varfër që kanë nevojë për asistencë juridike parashikon me sa vijon:

Neni 63 i LPP të vitit 2005

Çdokush ka të drejtë për mbrojtës në procedurën para-penale dhe gjyqësore. [...]

⁸³ Sigurimi i ndihmës ligjore falas kohëve të fundit ka pësuar ndryshime të mëdha pas miratimit dhe hyrjes në fuqi të Ligjit për ndihmë juridike falas. Sipas këtij ligji, ndihma ligjore falas është në dispozicion të viktimave që u janë nënshtruar veprave penale. Gjithsesi, ajo nuk zbatohet për personat e varfër nën ndjekje penale.

Neni 67 i LPP të vitit 2005

- (1) Atëherë kur kushtet për mbrojtje të detyrueshme nuk janë përmbushur procedurat që lidhen me një krim për të cilin Kodi përshkruan një dënim prej një viti apo më shumë, të akuzuarit mund t'i caktohet një avokat në saje të kërkesës nëse mjetet e tij financiare nuk i lejojnë që t'i përballojë shpenzimet e mbrojtjes.
- (2) Kërkesa për të pasur një avokat të caktuar nga gjykata sipas paragrafit 1 të këtij neni mund të pranohet vetëm pasi që padia të jetë ngritur. Gjykatësi kryesues i Këshillit vendos lidhur me kërkesën, ndërsa emërimi i avokatit është bërë nga Kryetari i Gjykatës.

LPP i ri i parashikon kushtet vijuese për t'u kualifikuar për ndihmë ligjore falas:

Neni 70 i LPP të ri: Të drejtat e të akuzuarit

Çdo i akuzuar duhet t'i ketë të drejtat vijuese themelore:

[...]

- të gjykohet në praninë e tij ose të saj dhe të mbrohet personalisht ose me ndihmën e një avokati mbrojtës sipas zgjedhjes së tij ose të saj, dhe nëse personi është i varfër, të marrë një avokat mbrojtës falas kur kjo kërkohet nga interesi i drejtësisë dhe, posaçërisht, nga serioziteti i veprës penale dhe kompleksiteti i rastit; [...]

Neni 75 i LPP të ri: Mbrojtja e personave të varfër

(1) Kur kushtet për mbrojtje të obliguar nuk janë plotësuar, me kërkesën e tij, të pandehurit mund t'i caktohet mbrojtës, në qoftë se gjendja e tij financiare tregon se i pandehuri nuk mund t'i përballojë shpenzimet e mbrojtjes.

(2) Gjykatësi i procedurës paraprake ose Kryetari i trupit gjykues do të vendosë në lidhje me kërkesën e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, ndërsa avokati mbrojtës do të emërohet nga Kryetari i Gjykatës.

(3) Shpenzimet e mbrojtjes të referuara në paragrafin 1 të këtij neni do të mbulohen nga buxheti i Shtetit të Republikës së Maqedonisë.

Në të dy versionet e kodit, të pandehurit e varfër kanë mundësi për këshilla ligjore falas nëse ata nuk mund t'i përballojnë shpenzimet e mbrojtjes. LPP i vitit 2005 shton kufizime për të drejtën për përfaqësues ligjor falas ku kërkon që krimi në fjalë duhet të sjellë një dënim me burgim njëvjeçar dhe se përfaqësimi i lirë fillon vetëm pasi aktakuza të jetë ngritur. LPP i ri e zgjeron mundësinë e ndihmës ligjore falas për të gjitha krimet dhe për të gjitha fazat e procedurës. Një shqyrtim i his-

torisë së kësaj të drejte sugjeron se ndihma ligjore falas është bërë më e arritshme për të pandehurit e varfër me kalimin e kohës. Para vitit 2004 kjo e drejtë ishte vetëm në dispozicion të atyre të akuzuarve për krime që ndëshkohen me burgim prej tre ose më shumë vjet.⁸⁴

Sipas ligjit të vitit 2005 kërkesa për këshillim ligjor falas duhet t'i drejtohet Kryetarit të trupit gjykues. LPP i ri parasheh që kërkesat e tilla do t'i paraqiten gjykatësit në procedurën paraprake ose Kryetarit të trupit gjykues, në varësi të fazës së procedurës. Të dy ligjet kërkojnë që caktimi duhet patjetër të bëhet nga Kryetari i gjykatës.

Sigurimi i ndihmës ligjore falas, përveç në rastet e mbrojtjes së detyruar, janë bërë efektive me LPP të vitit 2005.

Sipas disa të anketuarve, gjykatat në çdo rast sigurojnë mbrojtje ligjore falas me caktimin e avokatit ex-officio, në rastet kur i pandehuri personalisht nuk njih një avokat nëse ligji e urdhëron mbrojtjen e detyrueshme. Kjo do të thotë se gjykata nuk kontrollon patjetër nëse i pandehuri është i varfër para ofrimit të ndihmës ligjore falas, në rastet e mbrojtjes të detyruar dhe ky ex-officio emërim i avokatit është siguruar kinse-automatikisht, menjëherë sa do të duket se ai do të përfitojë nga mbrojtja e detyrueshme.

Megjithëse LPP i ri nuk ofron shumë detaje se si caktohet përfaqësuesi ligjor, të intervistuarit kanë shpjeguar se çdo gjykatë themelore e cila posedon dhomë penale, siguron listë të avokatëve të cilët, atëherë kur është e nevojshme, mund të emërohen si avokatë ex-officio (në sajë të detyrës zyrtare). Gjykatësi kryesues i Këshillit vendos nëse i pandehuri kualifikohet për ndihmë juridike falas dhe Presidenti i gjykatës e emëron avokatin.⁸⁵ Sistemi i ndihmës ligjore për personat e varfër, sipas të gjithë të anketuarve, është menaxhuar nga vetë gjykata

Një pasqyrim i situatës aktuale sipas mendimit të të intervistuarve sugjeron se avokatët ex-officio në mënyrë tipike zgjidhen për shkak të praktikës së tyre solide në fushën e veprave penale. Supozimi është se gjyqtarët janë të njoftuar me dosjet e punës së avokatëve në procedimet ku ata kanë qenë të involvuar dhe mu për këtë ata janë në pozicion që të gjejnë avokat kompetent të përcaktuar nga gjykata. Nga ana tjetër, një numër i të intervistuarve sugjeron se avokatët e caktuar nga gjykata nuk kanë qenë të zgjedhur domosdoshmërisht në bazë të listave

⁸⁴ Shih nenin 67, të LPP të vitit 1997 (Gazeta Zyrtare 15/97).

⁸⁵ Shih nenin 67 (2) të LPP të vitit 2005 dhe nenin 75(2) të LPP-së së ri.

ekzistuese ose në bazë të kualifikimeve të tyre në ligjin penal, por janë zgjedhur për shkak të miqësisë. Grupi i tretë i ka shprehur dyshimet e tyre në sistemin, duke konstatuar se emërimet nga ana e gjykatës nuk bëhen në saje të ndonjë kriteri përveç se me kalkulimin e mundësive se sa një avokat i caktuar do të bëjë ankesë ose do ta sfidojë vendimin e gjykatës. Ata mendojnë se kryetarët e gjykatave në mënyrë tipike emërtojnë avokatë që i kanë të njohur apo avokatë të cilët nuk do të “krijojnë probleme.”⁸⁶.

Në përgjithësi, praktikuesit ligjor duken të kënaqur me sistemin e emërimit sepse besojnë se ata që kanë nevojë për ndihmë juridike e fitojnë në kohë dhe se çdo gjykatë posedon një listë të avokatëve të cilët mund të caktohen *ex-officio*.

Me vendosjen e një roli më aktiv për mbrojtjen dhe prokurorinë dhe me frenimin e gjykatësit hetues në LPP-në e ri, shumica e praktikuesve pajtohen se *ex-officio* avokatët (ose avokatët në përgjithësi) do të përballen me një problem të madh me ngarkesën e rastit *vis a vis* (kundrejt) detyrave të reja hetimore. Një pjesë prej tyre mendonin se ngarkesa e punës do të shumëzohet për njëzet here, krahasuar me gjendjen aktuale. Një pjesë e tyre megjithatë, nuk janë pajtuar, duke parashikuar që barra e hetimit do të bie më tepër mbi prokurorin se sa në avokatin.

Një shqetësim i rëndësishëm i grupit të parë është pagesa e avokatëve *ex-officio* - ata parashtrajnë pyetje nëse do të ketë stimul financiar të shoqëruar me plotësimin e detyrave shtesë hetimore. Buxheti i gjykatës mund të mos rritet në mënyrë proporcionale për të lejuar pagesë përkatëse dhe në kohë të shpenzimeve të mbrojtjes *ex-officio*.

Buxheti dhe financimi

Shumica e praktikuesve nuk kanë informacion për pjesën e buxhetit vjetor të gjykatës i cili është lejuar ose harxhuar për shpenzimet e mbrojtjes *ex-officio*.

Në vitin 2009, buxheti i përgjithshëm për Gjqësinë arriti në 27,060,261.00 euro.⁸⁷ Buxheti që e përfshin ndihmën ligjore duke përfshirë *ex-officio* emërimet e avokatëve, dëshmitarët ekspertë dhe shpenzimet e tjera gjyqësore kanë qenë të barabarta me 1,772,655.00 euro. Buxheti i dedikuar për *ex-officio* emërimet e avokatëve për çështjet penale ishte 341,861.00 euro.⁸⁸

⁸⁶ Zakonisht, të anketuarit e përdornin këtë term për të aluduar në *ex-officio* avokatët të cilët nuk kanë zgjedhur të ankohen në vendimet e dhëna kundër klientëve të tyre.

⁸⁷ Ky buxhet shërben për dy programe: Administratën e gjykatës dhe për Akademinë e trajnimit të gjykatësve dhe të prokurorëve.

⁸⁸ Shih përgjigjen maqedonase në CEPEJ studimin, përgjigje në pyetjet 13, 14 dhe 15 (2010), që janë në dispozicion në http://www.coe.int/t/dgh/cooperation/cepej/evaluation/2010/2010_FYROM.pdf.

Shifrat e tjera që ne kemi qenë në gjendje t'i mbledhim janë ato të kostove të mbrojtjes ex-officio për vitin 2009 të Gjykatës Themelore- Shkup 1 që arriti në 8.768.851 denarë (rreth 142, 671,00 euro). Buxheti për vitin 2011 është planifikuar të jetë 9.126.000 denarë (rreth 148, 482. 00 euro).

Kushtet e pranueshmërisë

Edhe pse mundësia e ndihmës ligjore falas është e mirëseardhur, shtrohet pyetja se cilat kritere janë marrë parasysh për ta vlerësuar gjendjen pronësore të të pandehurit. Sipas formulimit në ligjin e vitit 2005, statusi pronësor i të akuzuarit duhet të jetë i ulët deri në atë pikë ku nuk ka burime për të përballuar shpenzimet e mbrojtjes.

Praktikuesit nuk ishin në gjendje të ofrojnë një pasqyrë të qartë të kritereve të kërkuara ligjore për këshillimin ligjor falas. Një numër prej tyre mendonin se statusi pronësor mund të vlerësohet përmes kritereve të ndryshme, duke përfshirë mungesën e dokumenteve të pasurisë në emër të një personi të lëshuara nga kadastra, certifikata se nuk është në marrëdhënie pune, dokumente që qartësojnë se personi ka qasje në ndihmë sociale etj. Megjithatë, nuk duket se ka qenë i identifikuar një prag i qartë sasior ose cilësor për t'i përcaktuar përfituesit potencial të përfaqësimit ligjor falas. Gjithashtu, shprehja “në interes të drejtësisë” e përdorur në nenin 70 të LPP të ri ka krijuar ndjenja të përziera në mesin e të anketuarve - disa mendojnë se paqartësia e kësaj shprehje lë shumë vend për interpretim. Është e rëndësishme të theksohet se LPP i ri ka një formulim të ngjashëm me atë të Konventës Evropiane dhe jurisprudencën e saj, sa i përket mbrojtjes së të varfërve. Sigurimi i avokatit të emëruar nga gjykata për të akuzuarit e varfër në rastet kur mbrojtja e detyrueshme nuk mund të zbatohet duhet t'i kënaq kërkesat e diktuar nga interesat e drejtësisë, njëlloj si në Konventë. Dispozitat e LPP-së shkojnë më tej duke treguar se interesi i drejtësisë do të vlerësohet në mënyrë të veçantë në bazë të dy elementeve: seriozitetit të shkeljes dhe kompleksitetit të rastit.

Në mënyrë më specifike, në bazë të LPP të ri ndihma ligjore për njerëzit e varfër është siguruar në ngarkesë të gjykatës, për krimet që tërheqin një dënim prej së paku një vit burgim, nëse gjendja pronësore e “të pandehurit nuk lejon që ai t'i përballojë shpenzimet e mbrojtjes.”⁸⁹

Duhet të nënvizohet një mos konsistencë në shifrat e siguruara në studimi. Në pyetjen 13, komenti thotë se i caktuari për ndihmë juridike nuk mund të identifikohet njëlloj sikurse që nuk mund të dallohen shpenzimet e tjera të gjykatës si dhe tarifën e paguara për ekspertët dëshmitarë. Megjithatë, përgjigja në pyetjen 14 e siguron buxhetin publik vjetor për ndihmë ligjore në rastet penale.

⁸⁹ Shih nenin 67 (1) të LPP të vitit 2005.

Kërkesa e kuptimit të saktë apo një analizë e detajuar e asaj se ç'është thotë shprehja e mësipërme, është e diskutueshme. Disa nga praktikuesit që i kemi intervistuar besojnë se gjykata është në pozitë ta vlerësojë skamjen në bazë të faktorëve të tillë, siç janë posedimi i pasurisë së paluajtshme të vërtetuar nga një dokument kadastral, vërtetimi që e dëshmon dhënien e ndihmës sociale, statusi i punësimit (ose dokumenti i papunësisë) dhe më në fund, dokumentet e lëshuara nga Zyra e brendshme e të ardhurave për të konfirmuar se marrësi bie në kategorinë e individëve që kanë të ardhura të ulëta. Të gjitha këto do të kërkohen nga gjykata për të përcaktuar nëse gjendja financiare e aplikuesit e arsyeton caktimin e një avokati ex-officio.

Një numër i të intervistuarve, megjithatë, kanë marrë qëndrim të kundërt duke gjetur se kriteri ligjor nuk është i qartë dhe se nevojiten testime të tjera plotësuese për t'i sqaruar ato, duke e përfshirë legjislacionin e shkallës së dytë të Ministrisë së Drejtësisë ose Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale.

Për sa i përket kriterit “në interes të drejtësisë” i prezantuar nga ligji i ri, shumica e të anketuarve kanë deklaruar se dhënia e ndihmës juridike falas për një të pandehur bazohet në interesat e drejtësisë” ka qenë një kriter mjaft i qartë, veçanërisht për shkak se termi “interesat e drejtësisë” ka qenë i plotësuar në vetë thelbin e ligjit nga një referencë për seriozitetin e veprës penale dhe kompleksitetin e rastit.

Mjete kundër vendimit për refuzimin e ndihmës falas juridike dhe tërheqja e ndihmës
Nuk ka asnjë dispozitë specifike për ankesë ndaj vendimit të Presidentit të Gjykatës për të caktuar një avokat ex-officio. Prandaj, zbatohet rregulla e përgjithshme për ta ankimuar vendimin procedural të neneve 408-413 nga LPP i vitit 2005. I pandehuri brenda tre ditëve në Gjykatën më të lartë mund të ankohe kundër vendimit i cili e refuzon kërkesën e tij për ndihmë ligjore falas.

2.1.2. MODELET NDËRKOMBËTARE DHE KRAHASUESE

- Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut dhe praktika e Gjykatës

Neni 6 (3) (c) i Konventës Evropiane thotë se: “[çdo]një i akuzuar për shkelje penale i ka të drejtat vijuese minimale: ... ta mbrojë veten ose përmes ndihmës juridike sipas zgjedhjes së tij ose, nëse nuk ka mjete të mjaftueshme për ta paguar ndihmën juridike, ajo t'i jepet falas kur interesat e drejtësisë e kërkojnë kështu.”

E drejta për ndihmë ligjore falas i nënshtrohet përmbushjes së dy kushteve kumulative: se individi është i paaftë t'i paguajë taksat ligjore dhe se interesat e drejtësisë kërkojnë që ai të pajiset me ndihmë ligjore falas.⁹⁰

Në lidhje me kushtin e parë, as Konventa e as jurisprudenca e Gjykatës nuk ka siguruar tregues të saktë për atë se i përbëjnë “mjetet e mjaftueshme”, duke ua lënë me qëllim këtë çështje juridiksioneve kombëtare, sepse standardet ekonomike, gjithsesi, ndryshojnë në secilin prej shteteve kontraktuese. Për më tepër, Gjykata ka pranuar se disa elemente mund të përbëjnë një sasi të provave në drejtim të konstatimit të varfërisë së një individi, të tilla siç janë certifikatat ose deklaratat zyrtare që e paraqesin gjendjen financiare të aplikuesit për ndihmë juridike.⁹¹

Sa i përket kushtit të dytë, Gjykata i ka përdorur kriteret e mëposhtme për të përcaktuar nëse “interesat e drejtësisë” në një rast të caktuar e kërkojnë sigurimin e dhënies së ndihmës ligjore falas: serioziteti i veprës penale, kompleksiteti i rastit dhe gjendja personale e të pandehurit. Në rastin e Quaranta kundër Zvicrës, Gjykata vendosi se të akuzuarit duhet t'i sigurohet ndihma ligjore falas për shkak se:

- ai mund të dënohet me burgim trevjeçar që cilësohet si vepër e rëndë;
- një nga bazat ligjore të ngritura gjatë gjykimit paraqesin çështje posaçërisht të rënda juridike të cilat tregojnë se rasti është kompleks;
- i pandehuri ka qenë një përdorues i rregullt dhe afatgjatë i drogës që vjen nga një mjedis pa të drejta, i cili nuk ka mund të jetë në gjendje ta paraqesë mbrojtjen e tij në një mënyrë të përshtatshme nëse nuk do të ndihmohej me një avokat.⁹²

Përveç kësaj, Gjykata Evropiane ka vendosur se e drejta për ndihmë ligjore falas, si dhe të tjerat të garantuara me Konventë nuk janë “teorike apo iluzore por të drejta që janë praktike dhe efektive; kjo posaçërisht është kështu me të drejtat për mbrojtje, në pikëpamje të vendit të dalluar që në një shoqëri demokratike e mban e drejta për gjykim të drejtë, nga e cila ajo buron ... Në të vërtetë, Gjykata i ka dënuar autoritetet shtetërore, kur ato nuk sigurojnë ndihmë ligjore efektive, emërimin e thjeshtë të një avokati i cili aktualisht nuk punon për mbrojtjen e një individi, nuk duhet të konsiderohet si ndihmë efektive juridike. Dështimi për ta zëvendësuar

⁹⁰ Shih Vendimin gjyqësor të GjEDNj, Pakelli kundër Gjermanisë, 25 prill 1983, par. 31, ku Gjykata e sqaron lidhjen midis dy kushteve në lidhje me ofrimin e ndihmës ligjore falas sipas nenit 6 (3) c: “Në përputhje me këtë, një “person i akuzuar për një vepër penale”, i cili nuk dëshiron të mbrohet vetë duhet të jetë në gjendje të ketë burime për ndihmë ligjore të zgjedhur nga ai; në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të paguar për një ndihmë të tillë, ai ka të drejtë në bazë të Konventës ajo ti jepet falas nëse këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë.” Shih gjithashtu më sipër, Artikolo kundër Italisë: paragr. 34

⁹¹ Shih më sipër Vendimin e GJNPJ-së, Pakeli kundër Gjermanisë, paragr. 34.

⁹² Shih Vendimi i GJNPJ, Quaranta kundër Zvicrës, 24 maj 1991.

avokatin e caktuar që nuk është në dispozicion ishte e barsvlershme me një shkelje të nenit 6-3-c.”⁹³

Më tej për të drejtën për ndihmë me një avokat mbrojtës, KNDCP parasheh “[në] përcaktimin e çfarë do qoftë akuze kriminele kundër tij, çdo kush ka të drejtë për garancitë vijuese minimale, në barazi të plotë: [...] të ketë ndihmë juridike që i është caktuar, për cilin do qoftë rast kur interesat e drejtësisë kështu kërkojnë, dhe pa pagesë nga ai në çdo rast të tillë në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme që atë ta paguajë”.⁹⁴ Kjo dispozitë e veçantë nga Komiteti i të Drejtave të Njeriut më tej është shpjeguar në mënyrën vijuese:

“qënia në dispozicion ose mungesa e ndihmës juridike shpesh përcakton nëse një person mund apo nuk mund të ketë qasje ose jo në procedurat përkatëse ose të marrë pjesë në to në një mënyrë kuptimplote. Përderisa neni 14 në mënyrë eksplicite i drejtohet garantimit të ndihmës juridike në procedimet penale në paragrafin 3 (d), shtetet inkurajohen të ofrojnë ndihmë ligjore falas në rastet e tjera, për individët të cilët nuk kanë mjete të mjaftueshme për ta paguar atë. Në disa raste, ata madje mund të jenë të detyruar ta bëjnë këtë. Për shembull, kur një person i dënuar me vdekje kërkon rishqyrtim kushtetues të parregullsive në një gjykim penal por nuk ka mjete të mjaftueshme për t’i përballuar shpenzimet e ndihmës juridike për të ndjek një mjet të tillë, Shteti është i detyruar të sigurojë ndihmë juridike në pajtim me nenin 14, paragrafi 1, në lidhje me të drejtën për mjet efektiv juridik siç është e paraqitur në nenin 2, paragrafi 3 të Konventës [...] Në mënyrë të ngjashme, vendosja e tarifave për palët në procedurë që de facto do ta parandalojnë qasjen e tyre në drejtësi mund të ngrenë çështje në bazë të nenit 14, paragrafi 1 [...]”⁹⁵

⁹³ Shih më sipër Vendimin e GJEDNJ-së, Artiko kundër Italisë, para. 33: “Gjykata kujton se Konventa ka për qëllim të garantojë të drejta që nuk janë teorike apo iluzore por të drejta që janë praktike dhe efektive; kjo posaçërisht është kështu për të drejtat e mbrojtjes në pikëpamje të vendit të shquar që në një shoqëri demokratike zë e drejta për një gjykim të drejtë, nga të cilat ajo buron (shih aktgjykimin Airey të 9 tetorit të vitit 1979, Seria A nr. 32, f. 12-13, paragr. 24, dhe paragr. 32 më sipër). Ashtu siç theksojnë qartë Delegatët e Komisionit, neni 6 paragr. 3 (c) (neni 6-3-c) flet për “ndihmë” dhe jo për “emërim”. Përsëri, emërimi i thjeshtë nuk siguron ndihmë efektive sepse avokati i caktuar për qëllime të ndihmës juridike mund të vdesë, të sëmuret rëndë, të pengohet për një periudhë të gjatë nga veprimi ose t’i shmanget detyrës. Nëse ata janë të njoftuar me situatën, autoritetet duhet ose ti zëvendësojnë ose të bëjnë që të përmbushin detyrimet e tyre. Miratimi i interpretimit kufizues të Qeverisë do të shpijë në rezultate që janë të paarsyeshme dhe pa përputhshme edhe me formulimin e nën-paragrafit (c) (neni 6-3-c) edhe strukturën e nenit 6 (neni 6) që merret si i tërë ; në shumë raste ndihma juridike falas mund të dëshmohet se është e pavlefshme”.

⁹⁴ Shih Nenin 14 (3) d të KNDCP.

⁹⁵ Shih KNDCP 32 [90] në nenin14, paragr.10-11.

Pikat kryesore të modelit të Kroacisë

Aty ku rrethanat e kërkojnë zbatimin e rregullave të mbrojtjes së obliguar për të akuzuarin (pavarësisht nëse është apo jo i varfër) i cili nuk ka arritur të angazhojë ose thjeshtë është pa mbrojtës, atij do t'i emërohet një avokat ex-officio (në sajë të detyrës zyrtare). Avokati ex-officio caktohet nga Kryetari i Gjykatës me propozimin e Gjykatës dhe të Prokurorisë. Kryetari i Gjykatës emëron avokatë ex-officio nga lista dhe nga avokatët në dispozicion të gjykatës (dhe që veprojnë brenda juridiksionit të saj territorial). Ndiqet radhitja në listë. Megjithatë, për rastet e krimeve të luftës ndiqet një listë e avokatëve ex-officio e cila është përgatitur në bashkëpunim me Odën e Avokatëve dhe është në baza vullnetare. Lista është e dizajnuar për të treguar nëse çdo avokat ka përvojë të duhur. Është interesante të theksohet se ka tendencë që shumica e vullnetarëve të jenë të rinj dhe të etur për të fituar përvojë, ta zhvillojnë reputacionin e tyre profesional në këtë fushë dhe të përfitojnë nga trajnimi në Akademinë e gjykatësve në LNH dhe tema të tjera të krimeve të veçanta penale. Nuk lejohet ankimi kundër vendimit për caktimin e një avokati ex-officio.

Avokati i caktuar nga gjykata mund të lirohet nga kjo detyrë vetëm për shkaqe të arsyeshme. Megjithatë, shumë praktikues me përvojë solide ngurrojnë të marrin raste ex-officio dhe e justifikojnë veten me orare tepër të ngarkuar. Rrjedhimisht emërimet nga gjykata, në të shumtën e rasteve u jepen avokatëve të rinj dhe relativisht pa eksperiencë. Përveç kësaj, në emërimin e një avokati ex-officio, Kryetarët e Gjykatave në mënyrë rigoroze e vijnë radhitjen duke i kushtuar pak apo aspak vëmendje eksperiencës specifike të cilën mund ta kërkojë rasti.

Aty ku kushtet për mbrojtje të detyrueshme nuk janë plotësuar, avokatët ex-officio në bazë të kërkesës mund të caktohen për të akuzuarit e varfër, në qoftë se rrethanat e posaçme e kërkojnë këtë. Në këto raste, një avokat ex-officio mund të emërohet për të akuzuarit e varfër vetëm pasi aktakuza të jetë ngritur dhe vetëm për vepra penale që sjellin burgim prej pesë ose më shumë vjet. Gjykatësi kryesues i këshillit ose një gjykatës mund ta rishikojë propozimin, por emërimi formal bëhet vetëm me vendim të

Kryetari të Gjykatës. Nuk lejohet kurrfarë ankese kundër aktvendimit duke e refuzuar vendimin për caktimin e avokatit falas juridik.

Ligji për Avokatët gjithashtu ofron ndihmë ligjore falas për viktimat e “Luftës atdhetare” dhe persona të tjerë të ndieshëm në aspekt social të cilët dëshirojnë t’i realizojnë të drejtat e tyre në këto dy fusha.

Debati në vazhdë e sipër i rrumbullakëson tarifatat që paguhet për avokatët e emëruar nga gjykata. Sipas nenit 18 § 2 të Ligjit për avokatët, Ministria kroate e Drejtësisë është përgjegjëse që t’i përcaktojë tarifatat për ex-officio emërimet. Në vitin 2004 Ministria nxori një Rregullore për tarifatat e aplikueshme⁹⁶ e cila thotë se avokatët ex-officio do të marrin 30 pikë për përfaqësimin e një klienti në gjykimet që involvojnë vepra penale që dënohen me më shumë se tetë vjet burgim, (1 pikë është e barabartë me 10 HRK që është e barabartë me 1,5 EUR). Sigurimi i avokatit ligjor në procedurat që përfshijnë vepra penale që dënohen me gjobë ose deri në tre vjet burgim llogariten 10 pikë në orë në ditën e marrjes në pyetje. Me që tarifa e Shoqatës së avokatëve është miratuar në vitin 2009⁹⁷ (që i përcakton tarifatat minimale për parashtresat e dërgimi e hartuar nga avokatët) jepet 400 pikë për të njëjtin shërbim, kjo do të thotë se ex-officio avokatët mbrojtës në realitet pranojnë më pak se 10 për qind të tarifës së përcaktuar me rregulloren e avokatëve. Tarifa e Shoqatës së avokatëve e vitit 2009⁹⁸ parashikon 50% nga tarifa e rregullt për avokatët ex-officio. Në të njëjtën kohë, meqë rregullorja e Ministrisë së Drejtësisë është ende në fuqi, atëherë kur vendoset për shumën që do të jepet për ex-officio mbrojtjen, gjykatat vazhdojnë t’u referohet tarifave të vjetra.

Kryetari i Gjykatës mund ta shkarkojë një avokat të caktuar nga gjykata, nëse është konstatuar se ka qenë joprofesional. Gjykata do të caktojë një tjetër avokat ex-officio dhe Shoqata e avokatëve do të informohet për shkarkimin e tij. Procedurat disiplinore që udhëhiqen para Odës së avokatëve janë të mbyllura për opinionin. Edhe pse disa raste disiplinore janë përcjellë nga mediat, asnjëri nga ato nuk involvojnë avokatë ex-officio por avokatë të angazhuar privatisht.

⁹⁶ Shih Rregulloren e MD-së për tarifatat për avokatët e caktuar ex-officio, të datës 29 dhjetor 2004.

⁹⁷ Shih tarifën e Shoqatës së avokatëve për pagesën dhe çmimin për punën e avokatëve, “Gazeta zyrtare 148/09, e datës 11 dhjetor të vitit 2009.

⁹⁸ Shih më sipër, Tarifa e avokatëve për tarifatat dhe shpërblimet për punën e avokatëve.

▪ Modeli amerikan: Zyra e mbrojtësit publik

SHBA-të janë të njohura për modelin e tyre për ndihmë juridike për të varfrit. E drejta për mbrojtës në llogari të shtetit për të akuzuarit e varfër është e njohur si e drejtë kushtetuese në saje të Amendamentit të gjashtë, nga Gjykata Supreme në rastin Gideon kundër Ëainëright në vitin 1963.⁹⁹ Si pasojë e rastit Gideon, në të gjithë vendin janë krijuar programe të shumta për mbështetje të mbrojtjes së të varfërve, sidomos në çështjet penale. Për shkak se bindja se të varfrit duhet të mbështetet në gjykatat dhe procedurat ligjore në llogari të shtetit e ka fituar rrugën e saj, një zgjidhje dhe një model i veçantë, që është reprodukuar në të gjitha shtetet amerikane, e ky model është Zyra e Mbrojtjes Publike (ZMP).

Natyra dhe sistemi i ndihmës juridike

Thelbi i mbrojtjes së të varfërve përmes programeve të Zyrës së mbrojtësve publikë (ZMP) është ndihma për të pandehurin, i cili nuk mund ta mbulojë mbrojtjen e tij ligjore, të shkojë në ngarkesë të shtetit, kështu që të varfrit nuk duhet të rimbursojnë asgjë.

Natyra e strukturës administrative dhe ligjore të institucioneve Amerikane ka pasur një ndikim vendimtar në mënyrën në të cilën është siguruar ndihma ligjore për njerëzit e varfër. Në të vërtetë, organizimi i ndihmës ligjore për të pandehurit e varfër ndryshon aq sa shtete ka në shtetin Amerikan. Sistemet kryesore të mbrojtjes së të varfërve mund të identifikohen si model i mbrojtësve publik, modeli i përcaktuar për avokatë, dhe modeli i shërbimit të kontraktuar:

“Sistemi i përcaktuar i mbrojtësve e përfshin caktimin e rasteve penale për avokatët privat në baza sistematike ose ad hoc ka të bëjë me caktimin e sistemit penal në raste të veçanta për avokatët privatë në një sistematike ose bazë ad hoc. Sistemi i kontraktimit ofron shërbime juridike përmes kontratave qeveritare me një avokat, grupi të avokatëve, ose ndonjë entiteti tjetër. Programi i mbrojtësve publikë në nivel lokal ose federal kanë avokatë të stafit të plotë dhe personel përkrahës të cilët sigurojnë shërbime për të akuzuarit e varfër për vepra penale.”¹⁰⁰

⁹⁹ Gideon kundër Wainwright, 372 SHBA 335 (1963), i cili urdhëronte çdo person të akuzuar për vepër për të cilën është paraparë dënim me burg është i autorizuar për ndihmë të avokatit mbrojtës.

¹⁰⁰ Shih karrierat në mbrojtjen e të varfërve, Udhëzues i shpejtë për Programet e mbrojtësve publik, Lisa D. Williams dhe Glan G. Rice, 2006, Presidenti dhe miqtë të kolegjit të Harvardit.

Për shkak të efikasitetit dhe të arsyeve administrative, por edhe për shkak të karakterit federal të organizimit të ndihmës për të varfrit, shumica e shteteve zakonisht kombinojnë disa modele për ta siguruar ndihmën juridike.¹⁰¹ Për shembull, në shtetin e Nju Hempshajrit, zyra e themeluar e mbrojtësit publik për rastet penale ku përfshihen të mbrojturit e varfër, fillimisht do të caktojë avokatët kontraktues, ndërsa avokatët të cilët janë në shërbim nën-kontraktues të shtetit dhe avokatët e përcaktuar në baza ad hoc janë opsion i dytë apo i tretë.¹⁰² Edhe pse edhe dy modelevë të tjera mund tu drejtohen kur ka nevojë, studimi aktual do të fokusohet në programin e mbrojtësit publik. Programet për mbrojtës publikë themelohen në nivel federal, shtetëror dhe të qarqeve.¹⁰³

Zyra e Mbrojtjes Federale Publike ofron shërbime të mbrojtjes në rastet federale penale për individët të cilët janë financiarisht të paaftë që të sigurojnë përfaqësim përkatës. Pesëdhjetë e tetë Zyra për mbrojtje publike (ZMP) janë themeluar për tu shërbyer 66 nga 94 rrethet gjyqësore federale. Stafi i Mbrojtësit Federal Publik, i cili përbëhet nga avokatë, hetues, dhe nga personeli tjetër mbështetës, janë të punësuar federal me orar të plotë pune.¹⁰⁴ Të gjithë avokatët e angazhuar janë me eksperiencë të madhe.

Ndaras nga ZMP-ja, ekzistojnë pesëmbëdhjetë organizata të avokatëve të komunitetit (OMK). OMK-të janë organizata për shërbime jo fitimprurëse juridike që veprojnë nën mbikëqyrjen e bordit të drejtorëve dhe shpesh herë si degë e mbrojtësve publikë shtetërorë ose organizata për shërbime juridike.

Gjithashtu, rastet federale penale shpesh herë trajtohen nga këshillat private të avokatëve. Aty ku nuk ka ZMP dhe OMK, zyrat private të avokatëve i trajtojnë të gjitha emërimet dhe kompensohen në baza të çdo rasti veç-e-veç.

¹⁰¹ Shih Robert L. Spangenberg dhe Marea L. Beeman, "Sistemet e Mbrojtjes së të varfërve në Shtetet e Bashkuara," 58 Ligji dhe Problemet bashkëkohore 31, (Universiteti Djuke - Shkolla e jurisprudencës, Dimri 1995).

¹⁰² Shih nenin 604-A: 2 II të Statutit të Nju Hempshajrit, në dispozicion në <http://www.gencourt.state.nh.us/rsa/html/NHTOC/NHTOC-LIX.htm>.

¹⁰³ Shih më sipër, Karriera në mbrojtjen e të varfërve, Udhëzues shpejtë i Programit të mbrojtësve publik; Raport i posaçëm mbi Programet Shtetërore për Mbrojtës Publik 2007, Lynn Langton dhe Donald Farole, Jr, Ph.D., shtator 2010, Departamenti i Drejtësisë, Zyra e Departamentit të drejtësisë së SHBA, Byroja e Statistikave të Drejtësisë, NCJ 228229.

¹⁰⁴ Lisa D. Williams, Esq. dhe Glen G. Rice, Bernard Koteen Zyra këshilluese për interesin publik, Shkolla e drejtësisë e Harvardit, Letra e titulluar: "Karrierat në mbrojtjen e të varfërve", e publikuar nga Kryetari dhe shokët e Kolegjit të Harvardit, 2006, f.6.

¹⁰⁵ Shih më lartë, Raport i posaçëm për programet shtetërore për mbrojtës publik 2007, f 1.

Programet federale kanë përgjegjësi për veprat federale ndërsa Programet për shtetet dhe qarqet merren me programet me veprat në shtetet. Të 50 shtetet e vendit posedojnë Programe të Mbrojtësve Publikë (PMP).¹⁰⁵ Sistemi politik federal ju lejon shteteve liri të plotë për ta organizuar sigurimin e ndihmës juridike në nivel shtetëror. Kështu, përderisa disa shtete vendosin ZMP shtetërore, tjerat kanë qarqe të cilat themelojnë ZMP me juridiksione specifike.¹⁰⁶

Shtrirja e rasteve të trajtuara nga organizata të mbrojtësve lëvizin nga kundërvajtjet, veprat e kryera penale nga të rriturit apo të miturit në nivel shtetëror ose federal, paraburgimi i fëmijëve, dërgimi në institucione psikiatrike etj. Programet e veçanta sigurojnë mbrojtje adekuate ligjore në rastet e mëdha.¹⁰⁷ Disa ZMP fokusohen në rastet e ankimuar.

Kundërvajtjet dhe shkeljet e zakonshme e përbënin pjesën më të madhe (43%) të rasteve të pranuar nga programet mbrojtëse publike dhe programet e pesëmbëdhjetë shteteve e kanë tejkaluar maksimumin e numrit të rekomanduar, të numrit të rasteve penale dhe të kundërvajtjeve për avokat.¹⁰⁸ Programet e shtetit të punësojnë një mesatare prej 163 avokatëve ndërgjyqësor dhe gjyqësor për shtet dhe ata kanë punësuar një hetues për çdo gjashtë avokatë ekuivalent ndërgjyqësor me orar të plotë (EOP) në vitin 2007.¹⁰⁹ Programet shtetërore për mbrojtës publik kanë raportuar një mesatare prej rreth 2 mbrojtës menaxhues që të mbikëqyrin dhjetë ndihmës publikë dhe në vitin 2007 rreth 3.000 të punësuar kanë ofruar përkrahje për avokatët në programet shtetërore për mbrojtës publik.¹¹⁰

Për më tepër, pesëmbëdhjetë programe shtetërore për mbrojtës publik e kishin ngarkesën e çështjeve apo të punës ose të të dyjave dhe pesëmbëdhjetë nga 19 programe shtetërore e kanë tejkaluar maksimumin e rekomanduar të rasteve të krimeve apo shkeljeve të ligjit për një avokat.¹¹¹

¹⁰⁶ Për një hartë të shteteve në sajë të dy sistemeve, shih më lartë, Raport special mbi Programet shtetërore për mbrojtës publikë 2007, f.1. Gjithashtu shih: Regjistrimi i programeve të mbrojtësve publikë, 2007, Raporti special, Zyra e Statistikave të Drejtësisë, Departamenti i Drejtësisë, shtator 2010, NCJ 228.229, f.2.

¹⁰⁷ Për më tepër informacione, shih më sipër Karrierat në mbrojtjen e të varfërve, Doracak i shpejtë në Programet e mbrojtësve publikë.

¹⁰⁸ Regjistri i Programeve për mbrojtës publikë, 2007, Raporti Special, Byroja e Statistikave të Departamentit të Drejtësisë, të SHBA-ve, shtator 2010, NCJ 228.229, f.

¹⁰⁹ E njëjta., f.1

¹¹⁰ E njëjta, f.14.

¹¹¹ E njëjta, f.12

Buxheti dhe financimi

Burimi i financimit të programeve për mbrojtës publikë rrjedh kryesisht nga buxhetet publike, qoftë ato të jenë lokale, shtetërore për PMP-të shtetërore ose federale për PMP-të federale. PMP-të shtetërore janë ose të mbështetura plotësisht nga buxheti i shtetit kur programi shtrihet në tërë shtetin ose janë të administruara nga fondet e qarkut, ose nga një përzjerje të fondeve të qarkut dhe të shtetit. Sipas Raportit të posaçëm mbi Regjistrat e Zyrës së Mbrojtësve publikë të bërë për programet shtetërore të vitit 2007 rreth 14 për qind të shpenzimeve totale të shtetit për të gjitha funksionet gjyqësore dhe ligjore në vitin 2007.¹¹² Mesatarja prej 15% të shpenzimeve shtetërore ligjore dhe gjyqësore kanë shkuar për programet për mbrojtës publikë.¹¹³

ZMQ-të në pjesën më të madhe janë financuar nga grandet nga Konferenca Federale Gjyqësore, edhe pse disa janë paguar në bazën rast-pas-rasti. Ato dallojnë në madhësi dhe kompensimi i tyre nuk është pjesë e sistemit federal, siç është rasti me Zyrat për Mbrojtës Publikë (ZMP) Federal.

PMP të caktuara kërkojnë që përfituesit e mbrojtjes së të varfërve të kontribuojnë në sistemin i cili ka siguruar se ai ka qenë i mbrojtur në mënyrë përkatëse. Këto kontribute e marrin formën e kompensimit, shënime premtimi dhe tarifa të aplikimit. Ndonjëherë, disa nga këto tarifa do të kërkojnë në të njëjtën procedurë. Dallimi kryesor midis këtyre tri formave të kontributit është pika në të cilën pagesa është e vlerësuar. Në të vërtetë, përderisa tarifat e aplikimit janë të vendosura në fillim të procedurës, shënimet e premtimit janë të vlerësuara në pika të ndryshme të rastit ndërsa kompensimi aplikohet në përmbyllje të një rasti. Lartësia e vlerësimit gjithashtu ndryshon: vlerësimet e tarifës së aplikimit zakonisht janë nominale, shumat fikse duke filluar nga 10\$ në 200\$, ndërsa shënimet e premtimit, të bazuara në atë se sa individë do të jenë të aftë të kontribuojnë, në përgjithësi kërkojnë shuma më të mëdha. Ngarkesat e kompensimit zakonisht e reflektojnë shumën e siguruar të përfaqësimit. Kritikat për parimin e ngarkesës së të varfërve për mbrojtjen e tyre dalin nga shqetësimi se kjo mund ta dekurajojë kërkesën potenciale për ndihmë juridike dhe ta inkurajojë vetë-përfaqësimin, midis mangësive të tjera.¹¹⁴

¹¹² Regjistri i programeve të mbrojtësve publikë, 2007, Raporti i posaçëm, Byroja e Statistikave të drejtësisë, Departamenti i SHBA-ve i drejtësisë, shtator 2010, NCJ 228229, f. 1.

¹¹³ Regjistri i programeve të mbrojtësve publikë, 2007, Raporti i posaçëm, Byroja e Statistikave të drejtësisë, Departamenti i SHBA-ve i drejtësisë, shtator 2010, NCJ 228229, f. 5

¹¹⁴ Shih më sipër, Tarifat për zbatimin e mbrojtësve publikë: 2001, Rregullim f.3 Gjithashtu shih për rishikimin e praktikave juridike para gjykatave shtetërore dhe federale, E drejta kushtetuese: kompensim i shpenzimeve të mbrojtjes së të varfërve, Hood, Michael D., 14 Washburn L.J. 146 (1975).

Kushtet e përshtatshmërisë

Para aplikimit për ndihmë juridike një klient në SHBA duhet të konstatohet se është i varfër, nga gjykata ose nga zyra e Avokatit të popullit gjë e cila është e përcaktuar nga statuti. Në shumë shtete çdo zyrë është e lirë që individualisht t'i nxjerrë kriteret e veta për përcaktimin e varfërisë.¹¹⁵ Më shpesh, pranueshmëria për caktimin e avokatit përfshin një plan gjithëpërfshirës i cili përmban rregulla të aplikueshme dhe procedura për përcaktimin e pranueshmërisë për caktimin e avokatit në saje të shpenzimeve publike, dhe ju kushton vëmendje të posaçme dispozitave vijuese dhe/ose gjendjes së klientit:

- Vështirësi e konsiderueshme;
- Aftësia për lirim me dorëzani,
- Punësimi (niveli i të ardhurave);
- Pranimi i ndihmës sociale;
- Aplikimi nën betim;
- Nivel i borxhit;
- Udhëzimet federale për varfërinë,
- Qëndrimi në institucione publike (të tilla si institucione publike të shëndetit mendor ose institucione përmirësuese);
- Diskrecioni i gjykatësit;
- Aplikime që nuk janë të bëra nën betim, dhe
- të tjera. Avokati nuk do t'i mohohet ndonjë personi vetëm për shkak se ai është i punësuar.¹¹⁶

Përcaktimi i përshtatshmërisë për caktimin e avokatit e përfshin vlerësimin si për shpenzimet e angazhimit të avokatit privat dhe përcaktimi nëse një person me të ardhura dhe me pronë që disponon, me mjete të mjaftueshme për t'i mbuluar shpenzimet për marrjen e avokatit privat. Përcaktimi i shpenzimeve të caktimit të avokatit privat në mënyrë tipike bazohet në natyrën e akuzës së ngritur, kompleksitetin e parashikuar të mbrojtjes, shpenzimet e përgjithshme për përfaqësimin nga një mbrojtës ligjor, si dhe tarifat të cilat kërkohen nga avokatët në komunitetin për ofrimin e shërbimeve të mbrojtjes në rastet e ngjashme. Shpesh herë zyrat i aplikojnë normat e përgjithshme të tilla si “në qoftë se klienti nuk mund japë asgjë për dorëzani ai/ajo do të konsiderohet i varfër”, gjë e cila ka tendencë të jetë e paqëndrueshme dhe jo gjithmonë aplikohet në mënyrë të njëtrajtshme.¹¹⁷

¹¹⁵ Grupi Spangenberg, Përcaktimi i përshtatshmërisë për mbrojtës publikë, maj i vitit 2002, f.2.

¹¹⁶ Regjistrimi i programeve të mbrojtjes publike, Shtator i vitit 2007, Raporti Special, Zyra e Statistikave të Drejtësisë, Departamenti i Drejtësisë së SHBA-ve, shtator 2010, NCJ 228.229, f.6.

¹¹⁷ Grupi Spangenberg, Përcaktimi i përshtatshmërisë për mbrojtës publikë, maj i vitit 2002, f.2.

Mjeti kundër vendimit për refuzimin e ndihmës juridike falas dhe tërheqja e ndihmës juridike

Në shumicën e shteteve të pandehurit nuk kanë të drejtë që t'i zgjedhin avokatët e caktuar nga gjykata. Nëse janë të pakënaqur me përfaqësimin, të pandehurit mund të kërkojnë avokat të ri të caktuar nga gjykata. Në Nju Hempshajr, për shembull, një i pandehur mund të kërkojë që mbrojtësi i tanishëm publik të plotësojë një mocion për t'u tërhequr nga rasti, të kërkojë nga Zyra e mbrojtësve publikë që të fitojë një caktim të ri për rastin dhe më në fund, të kërkojë nga gjykatësi një seancë për shkarkimin e tij/saj përkatësisht të avokatit të caktuar nga gjykata. Pasi avokati do të plotësojë një mocion për t'u tërhequr nga rasti, gjykata do të mbajë një seancë dëgjimore për të vendosur nëse avokati mund të tërhiqet. Klientit gjithashtu mund t'i kërkohet ta shpjegojë nevojën për mbrojtës të ri publik. Rregullat e shumë shteteve të SHBA-ve për sjellje profesionale ju lejojnë avokatëve të tërhiqen, në qoftë se ka një mosmarrëveshje thelbësore në mes të avokatit dhe klientit. Gjykatësi i rastit është autoriteti përfundimtar. Kur një kërkesë e tillë është mohuar nga gjyqtari, i pandehuri ose duhet ta mbajë mbrojtësin e caktuar ose ai/ajo ta përfaqësojë veten.

Përcaktimi i përshtatshmërisë për mbrojtje publike është bërë nga mbrojtësi, kontraktorët e shërbimeve, avokatë të caktuar, agjenci për shqyrtim neutral ose nga gjykata. Kur përcaktimi i përshtatshmërisë nuk bëhe nga gjykata, konfidencialiteti ruhet dhe përcaktimi bëhet subjekt i shqyrtimit nga gjykata me kërkesë të një personi për të cilin është gjetur se është i papërshtatshëm. Për ta determinuar natyrën dhe për t'i zgjeruar burimet financiare për sigurimin e përfaqësimit është përdorur një pyetësor. Nëse në ndonjë fazë të mëvonshme të procedurës që ka të bëjë me përshtatshmërinë vihet në dispozicion një informacion i ri, përshtatshmëria duhet të ri-determinohet.¹¹⁸

Reformimi i sistemit / problemit

Ka tregues se sistemi i drejtësisë i SHBA-ve ka nevojë urgjente për të trajtuar se si ai ju përgjigjet kërkesave në rritje për avokatë publikë. Më herët është raportuar se mbi 80 për qind të të akuzuarve nuk mund ta përballojnë angazhimin e një ekipi mbrojtës nga fondet private, dhe në këtë rast pritet që shteti të sigurojë një avokat kompetent për t'i përfaqësuar.¹¹⁹ Meqë niveli i kërkesës për ndihmë ligjore falas

¹¹⁸ Grupi Spangenberg, Përcaktimi i përshtatshmërisë për mbrojtës publikë, maj i vitit 2002, f.23, Standardi 5-7.3 të Standardeve të Asociacionit amerikan të avokatëve për drejtësi penale që sigurojnë shërbime të mbrojtjes.

¹¹⁹ Tiffany Edwards Fortney, Rezultate: "Kriza e mbrojtësve të të varfërve në Shtetet e Bashkuara, Rezultate publikimi, Çështja 8, 2010, f.1. Departamenti i Drejtësisë për fillimin e programit për mbrojtje të të varfërve. NPR. 26 shkurt 2010. <http://www.npr.org/templates/story/story.php?storyId=124094017>.

në SHBA gjatë dy viteve të fundit është rritur ndjeshëm, është bërë e pamundur për shumë shtete të SHBA-ve të sigurojnë avokatë me nivel të duhur të kualifikimeve. Si rezultat i kësaj mungesa e qasjes së barabartë në drejtësi është bërë një çështje kritike.¹²⁰ Nevojat më të mëdha janë vërejtur në sistemin e drejtësisë për të miturit, për arsye se lidhen me mungesën e komunikimit efektiv të të pandehurve, si dhe mungesë e avokatëve të trajnuar mirë dhe të përshtatshëm për mbrojtjen e të varfërve.

Për t'i adresuar këto probleme më 1 mars të vitit 2010 ka filluar një nismë e re e quajtur Qasje në Iniciativën për Drejtësi (QID) me qëllim që ta rivendosë ekuilibrin mes rasteve që kërkojnë mbrojtje të të varfërve dhe numrit të avokatëve në dispozicion për ta përshpejtuar këtë shërbim.¹²¹ Ky zhvillim ka marrë mbështetje thelbësore nga Avokati i përgjithshëm i SHBA-ve, Eric Holder. Disa programe që lidhen me QID tashmë janë duke u zhvilluar në mbarë vendin. Një nismë mbështet bursa trevjeçare me të cilat individët pranojnë trajnim për të filluar të punojnë si avokat penal mbrojtës në fushat në të cilat ka nevojë më të madhe.¹²² Programe të tjera kanë iniciuar ndihmë për përmirësimin e sistemit nga të mbrojturit dhe qytetarët në përgjithësi.¹²³

Për më tepër, përderisa ka nevojë në rritje e sipër për avokatë pro bono (për të mirën publike) dhe me që kriza ekonomike ka bërë që firmat e mëdha ligjore ta vonojnë rekrutimin e studentëve të jurisprudence dhe i mbështesin për punë njëvjeçare në institucionet shtetërore,¹²⁴ papritur, shumë prej këtyre personave nuk kanë zgjedhur që të kthehen në tregun privat, të tërhequr nga thirrja për t'u shërbyer komuniteteve të tyre dhe për të garantuar efektivitetin e drejtësisë për të pa privilegjuarit.¹²⁵

Ndërkohë, qasja e re në nismën për drejtësi, gjithashtu, synon promovimin e shkëmbimit me ministritë e jashtme të drejtësisë për të krijuar sisteme më të

¹²⁰ E njëjta, f.1.

¹²¹ E njëjta, f.1.

¹²² Tiffany Edwards Fortney, Rezultate: "Kriza e mbrojtësve të të varfërve në Shtetet e Bashkuara, Rezultate Publikimi, Çështja 8, 2010, f.2.

¹²³ Laurie Robinson. Shoqata e Avokatëve Amerikanë. Simpoziumi-darkë i mbrojtësve kombëtarë publikë, e enjte, 20 maj, 2010, Knoxville, TN. http://www.ojp.usdoj.gov/newsroom/speeches/2010/10_0520lrobinson.htm

¹²⁴ Lisa Faye Petak, Avokatët e rinj i kthehen shërbimit publik, New York Times. 19 gusht 2010. http://www.nytimes.com/2010/08/20/us/20defer.html?_r=1&hp

¹²⁵ Tiffany Edwards Fortney, Rezultate: "Kriza e mbrojtësve të të varfërve në Shtetet e Bashkuara, Rezultate Publikimi, Çështja 8, 2010, f.3

paanshme, dhe përmes shpërndarjes së praktikave më të mira bëhen përpjekje për ta plotësuar këtë iniciativë të SHBA-ve dhe gjetiu në mbarë botën.¹²⁶

Megjithatë, situata edhe më tej komplikohet me faktin se avokatët të cilët janë siguruar për të varfrit, shpesh nuk mund t'i përfaqësojnë klientët e tyre siç duhet për shkak të burimeve të pamjaftueshme dhe të mbikëqyrjes së pamjaftueshme, pa krijimin e bllokut të një sistemi të mbrojtësve publikë që funksionon mirë, lloj i sistemit që është përcaktuar në dhjetë parimet e Odës së ëë. Avokati i përgjithshëm amerikan Eric Holder ka vënë në pah se përpjekjet duhet të fokusohen në tri fusha kryesore: në dialog mes njerëzve në biznes, në ngritje të vetëdijes për përhapjen e plotë të problemeve dhe të sfidave, si dhe në zgjerim të rolit të mbrojtësve publikë për të gjetur zgjidhje jashtë sallave të gjyqimit për formulimin e politikave dhe për fuqizimin e komuniteteve.

▪ **Modeli i Francës**

Ndryshe nga Shtetet e Bashkuara, Franca ka një sistem të unifikuar për dhënien e ndihmës ligjore falas. Edhe pse sistemi i ndihmës ligjore i përshkruar në paragrafët vijues është menaxhuar nga aktorë të ndryshëm lokalë, ai mbetet i unifikuar në funksionimin e tij në mbarë vendin. Që nga viti 1991, sistemi ligjor i Francës ofron ndihmë juridike për qytetarët e tij dhe për ata në territorin e saj që kanë nevojë për asistencë ligjore. Ndihma juridike në modelin e Francës është një parim i përgjithshëm që përfshin të drejta të ndryshme. Domethënë, ajo përfshin:

- Ndihmën e përshtatshme ligjore: ndihmë financiare për procedurat gjyqësore dhe për procedurat e marrëveshjes jashtë-gjyqësore;
- Ndihma sipas tarifave të avokatëve në procedurat penale të cilat janë alternative për procedurën penale (marrëveshje dhe ndërmjetësim), ndihmë ligjore për ata që janë mbajtur nga policia për marrje në pyetje, dhe për procedurat disiplinore në burgje, dhe
- Qasje në të drejtën (informacion, udhëzim, këshillim ligjor falas).¹²⁷

Sistemi aktual i ndihmës juridike është përshkruar dhe rregulluar në Ligjin për ndihmë juridike të datës 10 qershor të vitit 1991¹²⁸ dhe në Dekretin e 19 dhjetorit të vitit 1991.¹²⁹

¹²⁶ E njëjta, f.3

¹²⁷ Shih Prezantimin e skemës së ndihmës juridike franceze, Rrjeti Gjyqësor Evropian në çështjet civile dhe tregtare, në dispozicion në # 2 http://ec.europa.eu/civiljustice/legal_aid/legal_aid_fra_en.htm.

¹²⁸ Shih Ligjin e Francës për ndihmë juridike (Loi n°91-647 du 10 juillet 1991 relative à l'aide juridique)

¹²⁹ Shih Dekretin e Francës për ndihmë juridike (Décret n°91-1266 du 19 décembre 1991 portant application de la loi n° 91-647 du 10 juillet 1991 relative à l'aide juridique).

Sistemi i ndihmës ligjore në Francë¹³⁰

Ky studim fokusohet në ndihmën përkatëse juridike e cila është e paramenduar si ndihmë financiare e dhënë nga ana e shtetit për personat me të ardhura të ulëta për t'u mbuluar pagesat e drejtësisë në tërësi ose pjesërisht (tarifat e avokatit, agjentët e zbatimit dhe tarifat e ekspertëve etj.) Kur një person nuk mund të gjejë një avokat, avokatin do t'ia emërojë ndihma juridike. Ndhma juridike është në dispozicion për të gjitha llojet e procedurave gjyqësore, pa marrë parasysh, nëse çështja është në fazën e gjykimit apo në atë kalimtare (transaksionet jashtë-gjyqësore), në rastet civile, penale ose administrative).¹³¹

Benefitet e ndihmës juridike mund të jenë të plota ose të pjesshme, përkatësisht shteti mund ta marrë përgjegjësinë ose për të gjitha shpenzimet që lidhen me procedurat juridike ose vetëm për një pjesë të tyre, ndërsa përfituesi e mban përgjegjësinë mbi pjesën tjetër të tyre.¹³² Ndhma e pjesshme juridike përfaqëson një përqindje të shpenzimeve të cilat do të mbulohen nga shteti.

Tabela vijuese i përmbledh pjesët e mbuluara nga shteti në vitin 2010 varësisht nga të ardhurat mujore të aplikuesit:¹³³

Të ardhura mujore midis	Pjesa e mbuluar me ndihmë juridike
915€ ose mbi këtë shume	100%
916 € dhe 957 €	85%
958 € dhe 1.009 €	70%
1.010 € dhe 1.082 €	55%
1.083 € dhe 1.165 €	40%
1.166 € dhe 1.269 €	25%

Tarifat e mbetura që duhet të paguhet nga përfituesi me avokatin e zgjedhur janë të përcaktuara përmes marrëveshjes për taksat e avokatit.¹³⁴ Kryetari i odës së avokatëve brenda 15 ditëve nga nënshkrimi i saj duhet të marrë një kopje të marrëveshjes së taksës dhe atë ta miratojë. Është në përgjegjësi të kryetarit të sigurojë se tarifat e kontraktuara të avokatit janë në përputhje me mundësitë e përfituesit.¹³⁵

¹³⁰ Për më shumë informacione të detajuara mbi skemën e ndihmës juridike në Francë, shih Prezantimin për ndihmë ligjore në faqen e internetit të shërbimeve publike (në dispozicion në gjuhën frënge në <http://vosdroits.service-public.fr/F18074.xhtml>).

¹³¹ Shih nenin 10 të Ligjit francez për ndihmë juridike.

¹³² Shih nenin 4 të Ligjit francez për ndihmë juridike.

¹³³ Shih letrën qarkulluese të Ministrisë Franceze të Drejtësisë, Circ. JUS SADJPV, 31 Dhjetor. 2009 (Në Justice n°2010/1 të 28 shkurtit 2010).

¹³⁴ Shih nenet 24 dhe 35 të Ligjit francez për ndihmë juridike.

¹³⁵ Shih nenin 35 të Ligjit francez për ndihmë juridike.

Në vitin 2008, diku rreth 886 337 persona janë pajisur me ndihmë juridike pa pagesë, përfshirë edhe 396 992 persona për çështje penale.¹³⁶

Financimi i ndihmës ligjore falas

Buxheti i dedikuar për ndihmë ligjore falas është pjesë e buxhetit vjetor të Ministrisë së Drejtësisë në shenjë të “qasjes ndaj ligjit dhe drejtësisë”. Në vitin 2010 kjo pjesë arriti në rreth 295 milionë euro.¹³⁷ Për vitin 2008, buxheti aktual i alokuar për ndihmë juridike ka qenë i përcaktuar afërsisht 306 milion euro.¹³⁸ Në mikro-nivel, buxheti i ndihmës juridike është menaxhuar nga Odat lokale të avokatëve të cilat marrin ndarje financiare për çdo vit.¹³⁹

Funksionimi i ndihmës juridike falas

Ndihma juridike është e menaxhuar dhe sigurohet nga byroja e ndihmës juridike në Gjykatën regjionale ose “*Tribunal de Grande Instance*”. “Harta” e tanishme juridike përmban 181 gjykata rajonale¹⁴⁰ të cilat janë përgjegjëse për trajtimin e të gjitha parashtresave për ndihmë juridike të bëra në të gjitha gjykatat që bien nën juridiksionin e tyre: Gjykatat e qarkut ose “*Tribunal d’Instance*”, gjykatat administrative, Tribunalet për marrëdhënie pune, Gjykatat e Apelit dhe Gjykatat Administrative të Apelit, gjithashtu, janë vendosur në byro specifike për ndihmë juridike në Gjykatën e Kasacionit; *Conseil d’État* (gjykata supreme administrative) dhe te Bordi për ankesa të refugjatëve.

Prandaj, Gjykata rajonale i trajton të gjitha kërkesat për ndihmë juridike në çështjet penale, duke i marrë parashtresat nga *Tribunal Correctionnel* i cili i trajton kundërvajtjet, *Cour d’Assises* i trajton krimet më serioze – të dy juridiksionet e pranuar në premisat e Gjykatës rajonale – dhe *Tribunal de Police* i cili merret me kundërvajtjet – i vendosur në Gjykatën e qarkut.

¹³⁶ Shih Ministère de la Justice et des Libertés, Les Chiffres-clés de la Justice 2009, page 31, në dispozicion në <http://www.justice.gouv.fr/budget-et-statistiques-10054/chiffres-cles-de-la-justice-10303/les-chiffres-cles-de-la-justice-18078.html>.

¹³⁷ Shih Ligjin e Francës për financat publike për vitin 2010, të miratuar më 30 dhjetor të vitit 2009 (LOI n° 2009-1673 du 30 décembre 2009 de finances pour 2010 (1)).

¹³⁸ Shih Ministère de la Justice et des Libertés, Les Chiffres-clés de la Justice 2009, faqja 6. Këto shifra përfshijnë tarifën e tjera ligjore të mbuluara nga ndihma juridike të tilla, siç janë tarifën për ekspertë juridikë, mbrojtës apeli, agjentë përmbarimi e të tjera.

¹³⁹ Shih nenin 27 të Ligjit për ndihmë juridike të vitit 1991.

¹⁴⁰ Reforma e filluar në vitin 2007 do të zvogëlojë në mënyrë progresive numrin e gjykatave në Francë, përfshirë edhe Gjykatat rraoalee. Nga viti 2011, do të ketë vetëm 158 tribunaux de grande instance sepse 23 do të suprimohen, prandaj me këtë rast duke e zvogëluar numrin e byrove të ndihmës juridike. Për më tepër informacione, shih ueb faqen e Ministrisë së Drejtësisë të Francës për reformat në hartën juridike, në dispozicion në <http://www.carte-judiciaire.justice.gouv.fr/index.php>.

Kushtet e përshtatshmërisë për ndihmë juridike

Ndihma juridike në sistemin francez i është nënshtruar përmbushjes së kërkesave specifike të tilla, siç janë: burimet, shtetësia dhe vendbanimi, si dhe pranueshmëria.

Burime - Sistemi francez përcakton limite shumë të qarta financiare për alokimin e ndihmës juridike. Ministria e Drejtësisë çdo vit e përcakton pragun e aplikueshëm në saje të të cilit është përcaktuar pranueshmëria. Një person ka të drejtë për ndihmë ligjore në qoftë se mesatarja e të gjitha burimeve të tij (me përjashtim të disa përfitimeve sociale dhe kompensimeve familjare) për vitin paraprak kalendarik nuk e tejkalon pragun e përcaktuar nga ministria.¹⁴¹

Nga 1 janari i vitit 2010, pragu i të ardhurave mujore për të marrë ndihmë të plotë juridike për një person është 915 € dhe 1,372 € për të përfituar nga ndihma e pjesshme ligjore.¹⁴² Burimet financiare që merren në konsideratë janë të ardhurat nga puna, qiraja, të ardhurat private, përfitimet nga dalja në pension dhe mbështetjet financiare të kërkuesit dhe partnerit të tij apo të saj dhe njerëzit e tjerë të familjes së njëjtë.¹⁴³ Si përjashtim, një individ burimet financiare të të cilit e tejkalojnë limitin ligjor, mund të përfitojë nga ndihma juridike në qoftë se gjendja e tij është me interes të posaçëm, sa i përket çështjes dhe shpenzimeve të parapara për procedurën.¹⁴⁴ Persona të caktuar, si ata që përfitojnë nga Fondi kombëtar i solidaritetit ose nga të ardhurat minimale në saje të punësimin dhe ata që kanë qenë viktime të veprave më serioze (shembull: akte torturimi dhe barbare etj.) janë të liruar nga vlerësimi i gjendjes së tyre financiare.¹⁴⁵

Shtetasit dhe rezidentët - Vetëm shtetasit francez, qytetarët e Bashkimit Evropian apo shtetasit e huaj që banojnë në baza të rregullta dhe ligjore në Francë kanë të drejtë për ndihmë juridike pa pagesë.¹⁴⁶ Si përjashtim, Ligji i Francës lejon ndihmë juridike falas për shtetasit e huaj të cilët janë të mitur, dëshmitarë, nën hetime, të akuzuar, të paditur ose palë të dëmtuara në ndjekjen penale, ose ku hapat e përfshira procedurale kërkojnë hyrje dhe qëndrim në Francë, pavarësisht nga gjendja e shtetësisë.¹⁴⁷

¹⁴¹ Shih nenin 5 të Ligjit francez për ndihmë juridike.

¹⁴² Shih më lartë Letrën qarkore të Ministrisë Franceze të Drejtësisë. Në të dy rastet limiti është rritur për 165 euro për dy të varurit e parë dhe me 104€ për të varurin e tretë dhe ata vijues.

¹⁴³ Shih nenin 5 të Ligjit francez për ndihmë juridike.

¹⁴⁴ Shih nenin 6 të Ligjit francez për ndihmë juridike.

¹⁴⁵ Shih nenin 9-2 të Ligjit francez për ndihmë juridike.

¹⁴⁶ Shih nenin 3 të Ligjit francez për ndihmë juridike. Gjithashtu, shtetasve të shtetit që kanë marrëveshje ndërkombëtare ose bilaterale me Francën gjithashtu u jepet mundësi për ndihmë juridike.

¹⁴⁷ Shih nenin 3 të Ligjit francez për ndihmë juridike.

Pranueshmëria – Pranueshmëria e kërkesës ligjore përbën një kusht për alokimin e ndihmës juridike. Hapat proceduralë, si të tillë, që janë haptazi të papranueshëm ose të liruar nga substancialja nuk do të mbështeten nga ndihma juridike. Megjithatë, të pandehurit, personat që bartin përgjegjësi civile, dëshmitarët, personat nën hetim ose personat e akuzuar, nuk duhet të dëshmojnë se kërkesa e tyre është e pranueshme.¹⁴⁸

Mjeti kundër vendimit për refuzimin e ndihmës juridike falas dhe tërheqja e ndihmës juridike

Në rastin kur lutja e kërkuesit për ndihmë juridike është refuzuar ajo/ai mund të kërkojë që byroja për ndihmë juridike ta rishqyrtojë vendimin, nëse refuzimi ka qenë i motivuar nga shkalla e tij e të ardhurave. Si alternativë kërkuesi mund t'i dërgojë një kërkesë Kryetarit të gjykatës përkatëse rajonale.¹⁴⁹

Përfituesit e ndihmës juridike janë të detyruar që në saje të ligjit zyrës kompetente t'ia raportojnë çdo ndryshim në gjendjen e tyre financiare ose të rrezikojnë tërheqje të tërësishme ose të pjesëshme të përfitimit të ndihmës juridike.¹⁵⁰ Vendimi për tërheqje mund të bëhet edhe në qoftë se gjykata konstaton abuzim të procedurës ose në rastet kur ata hapa që janë marrë kanë për qëllim vonesën e procedurave.¹⁵¹

Reformimi i sistemit të ndihmës juridike në Francë

Gjatë disa viteve të fundit, pas krijimit të sistemit të ndihmës juridike në vitin 1991, një numër në rritje e sipër të praktikuesve të ndihmës juridike në Francë, e kanë kritikuar funksionimin e ndihmës juridike, duke e përshkruar atë se është “në krizë”.¹⁵² Pika kryesore e kontestit është rritja e aplikimeve për ndihmë juridike që nga viti 2001 dhe, për këtë arsye, ka shpenzime më të larta për drejtësinë në shtet.¹⁵³ Për ta krijuar reformën e mundshme janë zhvilluar disa linja të mendimit duke u fokusuar mes tjerash në gjetjen e mënyrës për financimin e sistemit dhe për identifikimin e modelit dhe të procedurave për rimarrjen e pagesave gabimisht të aplikuara të ndihmës juridike.¹⁵⁴ Një opsion i diskutueshëm është duke u marrë në konsiderim – ngarkimi i përfituesit me taksa për

¹⁴⁸ Shih nenin 7 të Ligjit francez për ndihmë juridike.

¹⁴⁹ Shih nenin 22 të Ligjit francez për ndihmë juridike.

¹⁵⁰ Shih nenin 50 të Ligjit francez për ndihmë juridike.

¹⁵¹ Shih nenin 50 të Ligjit francez për ndihmë juridike.

¹⁵² Shih Raportin Informativ të vitit 2007 për ndihmën juridike në Francë të përgatitur nga senatori, Z-ti Roland du Luart, në dispozicion në gjuhën frënge në <http://www.senat.fr/rap/r07-023/r07-0231.pdf>

¹⁵³ Për më shumë informacion mbi gjendjen e sistemit të ndihmës juridike në Francë, shih më lartë Raportin Informativ të vitit 2007 për ndihmën juridike në Francë.

¹⁵⁴ Shih Projekt-Ligjin mbi Modernizimin e profesioneve të rregulluara gjyqësore dhe ligjore të paraqitura në Parlamentin francez, më 13 korrik të vitit 2010 dhe aktualisht në diskutim. Shih gjithashtu Raportin për profesione juridike të porositura nga Presidenti i Republikës, përgatitur nga Komisionit Darrois të udhëhequr nga z. Jean-Michel Darrois, Mars 2009.

disa procedura ligjore - një zgjidhje në kundërshtim me parimin e ndihmës juridike, thonë kritikuesit. Sipas këtij opsioni, tarifat për lutje gojore, aktualisht të vlerësuara me 8,84 € për lutje gojore, do të paguhen nga përfituesi i ndihmës ligjore në mënyrë që të jipet një kontribut të caktuar për këtë shërbim publik dhe për t'i shmangur abuzimet.¹⁵⁵

- Modeli ndërkombëtar i juridiksionit penal: shembull nga GJNPJ

Duke pasur parasysh se duhet të sigurohen të drejtat për mbrojtje, posaçërisht në procedurat ku përfshihen krime më të rënda, gjykatat penale ndërkombëtare, si GJNPJ-ja kanë krijuar skemë të detajuar për të siguruar ndihmë juridike për të pandehurit e varfër. Shembulli i GJNDPJ-së është më i përshtatshëm, sepse duke qenë më i vjetër nga gjykatat e tilla që zhvillojnë një sistem të ndihmës juridike, e ka zhvilluar edhe programin më të sofistikuar të ndihmës juridike. Seksioni vijues i përkushtohet ndihmës juridike të Tribunalit të Hagës për të pandehurit e varfër.

Fushëveprimi i ndihmës juridike

Sipas programit të ndihmës ligjore të vendosur në kuadër të GJNPJ-së, i dyshuari ose i akuzuari i cili nuk është në gjendje t'i përballojë shërbimet juridike të avokatit ka të drejtë për këshilla profesionale juridike, plotësisht ose pjesërisht, të paguara nga Tribunali.¹⁵⁶

Tribunali në thelb mbulon dy lloje të pagesave: shpërblimin e avokatëve dhe anëtarëve të ekipit të mbrojtjes dhe shpenzimet që lidhen me përgatitjen e lëndës. Shpërblimi i mbrojtësit juridik mbulon: "përgatitjen dhe paraqitjen e rastit të mbrojtjes, duke përfshirë shqyrtimin e aktakuzës, të materialeve mbështetëse dhe të gjitha dokumentet e tjera të ofruara nga prokuroria ose të mbledhura përmes hetimeve të mbrojtjes, paraqitjen e mocioneve, intervistimin e dëshmitarëve, hulumtimet dhe argumentimin e rastit në gjykatë."¹⁵⁷

Sipas programit të ndihmës juridike, Tribunali gjithashtu i mbulon taksat që kanë të bëjnë me përgatitjen e mbrojtjes për rastin, siç janë prodhimi i provave, raportet e ekspertëve, punësimi i konsulentëve të përkohshëm, transporti dhe akomodimi i dëshmitarëve të tjera.¹⁵⁸

¹⁵⁵ Shih nenin 41 të Projekt ligjit për financat publike për vitin 2011, aktualisht në diskutim e sipër në Parlamentin francez - në dispozicion në gjuhën frënge në <http://www.assemblee-nationale.fr/13/projets/pl2824.asp>

¹⁵⁶ Shih nenin 6 të Direktivës për caktimin e avokatit mbrojtës (Direktiva nr. 1/94) të plotësuar më 29 qershor të vitit 2009 (në dispozicion në <http://www.icty.org/sections/LegalLibrary/Defence>).

¹⁵⁷ Shih Prezantimin e skemës për ndihmë juridike në ueb faqen e GJNPJ-së në <http://www.icty.org/sid/163>.

¹⁵⁸ Shih nenin 23 (B) të Direktivës për caktimin e avokatit mbrojtës (Direktiva nr. 1/94) të plotësuar më 29 Qershor të vitit 2009.

Financimi i ndihmës juridike

Skema e ndihmës juridike e GJNPJ-së është e mbuluar nga buxheti vetanak i Tribunalit. Ajo paraqet afërsisht 11% të buxhetit vjetor, ose për vitin 2010, rreth 16,5 milion usd.¹⁵⁹

Funksionimi i sistemit të ndihmës juridike

Ndihma juridike është menaxhuar nga Zyra e Sekretariatit të Tribunalit për Ndihmë Juridike dhe Çështjet të Paraburgimit (OLAD) e cila përgjigjet për përcaktimin nëse një i akuzuar ka të drejtë të plotë ose të pjesshme për ndihmë juridike. Për t'i mundësuar këto operacione, Sekretariati, brenda radhëve të tij, i ka hetuesit financiarë të ngarkuar me përcaktimin e gjendjes reale financiare të të pandehurit. Elementet e marra parasysh nga ana e Sekretariatit për të arritur një vendim mbi vobektësinë e të pandehurit janë "mjetet e të gjitha llojeve të cilat i dyshuari ose i akuzuari i disponon në mënyrë të drejtpërdrejtë, të tërthortë ose të lirë, që përfshihen në të ardhurat e të drejtpërdrejta, llogaritë bankare, pasuritë e patundshme ose personale, pensionet, si dhe aksionet, letra-obligacionet ose pasuri të tjera të poseduara, duke përjashtuar ndonjë përfitim familjar apo ndihmë sociale për të cilën ai mund të ketë të drejtë."¹⁶⁰ Pasuritë e bashkëshortit të të pandehurit ose të personave që e përbëjnë familjen e tij gjithashtu shqyrtohen nga Sekretariati.

Një sërë faktorësh të cilët i ka përdorur Sekretariati për ta shqyrtuar shkallën në të cilën t'i jepet ndihmë ligjore të pandehurit ka të bëjë me kompleksitetin e çështjes, të tillë si "pozicioni i të akuzuarit në hierarkinë politike dhe ushtarake; numri dhe natyra e akuzave në aktakuzën, numri dhe lloji i dëshmitarëve dhe i dokumenteve të përfshira, nëse rasti i përfshin krimet e kryera në një numër të komunave, si dhe risinë dhe kompleksitetin e argumenteve ligjore dhe faktike me të cilat do të merret rasti".¹⁶¹

Mjeti kundër vendimit për refuzimin e ndihmës juridike

I pandehuri, të cilit i është refuzuar ndihma juridike, mund të ankohet për vendimin e Sekretariatit brenda pesëmbëdhjetë ditëve pas njoftimit për refuzimin, duke parashtruar një kërkesë për shqyrtim para Presidentit të Tribunalit, në qoftë se ai është ende një i dyshuar, ose para Dhomës, në qoftë se ai është i akuzuar.¹⁶²

¹⁵⁹ Kalkulim i bazuar në buxhetin dyvjeçar të GJNPJ-së për vitin 2010-2011 të përcaktuar në usd 301.895.900, 00, shih prezantimin e kostos së drejtësisë në ueb-faqen e GJNPJ-së në <http://www.icty.org/sid/325>.

¹⁶⁰ Shih Nenin 10 të Direktivës për Caktimin e avokatit mbrojtës.

¹⁶¹ Shih Paragrafin 22 të Avokatit mbrojtës-Politika për ndihmë juridike para gjyqimit e Sekretariatit të Tribunalit, të adoptuar më 1 Maj të vitit 2006 dhe Prezantimi i skemës të ndihmës juridike në ueb-faqen e GJNPJ në <http://www.icty.org/sid/163>.

¹⁶² Shih nenin 13 të Direktivës për Caktimin e avokatit mbrojtës.

Tërheqja e ndihmës juridike

Nëse Sekretariati konstaton se i pandehuri i ka mjetet për të paguar për mbrojtjen e tij ose për shkak se gjendja e tij ka ndryshuar, ose ai nuk e ka prezantuar plotësisht gjendjen e tij financiare ligjore ndihma juridike mund të tërhiqet për atë të mbrojtur/të akuzuar të caktuar. Gjykata mund të vazhdojë me rishikimin e pagesave të bëra.¹⁶³

Abuzimet në sistemin e ndihmës juridike

Sistemi i ndihmës juridike, ashtu siç është i themeluar nga Tribunali, ka pësuar disa raste të mashtrimit. Njëri prej rasteve më bindës ishte rasti i Zoran Zhigicit, një serb i Bosnjës, i dënua me 25 vjet burg për shkelje të zakoneve të luftës dhe për krime kundër njerëzimit. Zhigici ka elaboruar një skemë të “ndarjes së tarifës” me këshilluesit e tij juridikë për të ndarë tarifat e avokatit për ndihmë juridike. Ai arriti të mbledhë 175,000 usd nga pagesat për ndihmë juridike.¹⁶⁴

2.2. EMËRIMI I MBROJTËSVE EX-OFFICIO (ZYRTARË)**2.2.1. LIGJI I MAQEDONISË***Sistemi i emërimit të mbrojtësve*

Shumica e praktikuesve ligjorë të intervistuar për këtë hulumtim janë të njoftuar me procesin e emërimit të ex-officio avokatëve. Sipas tyre, gjykatësit hetues kanë një listë të avokatëve që kanë pranuar për tu caktuar ex-officio (zyrtarisht) ndërsa kryetarët e gjykatave posedojnë një listë të tillë për fazën e gjykimit. Për më tepër, disa prej tyre u përgjigjën se Shoqatat lokale të avokatëve ju ofrojnë gjykatave një listë të avokatëve, në të cilën radhitja e emërimit është në mënyrë alfabetike. Në eksperiencën e disa prej të intervistuarve Gjykatësi kryesues i këshillit e bën emërimin aktual/zgjedhjen e avokatit, edhe pse Kryetari i gjykatës duhet të jetë përgjegjës për këtë.

Të anketuarit në përgjithësi, gjithashtu, ishin të kënaqur me kohën që u është dhënë avokatëve të emëruar nga gjykata për përgatitjen e mbrojtjes për rastin e tyre. Disa kanë shtuar se avokati gjithmonë mund të kërkojë kohë shtesë për ta përgatitur mbrojtjen e tij dhe ajo, zakonisht, u jepet.

¹⁶³ Shih nenin 19 të Direktivës për Caktimin e avokatit mbrojtës.

¹⁶⁴ Shih kumtesën për shtyp CC/ PIS/ 686-e të 8 korrikut 2002, në dispozicion në <http://www.icty.org/sid/8086>. Shih përgjithësisht David Tolbert, Simpoziumi: GJNPJ-së në të mundshmet: një vlerësim kritik i vendimeve të mëdha të GJNPJ-së gjatë dekadës së kaluar: GJNPJ-ja dhe Avokatët mbrojtës: Një raport me shtetësimet, 37 New Eng. L. Rev. 975,2003

Sa u përket rasteve komplekse, opinionet e të anketuarve lidhur me mënyrën e emërimit të avokatëve ex-officio, sipas LPP-së të vitit 2005, ndryshojnë nga ato pozitive deri te ato jo aq funksionale. Një tjetër faktor që drejtpërdrejtë ka ndikuar në cilësinë e mbrojtjes nga avokatët e caktuar ex-officio është se sipas disa të intervistuarve, sa me më shumë përvojë një avokat të ketë, aq më pak ai është i motivuar të punojë ex-officio. Në të vërtetë, ata zakonisht janë shumë të angazhuar me çështje të tjera dhe nuk e konsiderojnë më si një sfidë këtë lloj të misionit.

Numri i të pandehurve në procedurat e krimeve komplekse sipas rregullës, nuk duhet të jetë më i madh se tre (raportohet se në një rast të mitës janë akuzuar 72 bashkë-të pandehur), sepse secili prej të pandehurve mund të zgjedh e të përfaqësohet nga më shumë se një avokat. Të anketuarit me përvojë në përfaqësimin e të pandehurit në krimet komplekse në pjesëmarrjet në procedurat që kanë të bëjnë me krimet komplekse rikujtojnë disa nga ato raste kur një i akuzuar është mbrojtur me disa mbrojtës. Në një shembull ka pasur tetë të pandehur, ku secili prej tyre ka pasur të paktën dy mbrojtës. Një shembull tjetër flet për 10-12 avokatë që kanë përfaqësuar disa të akuzuar në gjykim.

Të gjithë këta shembuj kërkojnë kujdes të posaçëm nga ana e këshillit për ta udhëhequr gjykimin.

Situata është më e komplikuar aty ku zbatohet mbrojtje e detyrueshme dhe kur një avokat i caktuar e braktis sillën e gjyqit në mes të gjyqimit, sepse mungesa e një avokati mbrojtës është bazë për shtyrje të asaj seance. Për t'i parandaluar vonesat e mëtejshme, një kryetar i trupit gjykues në mënyrë tipike mund ta caktojë një avokat të dytë ex-officio – njëlloj siç do të ishte rasti i përgjithshëm, kur gjykata do të konstatojë se avokati i angazhuar privatisht shkakton vonesa të pajustificueshme. Arsyeja është se avokati i caktuar ex-officio duhet t'i ndjek të gjitha seancat e gjyqimit dhe, nëse është e nevojshme, të jetë i pranishëm kur avokati i zgjedhur në mënyrë private nuk është aty, duke e mundësuar zhvillimin normal të gjyqimit. Në të njëjtën kohë, kjo qasje e zhvendos barrën për të siguruar mbrojtje në gjyq, përderisa lënia e një avokati mbrojtës që nuk e përmbush detyrën duket se nuk ka nxitje reale për të marrë pjesë në seancat dhe kështu t'u përmbahet kërkesave themelore të punës.

Koordinimi mes avokatëve mbrojtës në rastet e krimeve të ndërlikuara nuk duket se është një problem i madh. Megjithatë, disa nga mbrojtësit, që rregullisht marrin

pjesë në krimet komplekse, qoftë me emërim apo me angazhim nga klienti, janë ankuar se koordinimi është i vështirë meqë avokatët janë zakonisht shumë të angazhuar për ta koordinuar ose për ta përpunuar një strategji të përbashkët të mbrojtjes nga e cila do të përfitonin të akuzuarit.

Kualifikimi dhe trajnimi i avokatit

LPP e vitit 2005 nuk ka detaje në lidhje me kualifikimet e kërkuara për avokatët e emëruar ex-officio. LPP i ri, nga ana tjetër, e paraqet kërkesën për një përvojë pesë-vjeçare pas pranimit në radhët e avokatëve për avokatët që i përfaqësojnë të pandehurit në procedurat penale të cilat dënohen me një minimum prej 10 vjet burgim. Është e paqartë nëse kjo përvojë duhet të jetë e kaluar si avokat, apo në punë të tjera në radhët e avokatëve.¹⁶⁵

Oda e Avokatëve, institucioni kombëtar i avokatëve i themeluar në saje të ligjit, është ende në proces të zhvillimit të një sistemi për arsimim të vazhdueshëm ligjor të anëtarëve të saj. Aktualisht, duket se vetëm një numër i kufizuar i avokatëve kanë pasur mundësi të marrin pjesë në disa trajnime vjetore të organizuar nga Oda e Avokatëve. Shoqatat e tjera profesionale ofrojnë trajnime në fusha të ndryshme të drejtësisë, por jo domosdoshmërisht në procedurën penale. Këto kapacitete janë larg nga përfshirja e të gjithë 1,900 avokatëve në vend me arsimim cilësor të vazhdueshëm juridik që e ushtrojnë këtë. Ndryshe nga avokatët, gjykatësit dhe prokurorët janë të trajnuar vazhdimisht nga Akademia për trajnimin e gjykatësve dhe të prokurorëve publikë, e cila është një institucion i financuar nga shteti.

Kur flitet për krimet komplekse, të intervistuarit nuk ishin të një qëndrimi në lidhje me mungesën e kritereve në përzgjedhjen e avokatëve, të cilët marrin raste të ndërlikuar penale. Përderisa një numër janë të bindur se mungesa e kritereve nuk e ka dëmtuar të drejtën për të pasur një mbrojtje të përshtatshme, kundërshtarët besojnë se kjo nuk ka ndikuar në cilësinë e mbrojtjes. Megjithatë, të gjithë të anketuarit janë dakord se kriteret e reja të parapara nga LPP i ri paraqesin një përmirësim. Një i intervistuar sugjeroi që të shkohet edhe më tej, me kërkesën që avokatët të posedojnë një licence të specializuar para se të kenë të drejtë të përfaqësojnë në krimet komplekse, sidomos në rastet e krimeve të organizuara. Një tjetër i intervistuar e ka vënë në dukje shqetësimin për standardin e dyfishtë për kërkesën e re për përvojë më të gjatë për avokatët se sa ajo që kërkohet nga gjykatësit apo prokurorët që merren me rastet e njëjta. Të anketuarit me përvojë në krimet komplekse kanë deklaruar se i kanë marrë këto raste pasi parapakisht

¹⁶⁵ Shih nenin 71 paragr. 5 i LPP të ri i cili thotë: “ (5) Për krime që sjellin dënim me burg prej së paku dhjetë vjet, avokati mbrojtës duhet të jetë një avokat me të paktën pesë vjet përvojë pune, pas kalimit të provimit të avokaturës.”

disa vite me radhë kanë shërbyer si avokatë. Një avokat ka filluar të marrë krime të ndërlikuara një vit e gjysmë pas pranimit në Odën e avokatëve. Vlen të përmendet se disa kanë vënë re se shumica e avokatëve më të vjetër shpesh herë e luajnë rolin e këshilltarit/mentorit të pjesës më të madhe të të rinjve në çështjet komplekse juridike dhe procedurale.

Legjislacioni vendas nuk kërkon një specializim në fushën juridike. Avokatët e zhvillojnë specializimin e tyre në vazhden e punës së tyre në gjykime dhe në saje të preferencave personale. Të gjithë të anketuarit të cilët kanë punuar si avokatë mbrojtës në krime komplekse janë me përvojë në ligjin penal. Kështu, ata janë të specializuar gjatë praktikës. Gjykatat duket se e kanë vërejtur këtë si dhe: në shumicën e rasteve duket se avokatët e përcaktuar gjyqësor janë të zgjedhur në mesin e atyre me përvojë relevante – me një praktikë shumë të mirë dhe të dobishme për zhvillimin normal të gjykimit. Një numër i madh i të intervistuarve u pajtuan se një mbrojtje e dhënë nga avokatët e pakualifikuar dhe pa përvojë ka gjasa ta dëmtojë një rast të caktuar të të pandehurit, që si pasojë nuk i dëmton vetëm të drejtat procedurale të klientëve të tyre, por mund ta dëmtojë gjykimin e tërë, që kërkon që gjyqtarët kryesues të kenë një qasje paternaliste dhe kujdes gjatë mbrojtjes në mënyrë që të parandalohet çdo shkelje e të drejtave procedurale të të pandehurit.

Kompensimi i avokatëve

Tarifa e Odës së Avokatëve (TOA) e rregullon shumën e pagesave dhe të shpenzimeve për çdo procedurë të caktuar ligjore të kryer nga avokati. Ajo gjithashtu e përcakton pagesën për avokatët në emërimet *ex-officio*. Sipas TOA-së avokati dhe pala në rastin mund lirisht të pajtohen mbi pagesën dhe shpenzimet, por ajo nuk mund të jetë më e ulët se tarifat e përcaktuara nga TOA.¹⁶⁶ Të gjitha pagesat bëhen në denarë të Maqedonisë.¹⁶⁷ Është me interes të përmendet se kur pala në procedurë është me kombësi të huaj (person fizik apo juridik) dhe dokumentet juridike në rastin e dhënë e përfshijnë hartimin e tyre në gjuhë të huaj TOA-ja përcakton tarifa të cilat janë dyfishi i atyre me të cilat ngarkohet një person me kombësinë vendase ose ato që janë në gjuhën kombëtare.¹⁶⁸

Klientit i kërkohet që të kompensojë shpenzimet për sa i përket transportit, vendosjes, mëditjes dhe humbjeve të përfitimit të shkaktuara nga mungesa e mbrojtësit nga zyra. Përveç këtyre tarifave, klienti duhet t'ia paguajë avokatit shumën për punën e tij. Pagesat për shkrimin e dokumenteve juridike (përfshirë aty edhe në procedurat penale) janë me sa vijon:

¹⁶⁶ Shih nenin 1 (1) të Tarifës së Odës së Avokatëve (TOA-së),

¹⁶⁷ Shih nenin 2 të TOA-së.

¹⁶⁸ Shih nenin 3 të TOA-së.

- Për të shkruar një mocion për nisjen e procedurës, për sigurimin e vërejtjeve shpjeguese, për të kundërshtuar një vendim apo mocion, për t'iu përgjigjur në mocioni ose vendimi tjetër, për të kërkuar zbatimin e një vendimi ose një titulli etj., shpërblimet për tezat e mocioneve të ndryshme lëvizin midis 1.000,00 dhe 3.000,00 denarë.
- Kostoja për avokatin që do të përpilojë një marrëveshje me shkrim kushton prej 1.000,00 deri në 2.000,00 Denarë.¹⁶⁹
- TOA, gjithashtu, e rregullon pagesën për mbrojtjen për fjalën dhe përfaqësimin para gjykatës siç është gjykata penale dhe organet administrative. Këto akte janë të paguara në shumën për ta shkruar mocionin përkatës (mes 1.000,00 deri në 3.000,00 denarë), plus një normë për orë (20% të shumës për mocion) për çdo orë që është punuar në rastin e dhënë.
- Një llogaritje e njëjtë është përdorur për ta përcaktuar pagesën për mbrojtjen e klientit në procedurën penale, vizitën e klientit të burgosur dhe frekuentimin e ekspertizës mjeko-ligjore.
- Mocionet me kërkesa që përfshijnë gjoba deri në 10.000 denarë ose me burgim deri në një vit paguhet 1.000,00 denarë; gjobat që përfshijnë gjoba prej 25.001,00 denarë deri në 50.000,00 denarë ose me burgim deri në pesë vjet paguhet 2.000 denarë; ato që kanë të bëjnë me gjobat mbi 100.001 denarë ose burgim prej mbi dhjetë vjet, si dhe mocionet e përgatitura gjatë fazës së hetimit shpërblehen me 3.000 denarë.
- Së fundi, kompensimi për mocionet e paraqitura në Gjykatën Kushtetuese (që sfidojnë për shembull një vendim të Gjykatës së Apelit në çështjet penale) arrijnë tarifën më të lartë, 3.000 denarë.

Një shumicë e madhe e praktikuesve të intervistuar nuk ishin të kënaqur me tarifatat aktualisht të aplikueshme për shërbimet e përcaktimit nga gjykata. Ndërkaq ata që e dinin saktësisht shumën e saktë për kompensim, konstatojnë se pagesat e TOA-së janë tejet të ulëta për të filluar, duke shtuar edhe faktin se gjykatat shpesh herë as që arrijnë t'i paguajnë edhe këto shuma minimale. Disa praktikues, përfshirë aty edhe gjykatësit, pranojnë se avokatët marrin vetëm 50 për qind të shumave të parashikuara në TOA. Një i intervistuar sugjeroi se TOA duhet të rishikohet për shkak se gjykatat kanë probleme me përballimin e tarifave, siç janë ato në shërbimet e caktimit nga gjykata.

¹⁶⁹ Shih nenin 8 (3) të TOA,-së.

Disa prej tyre komentuan se pagesa aktuale e kompensimit nuk ndodh menjëherë pas kompletimit të misionit të avokatit, as para fillimit të tij. Në vend të kësaj, pagesa bëhet gjashtë muaj deri në një vit më vonë.

Konflikti i interesit dhe çështjet disiplinore

Nëse avokatët e caktuar privatisht dhe mbrojtësit e caktuar nga gjykata duhet t'i shmangen konfliktit të interesit. LPP i vitit 2005 lejon që disa të pandehur ta ndajnë të njëjtin mbrojtës për aq kohë sa nuk është në dëm të tyre.¹⁷⁰ Ligji gjithashtu elaboron disa mospajtime të tilla siç është ai për viktimën, bashkëshortin e viktimës ose për të afërmin e tij, që janë dëshmitarë në rastin, për vlerësuesin që ka punuar në këtë rast i cili duhet të jetë avokat mbrojtës.¹⁷¹ LPP i ri e shton konceptin e papajtueshmërisë ndërmjet funksionit të avokatit mbrojtës dhe të bashkë-pandehurit në të njëjtën lëndë.¹⁷²

Aty ka disa dispozita për parandalimin e konfliktit të interesit në Ligjin për Odën e avokatëve dhe në Kodin e sjelljes së avokatëve.

Shumica dërrmuese e të intervistuarve ka konfirmuar se konflikti i interesit nuk ka qenë problem. Një i anketuar ka komentuar se ndonjëherë kërkohet që avokatët e caktuar nga gjykata të nënshkruajnë një deklaratë ku konfirmohet se ata nuk kanë ndonjë konflikt interesi me një gjykatës, prokuror ose avokat tjetër para fillimit të procedurës.

Të intervistuarit dukeshin të kënaqur me nivelin e bashkëpunimit ndërmjet kolegëve të tyre në të njëjtin rast. Kjo është veçanërisht e vërtetë në çështjet e natyrës teknike.

Shumica e të intervistuarve nuk kishin njohuri për ndonjë procedurë disiplinore të ngritur kundër avokatë ex-officio. Në qoftë se kjo ndodh, Oda e avokatëve e ka lirinë e plotë për ta trajtuar atë si autoritet të ngarkuar me përkujdesjen se shërbimet e kryera nga avokatët i përmbushin standardet etike dhe profesionale dhe se janë kryer në mënyrë profesionale nga të gjithë anëtarët e Odës.

Pavarësisht nga niveli më i lartë i konfliktit të mundshëm të interesave **në rastet e krimit kompleks**, duke e pasur parasysh numrin më të madh të të pandehurve

¹⁷⁰ Shih nenin 64 (1) të LPP të vitit 2005 i cili përcakton se “disa të akuzuar mund të kenë avokat të përbashkët vetën nëse kjo nuk është kundër interesit të mbrojtjes së tyre. [...]”.

¹⁷¹ Shih nenin 65 të LPP të vitit 2005.

¹⁷² Shih nenin 73 të LPP të ri i cili siguron mospërputhje të ngjashme si ato nga LPP të vitit 2005 dhe i zgjeron ato në bashkë të akuzuarit.

të cilët ata përgjithësisht i përfshijnë, të intervistuarit nuk kanë raportuar se kanë vërejtur konflikt të pambikëqyrrur të interesave. Sipas pikëpamjes së shumicës së të anketuarve, gjyqtari shpesh bën hapa radikalë dhe vendos të përjashtojë një avokat aty ku mund të ndodhë një konflikt interesi për shkak se avokati përfaqëson më shumë se një të pandehur në një rast.

2.2.2. E DREJTA NDËRKOMBËTARE DHE KRAHASUESE

▪ Modeli Amerikan

Sistemi i caktimit të avokatëve

Siç u përmend më lart, shumë shtete të SHBA-ve kanë avokatë të caktuar nga gjykata për të pandehurit e varfër që përballen me veprat penale që mund të rezultojnë me burgim. Kualifikimet ndryshojnë varësisht nga serioziteti i krimit dhe personalitetit të të pandehurit (p.sh. rastet e kriminalitetit të të miturve dhe rastet e abuzuesve të fëmijëve për kryerje të krimeve të rënda) si për shembull rastet e kriminalitetit në të mitur dhe çështjet që përfshijnë shkelës të mitur të krimeve të rënda.. Për shembull, Shteti i Idianës i cili emërimi për krimeve të rënda, duke e përfshirë aty edhe vrasjen, kërkon të paktën tre vjet përvojë të gjerë paraprake në proceset gjyqësore të rasteve të ngjashme. Përvojë e gjerë paraprake, gjithashtu, kërkohet për mbrojtje të të pandehurve të mitur, posaçërisht kur një fëmijë është i akuzuar për vrasje.¹⁷³ Aty ku shtetet lejojnë që çdo avokat i licencuar për praktikimin e ligjit mund të caktohet si mbrojtës për të akuzuarin në çdo rast penal (me përjashtim të rasteve të mëdha), herë pas herë ajo rezulton me avokatë të cilët kurrë nuk kanë provuar në raste të rënda penale. Ky standard i përcakton kufijtë minimal për nivelet e përvojës së avokatëve të emëruar në bazë të seriozitetit të veprës penale.

Kualifikime dhe trajnim të avokatëve

Ligji penal dhe mbrojtja e çështjeve penale kërkon njohuri dhe trajnim të veçantë. Pasojat e gabimeve në përfaqësimin e mbrojtjes mund të jenë qenësore, duke përfshirë akuza të gabuara dhe humbje të lirisë.

Funksionimi i mbrojtjes publike, duke përfshirë përzgjedhjen, financimin dhe pagesën e avokatëve mbrojtës, është i pavarur. Sipas udhëzimeve profesionale për sigurimin e mbrojtjes së të varfërve, aftësia e avokatëve mbrojtës, trajnimi dhe përvoja përputhet me kompleksitetin e çështjes. Rast ideal është kur avokati i njëjtë e përfaqëson vazhdimisht klientin e njëjtë deri në përfundimin e çështjes.

¹⁷³ Për më tepër informacione, shih në <http://www.in.gov/judiciary.pdc/docs/standards/indigent-defense-non-cap.pdf>

Avokati mbrojtës është i pajisur dhe kërkohet që edhe më tej të ndjek arsimim të vazhdueshëm juridik dhe të jetë i mbikëqyrur vazhdimisht për cilësi dhe efikasitet në saje të standardeve të miratuara kombëtare dhe lokale.¹⁷⁴

Aktualisht, edukimi i vazhdueshëm juridik është i siguar për gjykatësit dhe prokurorët në llogari të Qarkut ose pa kurrfarë pagese përmes Qendrave gjyqësore të shtetit ose Këshillave të avokatëve për ndjekje penale. Nga ana tjetër, trajnime të specializuara janë siguar për avokatë mbrojtës që vijnë përmes shumë Këshillave të mbrojtësve publikë për një pagesë që çdo kush nuk mund ta përballojë. Praktikuesit deklarojnë se trajnimi i siguar për mbrojtje të të varfërve së paku duhet të jetë i njëjtë me atë që ju është siguar gjykatësve dhe prokurorëve.

Kompensimi i avokatëve

Zyrat Federale të mbrojtësve janë të mbështetura mirë. Avokatët e punësuar nga Zyrat Federale të mbrojtësve publikë kanë paga të caktuara që të përputhen me ato të avokatëve në Zyrën e Prokurorit të SHBA-ve. Kombinimi i pagave, përfitimeve dhe i mbështetjeve të ekipeve mbështetëse kanë tendencë të tërheqin dhe t'i mbajnë avokatët me kualifikime të larta.

Nga ana tjetër, paga mesatare për arritjen e nivelit të asistentit të avokatit mbrojtës është 46.000 usd në vit (që nënkupton 9 vite të shërbimit).¹⁷⁵ Rroga mesatare fillestare e avokatit me 5 ose më tepër vjet përvojë është 54,800 usd në vit dhe për 6 vite ose më shumë eksperiencë 60,300 usd në vit.¹⁷⁶ Në qoftë se ata sipas mesatares së agjencisë punojnë rreth 55 orë në javë, marrin rreth 12 dollarë në orë. Siç deklarojnë ata, me atë pagesë, është pothuajse e pamundur të vihen para të mjaftueshme anësh për pagesë të shkollës juridike.

Të angazhuarve të rinj, në shumë shtete, ju kërkohet të qëndrojnë deri në tre vjet në punë, por shumë nga avokatët e rinj konstatojnë se angazhimi vështirë se mund të përballohet. Megjithatë, shumë shtete janë në gjendje t'i tërheqin njerëzit e talentuar. Mirëpo, mbajtja e njerëzve të talentuar me atë mesatare të pagës është e vështirë. Sipas statuteve të Shtetit të Indianës (dhe shumë shteteve të tjera) pagat dhe kompensimi i mbrojtësve publikë në marrëdhënie pune dhe me kontratë në mënyrë thelbësore mund të krahasohet me pozitat e ngjashme në zyrën e Prokurorit për përndjekje penale. Megjithatë, në mbarë vendin, niveli i kompen-

¹⁷⁴ Asociacioni Kombëtar për Ndhimë dhe Mbrojtës Juridikë, Udhëzimet për përfaqësimin për Mbrojtje Penale (1995) dhe Standardet e Shoqatës Amerikane të Avokatëve për drejtësi penale, Sigurimi i Shërbimeve mbrojtëse (ed 3-të 1992).

¹⁷⁵ Regjistri i programeve për mbrojtës publik, 2007, Raporti Special, Zyra e Statistikave të Drejtësisë, Departamenti i Drejtësisë i SHBA-ve, shtator 2010, NCJ 228.229, f.18.

¹⁷⁶ E njëjta., f.18.

simit për mbrojtësit publikë me rrogë dhe ata me kontratë është i pamjaftueshëm dhe kjo krijon shqetësime të rënda në lidhje me cilësinë e shërbimeve të mbrojtjes të siguruara për të akuzuarit.¹⁷⁷

Kompensimi për mbrojtësin e caktuar, rast-pas-rasti, për gjykim apo apel me paraqitjen e një kërkesë për shërbime dhe kompensim të shpenzimeve është llogaritur nga: norma për orë, shpenzimet e rastësishme dhe nga shpenzimet periodike (ku është e aplikueshme).¹⁷⁸

Çështjet e konfliktit të interesit

Në shumicën e rasteve, si në shumë vende të tjera në botë, avokatët duhet t'i respektojnë standardet profesionale, ligjore dhe etike kur e kryejnë punën e tyre, në këtë rast në fushën e mbrojtjes së të varfërve. Zakonisht një program të mbrojtësve publikë nuk duhet marrë pjesë më shumë se një person ku ekziston një konflikt interesi në bazë të Kodit të përgjegjësisë profesionale.¹⁷⁹

Sipas standardeve të Shoqatës së avokatëve amerikanë (SHAA), kontratat e mbrojtjes së të varfërve nuk duhet të përmbajnë dispozita që krijojnë konflikte të interesit ndërmjet kontraktorit dhe klientit (SHAA standardi 5-3,2 (c); Ndihma ligjore kombëtare dhe asociacioni i avokatëve (NLKAA) Udhëzimi III-13). Në mesin e konflikteve të trajtuara të mundshme janë çështjet si: detyrimi i kontraktorëve ose të zgjedhin që të paguajnë për hetim, ekspert, transkriptim dhe shërbime të tjera, ose të heqin dorë nga këto shërbime duke mos i përfshirë ato në kontratë; dështimi që të sigurohet se mekanizmi i kontratës për përpunimin e rasteve konfliktuoze nuk funksionon si një dekurajim financiar për tërheqje, e nxit një avokat të heq dorë nga të drejtat e klientit (SHAA Standardi 5-3,3 (b) (VII) (X); NJKAA Udhëzimi III-).

¹⁷⁷ Për shembull, në katërbëdhjetë qarqet me një popullsi mbi 100.000 banorë, mesatarja që i paguhet e mbrojtësit publik me gjysmë-orari në gjykatat për krime është \$ 21,000 dhe ata mesatarisht caktohen në 70 raste të reja në vit, që do të thotë se ato paguhen 300 \$ për një rast. Mbrojtësit publik me gjysmë-orari në qarqet e njëjta që merren me trajtimin e rasteve të të njëjtës shkelje të ligjit marrin një mesatare prej 400 raste të reja në vit, e pagesa arrin në 52,50 \$ për rast. Pasqyrim i shkurtër i Këshillit mbrojtësve Publik të Indianës, në lidhje me: Kërkesën për krijimin e Rregullave që kanë të bëjnë me sistemin e mbrojtësve publik të Qarkut Marion, Çështja Nr 49SOO-9210MS-822.

¹⁷⁸ Normat për orë që aktualisht paguhen për avokatin e caktuar në Indiana shkojnë prej \$ 30 - \$ 60 në orë, e në shumicën e qarqeve përdoret një normë prej 40 \$ në orë për orarin jashtë-gjyqësor dhe \$ 50 për kohën e përfaqësimit në gjykatë. Për shumë avokatë, kjo mezi i mbulon punët në zyrë. Ky standard përcakton një normë minimale prej 60 \$ në orë dhe kërkon kompensim për shpenzimet e rastësishme. Ky standard gjithashtu kërkon që avokati, sipas kërkesës, duhet të paguhet në baza mujore se sa të pritët deri në fund të rastit.

¹⁷⁹ Shih për shembull praktikën në Nju Hempshajr "Statutet, titulli LIX, Procedurat në rastet penale, Kapitulli 604-B: 3"

Për të kapërcyer një problem potencial të konfliktit të interesit disa shtete, siç është Xhorxhia, kanë mbajtur avokatë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me orar të plotë në zyrat e mbrojtësve për mosmarrëveshje. Përndryshe, ajo mbështetet në mbrojtësin e caktuar të pavarur për konflikt dhe e tejkalon punën. Sipas çdo opsioni, avokatët për konflikte është e domosdoshme të punojnë në vende të veçanta nga mbrojtësit publikë të caktuar për t'i përfaqësuar të pandehurit e tjerë në këtë rast. Këshillimi për konflikt është paramenduar gjithashtu të financohet në mënyrë adekuate gjë që varet nga shteti ose trupa të tjerë që e përbëjnë atë.

Pasqyrë e një sistemi të specializuar nga rajoni: lista e posaçme e Kroacisë për ex-officio emërimet në rastet e krimeve të luftës

Mbrojtja Ex-officio i është nënshtruar shqyrtimit të veçantë në rastet e krimeve të luftës, pa marrë parasysh se të pandehurit janë të pranishëm ose gjykohe në mungesë. Megjithatë, për shkak se përgjegjësia e mbrojtjes ex-officio është më e madhe kur i pandehuri gjykohet në mungesë, këto raste kanë një vëmendje të veçantë për monitorim nga Zyra e OSBE-së në Zagreb. Rezultati i këtij ushtrimi të monitorimit sugjeroi që avokatët të cilët ishin caktuar t'i përfaqësojnë të pandehurit në rastet komplekse, shpesh herë, nuk kanë pasur përvojë të mjaftueshme praktike dhe specifike teorike ndërkom-bëtare nga edukimi për të drejtën humanitare. Si rezultat, në përgjigje të shqetësimeve mbi mungesën e efektshmërisë së përfaqësimit të parashikuar për të pandehurit për krime lufte, Ministria e Drejtësisë në fund të vitit 2008, përpiloi një listë të avokatëve të cilët kanë shfaqur interes për t'u caktuar nga gjykata në këto raste. Gjykata e Lartë u ka shpërndarë lista kryetarëve të gjykatave të qarkut, edhe pse nuk është bërë e detyrueshme për gjykatësit të zgjedhin avokatë nga kjo listë. Avokatët e regjistruar në listë kanë deklaruar se ata ose kanë përvojë të veçantë, ose ishin të gatshëm për t'u stërvitur. Shumicës së avokatëve në listë u mungonte përvoja, disa kishin qenë në praktikë në Zagreb, ndërsa disa gjykata jashtë kryeqytetit, për rastet e krimeve të luftës, kanë pasur pak ose nuk kanë pasur aspak avokatë në listë. Lista përbën një hap të parë për t'i kompensuar efektet e mbrojtjes së përshtatshme ose të dobët në rastet e krimeve të luftës, prandaj është dashur të merren masa të tjera të nevojshme. Në vitin 2008 ndodhi një zhvillim pozitiv, ku në një rast të përfaqësimit të përbashkët të një rasti për gjen-

cid, për më shumë se një të pandehur, mbas ndërprerjes së gjykimit, për çdo të akuzuar ishte caktuar avokat.

▪ Modeli i Francës

Sistemi i emërimit

Sistemi francez i ndihmës ligjore mundëson që përfituesit të kenë liri për përcaktimin e një avokati ex-officio në saje të zgjedhjes nga një klient, avokati përgatit një letër pranimi të emërimit të ndihmës juridike që përfituesi ja paraqet zyrës për ndihmë juridike me pjesën tjetër të kërkesës së tij.¹⁸⁰ Megjithatë, avokati për ndihmë ligjore gjithashtu mund të jetë i emëruar nga Shoqata kur i akuzuari nuk mund të gjejë avokat. Në çdo rast një avokat është i lirë të shmanget nga emërimi në kontekstin e ndihmës juridike.

I vetmi përjashtim është rasti i avokatëve të emëruar nga kryetari i shoqatës ose gjykata sipas sistemit të “*comission d’office*” ose përcaktimit ex-officio i cili i sugjerohet një personi që nuk njeh ndonjë avokat, të marrë ndihmë të përshtatshme. Në këto raste emërimi i avokatit shihet si “shërbim publik” për të cilin gjë japin betim avokatët kur pranohen në praktikë. Emërimi ex-officio nuk mund të refuzohet pa një arsytim të duhur.¹⁸¹ Kompenzimi në këto raste gjithashtu bëhet siç është specifikuar në kuadër të tarifave të ndihmës.

Grupi i avokatëve në dispozicion për përzgjedhje nga Presidenti i shoqatës për rastet e ndihmës juridike është i organizuar p.sh. me një listë vullnetarësh, si në rastet e qyteteve të mëdha si Parisi apo Lioni - ose në bazë të një regjistri të përbërë nga të gjithë avokatët e pranuar të një shoqate të caktuar (në qytetet e vogla). Ky dallim është bërë kryesisht për shkak se shoqatat më të vogla, në bazë të numrit të anëtarësisë së tyre, nuk mund ta përballojnë mbajtjen e një numri të vullnetarëve. Në zonën e Odës së avokatëve të Parisit dhe në mënyrë specifike për rastet penale, avokatët që e pranojnë ndihmën juridike për lëndët penale janë të detyruar të ndjekin një trajnim intensiv në të drejtën penale, para se të pranohen në listën e vullnetarëve të angazhuar ex-officio (në saje të detyrës zyrtare).¹⁸²

¹⁸⁰ Shih nenin 75 të Ligjit Francës për ndihmë juridike.

¹⁸¹ Neni 9 i Ligjit të Francës i reformimit të profesioneve të caktuara ligjore dhe gjyqësore, Loi n°71-1130 du 31 décembre 1971 portant réforme de certaines professions judiciaires et juridiques) i cili shpjegon se avokati i caktuar sipas *comission d’office* sistemit nuk mund të refuzojë të marrë një rast, pa e pasur aprovimin e Kryetarit të shoqatës së avokatëve ose të Kryetarit të gjykatës penale të ndjesës apo të ndonjë pengese që ekziston për të. Për më tepër diskutime në lidhje me çështjen, shih paragrafët 36, 51-54, *Déontologie de l’avocat*, Raymond Martin, 9 Edicioni, 2005.

¹⁸² Shih Përmbledhjen Teknike të Shoqatës së Parisit për qasjen në ligj, janar 2007, në dispozicion në gjuhën frënge në http://www.avocatparis.org/avocats_service/PDF/Presentation.pdf.

Kualifikimet e avokatëve

Kualifikimet e kërkuara nga avokatët e caktuar në rastet penale ndryshojnë në varësi të rregulloreve të brendshme të shoqatave dhe madhësisë së tyre. Siç është paraqitur më lart, në juridiksionet si në Paris e gjetiu, avokatët vullnetarë duhet t'i nënshtrohen një trajnimit të gjerë në të drejtën penale, para se të pranohen në listën e vullnetarëve. Nga ana tjetër, në shoqatat që e aplikojnë sistemin e regjistrimit, për të siguruar se nuk është vënë në rrezik cilësia e mbrojtjes, aty ku emërimet janë bërë ex-officio, Presidenti i shoqatës mund të emërojë një avokat "sendor" së bashku me një avokat me më pak përvojë. Kjo ndodh, veçanërisht, kur rasti është kompleks dhe vepra është shumë serioze.¹⁸³ Megjithatë, nuk është marrë qasje e unifikuar apo formale për të vënë një prag të unifikuar cilësor dhe sasior për kualifikimin e kërkuar të avokatëve ex-officio.

Kompensimi i avokatëve

Në kuadër të ndihmës së plotë ose të pjesshme ligjore [të paguar nga shteti] avokatët janë paguar për çdo akt procedural të ndërmarrë, duke ndjekur një shkallë të rreptë dhe precize. Dekreti që e rregullon profesionin e avokatit e përshkruan shpagimin e akteve procedurale në aspektin e *unités de valeur*-kredite.¹⁸⁴ Çdo vit Ligji i financave publike përcakton vlerën në një kredie në euro. Megjithatë, vlera e një krediti në kontekstin e procedurave të ndihmës së pjesshme juridike - 22,50 € që nga viti 2007¹⁸⁵ - dallon nga rasti i ndihmës së plotë. Për më tepër, në rast të ndihmës së plotë, krediti dallon nga një shoqate lokale në shoqatë tjetër, varësisht nga ngarkesa e ndihmës juridike për rastin brenda zonës së shoqatës. Për shembull, një kredit për sigurimin e ndihmës së plotë në Paris është me vlerë 22,84 €, ndërsa në rajonin e shoqatës së Orleanit ajo shkon deri në 24,20 €. ¹⁸⁶ Për shembull, një avokat nga Shoqata e Parisit paguhet me një normë themelore fikse prej 1142 € për ta ndihmuar një të pandehur gjatë tërë fazës së hetimit për një krim të dyshuar (në vlerë minimale prej 50 kredi) ose me 182,72 € për ta ndihmuar një të pandehur vetëm gjatë një seancë para Gjykatës për kundërvajtje ose Gjykatës për të mitur (me minimum 8 kredi). Tarifa shtesë paguhet në rrethana të veçanta të

¹⁸³ Shih Dosjen: *métier d'avocats*, Letudiant.fr, në dispozicion në gjuhën frënge në <http://www.letudiant.fr/metiers/metiers-davocats-comme-dans-les-series-tele-18828/idee-recue-n4-les-avocats-simpliquent-corps-et-ame-dans-leurs-affaires-14761.html>.

¹⁸⁴ Shih në përgjithësi Dekretin e Francës për ndihmë ligjore.

¹⁸⁵ Shihe Seksionin 2 të Qarkores së Ministrisë së drejtësisë në lidhje me të drejtën për ndihmë ligjore (Circulaire du SADJPV du 29 décembre 2006 relative au montant des plafonds de ressources, des correctifs pour charges familiales et des tranches de ressources pour l'admission à l'aide juridictionnelle en 2007. – Revalorisation du montant de l'unité de valeur), në dispozicion në gjuhën frënge në http://www.textes.justice.gouv.fr/art_pix/boj_20070001_0000_0004.pdf.

¹⁸⁶ Shih Qarkoren ministrore për ndihmë të plotë juridike (Arrêté du 28 décembre 2006 fixant la majoration des unités de valeur pour les missions d'aide juridictionnelle totale).

tilla si ndihmë gjatë një ditë shtesë të marrjes në pyetje ose kryerjes së veprimeve procedurale të cilat kërkojnë një udhëtim të veçantë për shembull në një institucion të vendosur jashtë juridiksionit gjeografik të gjykatës së përfshirë me rastin.

Dispozita për konflikt të interesave

Ashtu si të gjithë avokatët praktikantë të kufizuar nga rregullat etike për praktikimin e profesionit, avokatët për ndihmë ligjore duhet të refuzojnë ta marrin ose duhet të tërhiqen nga një rast që mund të çojë në konflikt të interesit mes klientëve të tij.¹⁸⁷ Kjo ndalesë vlen për avokatët që veprojnë në kuadër të së njëjtës kompani juridike.¹⁸⁸

▪ Modeli i juridiksionit ndërkombëtar penal

Ndryshe nga sistemet e tjera të përshkruara më sipër, emërimi ex-officio i avokatëve para GJNPJ-së ekziston vetëm nëpërmjet skemës së tij të ndihmës ligjore.¹⁸⁹ Supozimi i Tribunalit dhe si rrjedhojë i kësaj, hapat procedurale që e ndjekin shembullin janë se një i pandehur në qoftë se se i ka mjetet për të paguar për mbrojtjen e tij, ai ka gjasa të jetë i aftë dhe për të zgjedhur avokat privat ligjor. Në të njëjtën kohë të pandehurit që kanë nevojë për ndihmë mund të kërkojnë nga gjykata që t'u zgjedh dhe t'ua paguajë një avokat.¹⁹⁰

¹⁸⁷ Shih nenin 7 të Dekretit për etikën e avokatëve (Décret n°2005-790 du 12 juillet 2005 relatif aux règles de déontologie de la profession d'avocat). Gjithashtu shih nenin 3.2. të Kodit të Etikës së Avokatëve Evropianw, të adoptuar nga Këshilli i Odave të Avokatëve dhe Shoqatave të juristëve në Evropë (OASHJ) më 19 Maj të vitit 2006. Ai flet për konfliktin e interesit:

3.2.1 Avokati nuk guxon të këshillojë, përfaqësojë apo të veprojë në emër të dy ose më shumë klientëve në të njëjtën çështje në qoftë se ka një konflikt, ose një rrezik sinjifikues për konflikt, në mes të interesave të atyre klientëve.

3.2.2. Avokati duhet të pushojë së vepruari për të dy, ose për të gjithë klientët në fjalë, kur lind një konflikti i interesave midis atyre klientëve dhe gjithashtu sa herë që ka një rrezik të thyerjes së besimit ose ku pavarësia e avokatit mund të jetë e dëmtuar.

3.2.3. Avokati duhet të përmbahet nga veprimi për një klient të ri, nëse ekziston rreziku i shkeljes së një konfidence (besimi) që i është dhënë avokatit nga një ish klient ose naga një njohje të cilën avokati e posedon për punët e klientit, e cila do t'i jipte një avantazh të padrejtë klientit të ri.

3.2.4. Aty ku avokatët e bëjnë praktikën në shoqatë, paragrafët e sipërm 3.2.1 në 3.2.3 do të zbatohen për shoqatën dhe për të gjithë anëtarët e saj.”

¹⁸⁸ Shih nenin 7 të Dekretit për etikën e avokatëve. Për më tepër informacione, shih më sipër Raymond Martin, parag. 52..

¹⁸⁹ Shih Rregullën 45 të Rregullave dhe evidencës së rregullave të GJNPJ: “Sa herë që interesat e drejtësisë kërkojnë, ashtu duhet edhe t'i caktohet avokati të dyshuarit ose të akuzuarit, të cilëve u mungojnë mjetet për të shpërblyer mbrojtësit e tillë.” Gjithashtu shih nenin 1 (A) të Direktivës për Caktimin e Avokatit mbrojtës: “[...]Sistemi i Tribunalit për caktimin e avokatit synon që të sigurojë ndihmë juridike për të dyshuarit e varfër ose të akuzuarit në mënyrë më efikase, më ekonomike dhe më të drejtë në mënyrë që t'i mbrojë të drejtat e ofruara për të dyshuarit dhe të akuzuarit në bazë të Statutit dhe Rregullave. [...]”

Një specifikë tjetër e GJNPJ-së qëndron në caktimin e mundshëm të një ekipi të tërë profesionistësh, të përbërë nga një avokat kryesor, një bashkë-avokat, ndihmës ligjor, hetues dhe menaxhues të rastit.¹⁹¹ Kjo është e justifikuar me seriozitetin dhe kompleksitetin e rasteve me të cilat merret Tribunali.

Sistemi i caktimit

Gjykata mban një listë të avokatëve të kualifikuar të cilët janë pranuar për të përfaqësuar një të pandehur. Pasi që kërkesa për ndihmë juridike dorëzohet zyrtarisht dhe pranohet nga Sekretari, të pandehurit do t'i lejohet që të zgjedhë avokat nga lista e dhënë nga Tribunali.¹⁹² Pasi të emërohet, avokati kryesor formon ekipin e tij të mbrojtjes, zakonisht të përbërë nga mbrojtës ligjorë- asistentë, hetues dhe një menaxher të rastit.¹⁹³

Kualifikimet e avokatëve

Kërkesat edhe për avokatët të cilët janë angazhuar privatisht apo atyre të emëruar në bazë të listës së regjistrimit janë identike. Sipas Rregullës 44 të Rregullave të procedurës dhe provave, për tu paraqitur para Tribunalit avokatët duhet të plotësojnë një numër të kërkesave, duke përfshirë: a) të jenë të pranuar për ushtrimin e ligjit në një shtet apo të punojnë si profesorë universitarë të së drejtës; b) të kenë rrjedhshmëri të të folurit dhe aftësi të shkrimit frëngjisht dhe anglisht, c) të ketë të paktën shtatë vjet përvojë relevante si gjykatës, prokuror, avokat, apo në përgjithësi në procedurën penale, si dhe t'i respektojnë standardet morale etj.¹⁹⁴ Në raste të veçanta, shefi i regjistrimit mund të vendosë që të caktojë si bashkë-avokat një avokat tjetër i cili nuk posedon aftësi të nevojshme në një nga dy gjuhët zyrtare të gjykatës, por flet rrjedhshëm në gjuhën që flitet në territorin mbi të cilin gjykata ka juridiksion.¹⁹⁵

¹⁹⁰ Shih PShP (Pyetjet më shpesh të parashtruara) Mbrojtjen në ueb-faqen e GJNPJ-së në dispozicion në <http://www.icty.org/sid/157>.

¹⁹¹ Shih nenin 16 (E) të Direktivës për caktimin e Avokatit mbrojtës.

¹⁹² Shih PShP për Mbrojtjen në ueb faqen e GJNPJ-së në dispozicion në <http://www.icty.org/sid/157>.

¹⁹³ Shih nenin 16 (E) të Direktivës për caktimin e Avokatit mbrojtës.

¹⁹⁴ Shih Rregullën 44 (A) të Rregullave të procedurës dhe të provave: «[...]Subjekt të cilit do qoftë përcaktimi nga Dhoma në pajtim me rregullën 46 ose 77, avokati do të konsiderohet i kualifikuar për ta përfaqësuar të dyshuarin ose të akuzuarin në qoftë se ai 1) i plotëson kërkesat e Regjistrimit për ta praktikuar drejtësinë në një Shtet, ose nëse është profesor universitar i të drejtës; 2) ka aftësi shkrimi dhe të të folurit nga dy gjuhët punuese të Tribunalit, përveç nëse Regjistri mendohet se është i interesuar të heq dorë nga kjo kërkesë, siç parashikohet në paragrafin (B); 3) është anëtar që qëndron mirë në praktikimin e avokaturës në Tribunalin që është e pranuar edhe nga Regjistri; 4) nuk është gjetur fajtor apo i ndëshkuar në procedurat përkatëse disiplinore kundër tij në një forum kombëtar ose ndërkombëtar, duke përfshirë edhe rastet e parashikuara në Kodin e sjelljes profesionale për Avokatë të Mbrojtjes që paraqiten para Tribunalit Ndërkombëtar, përveç nëse Sekretariati gjykon se, në këto rrethana, do të jetë jo proporcionale të përjashtohet gjykatësi i tillë; 5) nuk është shpallë fajtor në procedurat

Kompensimi i avokatëve

Që nga viti 2004, ka qenë i vendosur një sistem “paushalli” në mënyrë që ta sigurojë ekipin e mbrojtjes me më shumë fleksibilitet në vlerësimin e punës së tij se sa ai që ishte në sistemin e mëparshëm të ndarjes maksimale të orëve të punës të cilat paguheshin me një normë të caktuar për orë. Paushalli i paguar nga Gjykata ka për qëllim mbulimin e tarifave të mbrojtësit kryesor, të bashkë-avokatëve, tarifave për asistentët ligjorë, tarifave e hetuesit, shpenzimet e zyrës, shpenzimet administrative, si dhe tarifave konsulente.¹⁹⁶

Këto pagesa të përgjithshme dallojnë në lartësinë e tyre në varësi nga faza e procedurës dhe nga kompleksiteti i çështjes. Për shembull, në fazën e para-gjyimit nga niveli i një rasti kompleks (që korrespondon me një nivel të vështirë), ekipit të mbrojtjes do t'i caktohen 136.810 €, ndërsa në një rast të nivelit të 3-të (nivel më i lartë i vështirësisë), atij do t'i caktohen të marrë marrë 382.827€. Gjithashtu, në kontekst të fazës së gjyimit, ekipit mbrojtës do t'i caktohet një pagesë mujore prej 28.738 €, ndërsa për raste të nivelit të 1-rë 40.738 € për çështje të nivelit të 3-të.¹⁹⁷

Konflikti i interesit

Për ta parandaluar konfliktin e interesit në Rregullat e procedurës së GJNPJ-së një avokati, në të njëjtën kohë, nuk i lejohet të përfaqësojë më shumë se një të dyshuar ose të akuzuar, përveç nëse i pandehuri i këshilluar nga Sekretariati e merr pëlqimin me shkrim për ta pasur të njëjtin mbrojtës dhe vetëm nëse Sekretariati është i bindur se nuk do të ketë konflikt interesi në lidhje me caktimin ose integritetin e avokatit.¹⁹⁸

relevante penale; (6) nuk është angazhuar në zbatimin e profesionit të tij ose të saj ose nuk është i sinqertë ose i diskredituar ndryshe për një avokat, i dëmshëm për administrimin e drejtësisë, apo mund ta ketë të zvogëluar besimin në Gjykatën Ndërkombëtare ose në administrimin e drejtësisë, ose ndryshe e ka diskredituar Gjykatën Ndërkombëtare, dhe (7) ka siguruar informacione të rrejshme ose mashtruese në lidhje me kualifikimet e tij ose të saj dhe ka pasur durim në praktikimin ose nuk ka arritur të sigurojë informacione të rëndësishme.”

Gjithashtu shihë nenin 14 (A) të Direktivës për caktimin e avokatit mbrojtës.

¹⁹⁵ Shih nenin 14 (C) të Direktivës për caktimin e avokatit mbrojtës.

¹⁹⁶ Këto pagesa të përgjithshme nuk i përfshijnë disa pagesa të tjera të mbuluara nga ana e Tribunalit të tilla siç janë interpretimi dhe përkthimi, DSA-së dhe tarifave të udhëtimit. Për detajet e ndarjes së shumave të përgjithshme, shih në përgjithësi: Këshilluesi mbrojtës- Procedurat paraprake të mbrojtjes ligjore të Sekretariatit të Tribunalit, të miratuara më 1 nëntor të vitit 2009.

¹⁹⁷ Për më shumë informacione, shih Këshilluesin mbrojtës- Procedurat paraprake të mbrojtjes ligjore të Sekretariatit të Tribunalit dhe Këshilluesin mbrojtës- Procedurat paraprake të mbrojtjes ligjore të Sekretariatit të Tribunalit, të adoptuara më 1 nëntor të vitit 2009.

¹⁹⁸ Shih nenin 16 (G) të Direktivës për caktimin e Avokatit mbrojtës.

■ KONKLUZION

Përmbledhja e disa modeleve të përcaktuara për dhënien e ndihmës juridike në çështjet penale i pasqyron disa karakteristika dhe tendenca kryesore në caktimin gjyqësor të avokatëve të të pandehurve të varfër. Këto karakteristika dhe trende janë një reflektim i zgjedhjeve të bëra nga juridiksione të ndryshme për t'ju dhënë të varfërve qasje për asistencë ligjore. Natyrisht çdo model që paraqet një sërë të avantazheve dhe të disavantazheve të tij, duke përsëritur një model të veçantë, është vështirë të argumentohet. Në vend të kësaj, fokusi duhet të vihet mbi cilësinë e çdo modeli dhe të shqyrtohen mënyrat ose qasjet specifike që mund t'i përshtaten modelit në shqyrtim.

